



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 2 MAJ 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 2. MAJA 2013. GODINE**

**MAJ - MAJ
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Miratimi i marrëveshjes së deputetëve nga radha e komuniteteve tjera joshumicë dhe zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit nga këto komunitete,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Avokatinë,
7. Interpelanca e ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Ramë Buja, sipas kërkesës së deputetit Burim Ramadani, mbështetur edhe nga 7 deputetë tjerë lidhur me çështjen e arsimit në Kosovë,
8. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2012,
9. Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2012,
10. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis,
11. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për vlerësimin strategjik mjedisor,
12. Emërimi i dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Usvajanje Sporazuma poslanika iz redova ostalih nevećinskih zajednica i izbor potpredsednika Skupštine iz ovih zajednica,
5. Drugo razmatranje Nacrt zakona o slanju Bezbednosne snage Kosova van zemlje,
6. Drugo razmatranje Nacrt zakona o advokaturi,
7. Interpelacija ministra Obrazovanja, nauke i tehnologije, g. Ramë Buja, prema zahtevu poslanika Burim Ramadani, podržan još od 7 drugih poslanika u vezi pitanja obrazovanja na Kosovu,
8. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Autoriteta civilne avijacije Kosova za 2012. godinu,
9. Razmatranje Izveštaja o radu Kosovske agencije za imovinu za 2012.godinu,
10. Razmatranje Izveštaja Komisije za poljoprivredu, šumarstvo, ruralni razvoj, životnu sredinu i prostorno planiranje o nadgledanju sprovođenja Zakona o procenu uticaja na životnu sredinu,
11. Razmatranje Izveštaja Komisije za poljoprivredu, šumarstvo, ruralni razvoj, životnu sredinu i prostorno planiranje o nadgledanju sprovođenja Zakona o strateškoj proceni životne sredine,
12. Imenovanje dvojice članova u Bordu Radiotelevizije Kosova.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia, me kryetarët e grupeve parlamentare.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit 5 minuta, në emër të deputetit 3 minuta, replika nuk ka.

Në emër të Grupit s'është lajmëruar kurrkush. Po fillojmë sipas radhës së paraqitjes. Fjalën e ka deputetja Xhevahire Izma.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Derisa ne po nisim seancën parlamentare sot, në fshatin Studime të komunës së Vushtrisë po fillon ora përkujtimore në nderim të 112 bashkëqytetarëve të mi, të vranë në natën e 2 majit këtu e 14 vjet më parë.

Më 2 maj '99 në fshatin Studime në komunën e Vushtrisë, forcat policore dhe ato paraushtarake serbe bënë masakra mbi kolonën me njerëz, të cilët nga presioni kishin braktisur shtëpitë e tyre. Në atë kolonë të gjatë refugjatësh shqiptarë ndodheshin: gra, pleq, të rinj dhe fëmijë, kryesisht në traktorë, ulur dhe shtrirë dhe të sëmurë, fëmijë në gjumë, pleq në gjumë, pleq të sëmurë dhe nuk u kursye asnjëri. U vranë edhe në prehër të nënave. Ky fshat konsiderohet të jetë fshati më i martirizuar në gjithë Kosovën, ku numëron t'i ketë 152 të vdekur vetëm në gjashtëmuorin e parë të vitit '99.

Brenda një ore, pra u vranë në atë kolonë 112 qytetarë, duke mos përjashtuar edhe familjen e martirizuar të Selajdin Gërxhaliut, fëmijët e të cilit u gjetën dhe u vranë në gjumë nga paraushtarakë e forca të tjera policore, e disa nga ta edhe u njohën me emra. Emrat e tyre janë dorëzuar dhe dëshmuar në drejtësinë vendore e ndërkombëtare, por deri tani s'u dënua asnjëri.

Të nderuar kolegë deputetë, ata njerëz që vdiqën atë natë, lanë pas edhe fëmijët e tyre edhe familjet e tyre. Dhjetëra fëmijë mbetën pa prindër, pa të dy prindërit, iu vranë ose edhe mbetën të jetojnë me gjyshërit e tyre. Përkrahja financiare normalisht që nuk është e bollshme, institucionet lokale nuk i lanë të pambrojtur, në nivel lokal gjithmonë dyert i patën të hapura për përkujdesje. Shumë organizata humanitare i kanë vizituar dhe disa nga ato kryesisht të Emirateve të Bashkuara, vazhdojnë të asistojnë në ndihma sociale.

Ngjarja si e tillë nuk u trajtua seriozisht asnjëherë. Edhe në Gjykatën e Hagës u thanë një nga një dëshmitë, dëshmitë nga të mbijetuarit, dëshmitë e gjalla të njerëzve që mbijetuan nga ajo masakër, prapë askush s' u dënua.

Fshati Studime u ri ngrit mbi rrënojat e dhembshme, ata të rinj vazhduan shkollimin, fëmijët po rriten, ndërsa pleqtë që mbetën të pavarur kujdesen për nipat e mbesat me zemra të thyera. Fshati Studime është njëri nga sakrificat e këtij vendi për çlirim e pavarësim, fshati Studime dhe të gjithë bashkëqytetarët e mi nuk do të ndalen së kërkuari të drejtën e tyre, që vrasësit të marrin dënimin, edhe pse asnjëherë s' do të jetë mjaft, më të dashurit e tyre nuk do të kthehen asnjëherë në jetë.

Nuk ishte e vetme masakra e Studimes, pas datës së 2 majit, u bashkuan...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputetja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Kryetar, faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës.

Dje ishte dita e Një Majit. Në shumë vende të botës kjo ditë u shënua me protesta, pakënaqësi të punëtorëve dhe kërkim të të drejtave të tyre. Çuditërisht në Kosovë nuk pati protesta. Dhe kjo është, ne mendojmë, jo për shkak se punëtorët në Kosovë janë të kënaqur me kushtet e punës së tyre. Kemi parë storie nga më të ndryshmet, se si shkelen të drejtat e punëtorëve, por kjo, ne konsiderojmë se është nga zaptimi i institucioneve nga ana e shtetit, institucione këto të cilat duhet të merren me të mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

Po të dëgjosh përfaqësuesit e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, të mbetet përshtypja se këto institucione më shumë punojnë për shtetin, se sa për t'i mbrojtur të drejtat e punëtorëve. Një gjë e tillë po ndodh edhe me Agjencinë e Statistikave të Kosovës. Qeveria përfundimisht duket se ka marrë vesh që nuk po mund të adresojë problemin e papunësisë dhe tash ka filluar të fabrikojë artificialisht të dhëna, të cilat janë komplet të pasakta.

Lidhja Demokratike e Kosovës vlerëson se statistikat për të papunët, të prezantuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, nuk tregojnë gjendjen reale.

Vlerësimet se papunësia është ulur për 10% tregojnë se në çfarë mase Qeveria e Kosovës po manipulon me këtë agjenci dhe tregojnë gjithashtu se për çdo ditë kjo agjenci po bëhet dorë e zgjatur e Qeverisë.

Të gjitha të dhënat janë në kundërshtim me konstatimin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës se papunësia na paska rënë për 10%.

Për shembull, të dhënat nga Administrata Tatimore dhe Trusti Pensional tregojnë që në vitin 2012 janë krijuar vetëm 6 mijë vende të reja të punës, derisa vendet e reja të punës të krijuara një vit më parë kanë qenë 16 mijë. Ky është një indikator i mjaftueshëm që ne kemi rritje të papunësisë dhe assesi ulje të papunësisë. Por, ku të merren parasysh 25 - 30 mijë punëtorë që i bashkëngjiten tregut të punës çdo vit, atëherë kjo gjendje del edhe më alarmante.

Edhe statistikat tjera janë në kundërshtim me konstatimin e ASK-së.

- Rritja e prodhimit të brendshëm ka rënë nga 5% në vitin 2011 në 2,7% në vitin 2012.
- Eksportet në vitin 2012 kanë rënë 15% krahasuar me një vit më parë.
- Kemi pasur rënie të investimeve të huaja për 13%,
- Kemi pasur rënie të investimeve të reja nga 8,8% në vitin 2011 në 4,4% në vitin 2012.

Kështu që këto të dhëna që ditë më parë i prezantoi Agjencia e Statistikave të Kosovës, kanë plot kontradikta dhe konstatime jo logjike. Po të shikonim në të dhënat që aty prezantohen, na del se numri i të papunëve ishte 400 mijë në vitin 2011 dhe është 400 mijë në vitin 2012. Vetëm kjo shifër të merret parasysh, atëherë del që papunësia nuk është zvogëluar me 10%, siç paraqitet aty.

Ne kujtojmë se kjo agjenci duhet të jetë plotësisht e pavarur. Kjo Agjenci para dy vjetësh është futur nën ombrellën Zyrës së Kryeministrit dhe me këtë rast Qeveria nga viti 2009 e ka stopuar anketën e tregut të punës, e cila çdo vit nxirrte në shesh dështimet e Qeverisë për uljen e papunësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Grupit të “Vetëvendosjes”, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Një pyetje që ka mbetur përherë pa përgjigje për sa i përket procesit të privatizimit të vazhdueshëm është ajo më e thjeshta, e cila del natyrisht si pyetje kryesore drejtuar vendimmarrësve në këtë proces.

Pse po e privatizoni pronën publike të Kosovës?

Them se ka mbetur e pa përgjigje për shkak se asnjë prej përgjigjeve të deritashme të dhëna nga ministri Beqaj apo eksponentët tjerë të ekzekutivit, nuk e kanë as bazën më të vogël rationale që e mbështet përgjigjen.

Njëra prej përgjigjeve kryesore e cila mëton të tingëllojë edhe e saktë në aspektin ekonomik është arsyeja kujdestare e privatizimit, rritja e efikasitetit të kompanisë, si dhe një arsye tjetër që përdoret zakonisht e që lidhet me të është futja e kapitalit të freskët privat në kompani.

Në rastin e PTK-së kjo përgjigja e dytë, pra e kapitalit privat, kapitalit të freskët, nuk ka kurrfarë kuptimi, pasi që PTK-ja ka qenë dhe mbetet kompani profitabile, e cila jo që nuk ka marrë para nga buxheti i vendit, por e ka furnizuar atë me para. Në mungesë të kësaj arsyeje që tingëllon e mirë për veshin e qytetarit, pra po privatizojmë meqenëse duam ta lirojmë buxhetin e vendit nga barra e subvencionimit, Qeverisë i ka mbetur vetëm një përgjigje efiçenca, mirëpo këto të dyja janë të lidhura me njëra-tjetrën.

Një kompani që e përfundon secilin vit të operimit me bilanc të kënaqshëm pozitiv, nuk mund të thuhet se është kompani joefiçente.

Instituti INDEP tash së fundi ka publikuar një infograf në të cilin përmbledhen të dhënat që dëshmojnë shëndetin financiar dhe operativ të PTK-së prej vitit 2007. Po i përsëris disa prej tyre këtu.

- Nga viti 2007 deri në vitin 2011, PTK ka realizuar profit neto, pra të kulluar, prej 234 milionë e 300 mijë euro.
- PTK i ka 1.2 milionë konsumatorë aktivë, treg ky që është shumë i dëshirueshëm për cilëndo kompani, në cilindo sektor.
- Gjatë këtyre 5 vjetëve PTK ka investuar 293 milionë 900 mijë euro në rrjetin e vet.
- Ndërkohë që është shitur për 242 milionë euro.

Gjatë një takimi që Komisioni për Zhvillim Ekonomik ka pasur me përfaqësuesit e “British Telecom”, të cilët janë paraqitur këtu si kompani ose këshillues strategjik për kompaninë që e ka fituar tenderin, pra për AXOS-in, ata kanë treguar se sipas vlerësimit të tyre me 140 milionë euro investime shtesë PTK do të bëhej kompani e standardeve evropiane të telekomunikimit, që i bie se po të mos i ndalohej rritja PTK-së nga Qeveria përmes urdhërësës së famshme të vitit 2010 të ish-ministrit Ahmet Shala, tash sigurisht se do ta kishim një PTK shumë më të zhvilluar.

Dhe, kështu kthehemi te pyetja fillestare, pse po e privatizoni PTK-në?

Racionalitet shoqëroro-ekonomik në privatizim nuk ka. Në rastin e PTK-së nuk ka fare as racionalitet financiar, që i bie se arsyeja privatizimit ose është korrupsioni ose është besimi ideologjik i Qeverisë në privatizim. Ky besim ideologjik në një teori që qartazi ka dëshmuar të jetë e gabuar dhe dashakeqe është vetvetiu korruptiv. Pra, këto dyja nuk mund të ndahen dhe ky proces i privatizimit, përveç që nxit korrupsionin, ky vetvetiu e shkakton dhe është proces i korrupsionit, prandaj edhe duhet të ndalet. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Ministri i Transportit nuk është këtu, por ndoshta i shkon kjo porosi prej Kuvendit. Unë do të kërkoj një temë që lidhet me Klinën, respektivisht me fshatin Zajm, ku kemi pasur vërshime ditëve të fundit të trajtohet me urgjencë nga Qeveria, për faktin e thjeshtë se atje vazhdon të jetë një gjendje e jashtëzakonshme. Dhe, kur po them të trajtohet, nuk po

ndalem te kërkesa për përkrahje tash pas vërshimeve dhe pas problemeve që u shkaktuan ujërat këtyre njerëzve, mirëpo të trajtohet seriozisht duke shtruar rrugën atje dhe duke rregulluar kanalet e përçarjes së ujit.

E di ministri, sepse projekti ekziston dhe kërkesa e qytetarëve, mirëpo në vazhdimësi po neglizhohet dhe veç kur po kemi vërshime po shkojmë sa për të dalë në televizion për të thënë qe erdhëm t'ju shohim e t'ju ndihmojmë.

Tash është momenti, është pranvera, për ta kryer atë projekt, në mënyrë që njerëzve atje të mos u përsëriten tragjeditë që kanë ndodhur ditëve të kaluara e të cilat po vazhdojnë të kenë pasoja për ta dhe familjet e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Deputetë të nderuar,

Ministra,

Dje kemi qenë dëshmitarë nga lajmet që i kemi marrë të një sulmi në shtëpinë e një gazetari. Është fjala për një nga gazetarët më veteran, më profesional në Kosovë, kryeredaktorin e Radiotelevizionit të Kosovës.

Po e shfrytëzoj këtë rast këtu që të shpreh shqetësimin dhe të kërkoj nga organet që sa më shpejtë të bëjë ndriçimin e këtij rasti. Rastet e tilla nuk na ndihmojnë fare në asnjë prej proceseve, përkundrazi e dëmtojnë rënd fjalën e lirë dhe demokracinë në Kosovë, për më tepër ndikojnë negativisht edhe në raportet që nxirren nga institucionet ndërkombëtare për lirinë e shtypit dhe të gazetarisë në Kosovë.

Përfundimisht, institucionet tona me prioritet duhet t'i trajtojnë këto raste dhe t'i zbardhin sa më shpejtë, në mënyrë që në opinion të mos ketë paragjykime dhe ata që bëjnë vepra të tilla, të dalin sa më shpejtë para drejtësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Haki Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Kohë më parë një punëtor i konsorciumit "Behtel&Enka" ka pësuar një aksident të rëndë derisa po punonte në vend punishten e kësaj kompanie, në afërsi të Fushë Kosovës.

Aksidentet e këtilla të punëtorëve që jo rrallë përfundojnë edhe me vdekje, zakonisht ndodhin për shkak se siguria e punëtorëve në ambientet e tyre të punës në Kosovë, vazhdon të mbetet në nivel tejet të ulët.

Sipas të dhënave të Inspektoratit të Punës gjatë vitit 2011 në Kosovë 10 punëtorë kanë gjetur vdekjen në vendet e tyre të punës, kurse 31 të tjerë kanë pësuar lëndime serioze,

kurse gjatë vitit 2012 numri i punëtorëve të vdekur nga aksidentet në punë ishte edhe më i madh, se sa ai i vitit 2011, sepse ishin gjithsej 14 të vdekur.

Ndonëse dispozitat e Ligjit për punë dhe atij për siguri në punë kanë hyrë në fuqi në fillim të vitit 2011, për shkak të moszbatimit adekuat të tyre nga ana e organeve përkatëse, sot kemi situatën në të cilën punëtorët kosovarë jo vetëm që punojnë në ambiente të pasigurta pune, por edhe në të njëjtën kohë një numër shumë i madh i tyre nuk gëzon kurrfarë sigurie juridike, për shkak të punësimit pa kontrata pune, apo për shkak të mosrespektimit të kontratave të punës nga ana e punëdhënësve.

Kjo pasiguri fizike në punë dhe pasiguria juridike punëtorin kosovar e ka shndërruar, kushtimisht thënë, në një skllav të shekullit XXI, duke e vënë atë në një pozitë tejet të rëndë. Kjo pozitë e rëndë e punëtorëve kosovarë, në radhë të parë është refleksion i varfërisë dhe papunësisë së madhe në Kosovë, sepse në një vend ku afro 20% e popullatës jetojnë në varfëri të skajshme dhe ku afro 50% janë të papunë, është e pritshme që punëdhënësit pasur parasysh mundësinë që në tregun e punës të gjejnë dhe të zgjedhin punëtorë sipas dëshirës dhe çdo kohë, që edhe të mos i trajtojnë ata konform dispozitave ligjore në fuqi dhe konform parimeve humano-etike.

Andaj, duke pasur parasysh këtë gjendje të rëndë të punëtorëve kosovarë, kërkoj nga Qeveria, Ministria e Punës dhe Inspektorati i Punës, që të rrisin buxhetin, të shtojnë kapacitete njerëzore, por edhe t'i intensifikojnë veprimet dhe aktivitetet e tyre punuese në rrafshin e zbatimit të ligjeve në fuqi me përpikëri dhe në atë mënyrë të krijojnë ambiente të kënaqshme të punës, ku punëtori kosovar do ta gëzonte sikurse sigurinë e duhur juridike, ashtu edhe atë fizike. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Dialogu politik në Bruksel midis Thaçit e Daçiqit, nga Qeveria e Kosovës argumentohet edhe me nevojën për integrimin e serbëve të Kosovës.

Në fakt, sa herë që kemi pasur bisedime e negociata midis Kosovës e Serbisë, janë përdorur serbët e Kosovës, nga Prishtina zyrtare kinse për integrimin e tyre, kurse nga Beogradi zyrtar, kinse për mbrojtjen e tyre.

Qeveria e Kosovës flet për integrimin e serbëve, që të jetë sa më e pranueshëm nga faktorët ndërkombëtarë dhe t'ua zbusë sa zemrën atyre që ia kanë dosjet e korrupsionit dhe të krimit të organizuar. Ndërkaq, qeveria e Serbisë flet për mbrojtjen e serbëve në Kosovë, për ta rritur hegjemoninë e vet me ç'rast serbët lokalë janë mjeti për territor dhe pasuri natyrore e jo anasjelltas.

Kësisoj oportunitizmi i Prishtinës bëhet komplementar me hipokrizinë e Beogradit. Integrimi i vërtetë dhe i qëndrueshëm është integrimi shoqëror e jo ai institucional. Për integrimin institucional do të mund të thuhej se është i nevojshëm, por kurrësi i

mjaftueshëm. Integrimi institucional është integrim i përfaqësuesve të serbëve dhe jo i serbëve, prandaj integrimi i kufizuar tek ai institucional është i brishtë. Kujtojeni, për shembull, rastin e Oliver Ivanoviqit, i cili për tetë vjet rresht ishte i integruar në institucionet e Kosovës, por e dimë se ku është sot dhe çfarë bënë atje.

Integrimi institucional është elitë, është integrim i elitës. Përmes këtij integrimi diku mirëmbahet e diku edhe prodhohet elita, por nuk integrohet komuniteti. Integrimi institucional është prej lart-poshtë. Kosova ka nevojë për integrim prej poshtë – lart. Integrimi prej lart mbetet lart dhe nuk mbërrin poshtë, integrimi prej poshtë arrin edhe lart.

Integrimi prej lart-poshtë është konjunktural, integrimi prej poshtë – lart është demokratik dhe mbi të gjitha është shoqëror, është integrim në shoqëri. Ne i përkasim kombeve të ndryshme por, jemi në të njëjtën shoqëri.

Megjithatë, kur them integrim shoqëror nuk mendoj te seminarët, konferencat e trajnimet e OJQ-ve në kohën e pasluftës, por te barazia si vlerë e synim, te shteti i së drejtës dhe zhvillimi ekonomik i bazuar në prodhim. Integrimi është çështje e barazisë dhe jo çështje e tolerancës. Në fabrika dhe universitete thuret shoqëria, sepse aty krijohet solidariteti i punëtorëve dhe bashkëpunimi i studiuesve akademikë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Deklarimi im ka të bëjë me shqetësimin e komunitetit të fshatit Prelez të Muhaxherëve lidhur me pronat publike të këtij fshati.

Kuvendi Komunal i Ferizajt në vitin 2012 kishte shpallur interes të veçantë për disa prona të fshatit Prelez të Muhaxherëve. Konkretisht, bëhet fjalë për dy ngastra kadastrale me sipërfaqe të përgjithshme prej 2,7 hektarësh. Kuvendi Komunal i Ferizajt në vitin 2012 kishte formuar një komision lidhur me këto prona, ky komision kishte për detyrë të pranonte aplikacione për ofertim për këto prona.

Po këtë vit banorët e fshatit Prelez të Muhaxhirëve kishin zhvilluar një takim me kryetarin e komunës. Në takim është prezantuar kërkesa e kryetarit të komunës të ndajë 2 hektarë për varrezat e fshatit, si formë e tjetërsimit të pronës, por gjërat nuk kanë lëvizur aspak në drejtimin e kërkesave të banorëve. Injorimi i banorëve nga kryetari i komunës ka bërë që ata ta formojnë një këshill organizativ për t'i mbrojtur interesat e komunitetit të tyre.

Po ashtu ky këshill ka mbledhur më shumë se 500 nënshkrime të banorëve të fshatit, për ta kundërshtuar propozimin e Komisionit për dhënie në shfrytëzim të pronave. Peticioni i është dorëzuar shefave të kryetarit të komunës, kryesuesit të Kuvendit Komunal dhe grupeve parlamentare komunale, por mbledhja e Kuvendit Komunal e datës 28 mars të vitit 2013 nuk rezultoi kështu, për shkak se Kuvendi e miratoi këtë vendim, edhe pse ishte dorëzuar një peticion.

Mendojmë se këtu kemi të bëjmë me një shkelje të procedurës, sepse neni 100 i Statutit të komunës, obligon kryetarin që në afat prej 30 ditësh nga dita që ai pranon çdo petition të vlefshëm, t’ia propozojë këtë Kuvendit. Po ashtu, neni 102 përcakton qartë se komuna afirmon dhe avancoon parimet dhe mekanizmat për pjesëmarrje të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes për çështje me interes të përgjithshëm të komunës, të komunitetit dhe për prona dhe treva tjera të caktuara.

Banorët mendojnë që neni 34, pika 1 dhe neni 34, pika 2 i Ligjit për vetëqeverisje lokale është shkelur nga ana e kryetarit të komunës, respektivisht nga komuna e Ferizajt.

Banorët e Prelezit të Muhaxherëve nuk u pyetën fare për dhënien ose jo në shfrytëzim të pjesës ku ata mendojnë që është e destinuar për destinim kolektiv të fshatit. Me këtë rast ata mendojnë se është shkelur edhe neni 99 i Statutit të komunës së Ferizajt. Banorët e këtij fshati e kundërshtojnë këtë zonë ekonomike, sepse kanë pasur një përvojë shumë të hidhur në një zonë tjetër, një kilometër afër fshatit të tyre.

Komuna pra nuk e ka marrë parasysh petitionin për 500 nënshkrimet e fshatarëve, ka shkelur Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe po ashtu Statutin e komunës, pra komuna do të duhej të rreshtohet në anën e banorëve, në anën e interesave të qytetarëve dhe jo t’i kundërshtojë ato edhe kur ka këshille organizative edhe kur banorët respektojnë çdo procedurë, në këtë rast duke formuar këshillin organizativ dhe duke formuar po ashtu, edhe një petition prej 500 nënshkrimeve.

Kërkojmë nga komuna, që ta respektojë vendimin e komunitetit dhe po ashtu, ta tërheqë vendimin e padrejtë që ka marrë në dëm të fshatit Prelez.

KRYETARI: Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Unë sot do të paraqes një shqetësim të qytetarëve lidhur me zhvillimet që kohëve të fundit janë duke ndodhur në Kuvendin e Kosovës, në veçanti me dhunimin që është duke iu bërë Kuvendit të Kosovës nga deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Nuk ka ekzistuar një praktikë e tillë që të organizohen protesta në sallat e mbledhjeve plenare. Kjo praktikë e organizimit të protestave në sallat e mbledhjet plenare po e dëmton rënd imazhin e Kuvendit të Kosovës. Parlamenti nga tempulli i demokracisë, nga deputetët e “Vetëvendosjes” ka filluar të shndërrohet në sheshin ‘Tahrin’.

Po shihet qartë se deputetë të “Vetëvendosjes”, në krye me liderin e tyre, me shumë dilema kanë marrë për detyrë që ta degradojnë Kuvendin e Kosovës, nga tempulli i demokracisë, nga organ ligjvënës, në shesh të protestave, në sheshin ‘Tahrin’.

Përpjekjet e këtij grupi të frustruar, të cilët nuk po gjejnë përkrahje nga qytetarët, sepse ato në qytete nuk kanë as nga dhjetëra protestues në organizimet e tyre, andaj

“Vetëvendosja” e dëshpëruar, në mungesë të përkrahjes së qytetarëve, ka filluar të dhunojë demokracinë në Kuvend të Kosovës me këto veprime, të cilat do të duhej të sanksionoheshin nga Kryesia e Kuvendit, konform Rregullores së punës së Kuvendit.

Qytetarët e Kosovës janë të indinjuar me degradimet që po u bëhen Kuvendit të tyre nga ky grup i frustruar dhe i demoralizuar. Kërcënimet me jetë që po i bëhen kryeministrit të vendit nga aktivistë të “Vetëvendosjes” dhe rasti i fundit i eksplodimit me bombolë gazi te shtëpia e kryeredaktorit Mufail Limani, dëshmojnë qartë se individë dhe grupe politike të caktuara nuk mund ta kuptojnë jetën plurale në Kosovë dhe kanë probleme serioze në të kuptuarit e demokracisë.

Kërkoj nga organet e rendit, që të bëjnë të pamundurën, të shpenzojnë tërë potencialin, që personat që shkaktuan dhe rrezikuan familjen Limani, të gjenden sa më shpejt dhe të marrin dënime të merituar.

Gjithashtu, kërkoj nga organet e rendit që personat që në rrjetet sociale dhe në media e kërcënuan publikisht kryeministrin e vendit, t’i arrestojnë, sepse dihen me emër dhe mbiemër dhe të njëjtit të gjykohen për vepra penale të kërcënimit, konform Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Nesër është 3 maji, që është Dita Botërore e Lirisë së Shtypit. Në prag të kësaj dite raporti i Freedom House ka dalë dhe ka konstatuar që Kosova ka rrëshqitur ose është përkeqësuar liria e medias në Kosovë. Në fakt, ka rrëshqitur nga vendi i 98, në vendin 102, në krahasim me një vit më parë.

Sfidat, të cilat shihen ose evidentohen në këtë raport, kanë të bëjnë me këtë, që media është e lidhur me politikën dhe vështirësitë ekonomike. Në fakt, Dita Botërore e Lirisë së Shtypit e gjen Kosovën në një cirk mediatik ose politiko-mediatik, kur një kompani private është në gjendje ta bëjë këtë cirk me një televizion të pavarur.

E kam fjalën për IPKO-n dhe RTK-n, e cila kompani në kundërshtim të plotë me interesat e publikut, vendos sipas qejfit ta zhvendosë një nga kanalet kryesore të informimit të publikut. Frekuencat publike janë një e mirë publike, kështu që askush nuk mund të luajë me këto.

Liria e shprehjes nuk është e mundur në atmosferën e frikës, edhe pse ne mund të kemi ligje të mira edhe pse unë mendoj se ende nuk është plotësuar korniza ligjore e duhur për sa i përket lirisë së medias e megjithatë, mediat sot, gazetarët, sidomos gazetarët profesionistë operojnë në një atmosferë frike, atmosferë e cila vjen në formën e shantazheve dhe kërcënimeve të ndryshme, veçanërisht nga Qeveria e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk kemi më të lajmëruar për këtë pikë të rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, por para se të vazhdojmë me pikën e rendit të ditës unë i kisha lutur deputetët që të mos e marrin rolin e organeve që nuk e kanë për detyrë dhe obligim. Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Kësaj radhe i kemi 16 pyetje parlamentare. Shumica e ministrave të cilëve u janë drejtuar pyetjet, nuk janë këtu, megjithatë ne po shkojmë me radhë pasi kemi disa që janë këtu.

Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Ramë Buja.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

I nderuari ministër zoti Ramë Buja,

Studentët e Fakultetit Juridik të cilët kanë përfunduar studimet me 4 vjet, kanë të drejtë të hyrjes në provimin e jurisprudencës, do të thotë, pa provim pranues, ndërsa studentëve të cilët i kanë të kryer sistemin bachelor 3 vjet nuk u lejohet të hyjnë në provimin e jurisprudencës pa përfunduar masterin.

Dihet se studentët në sistemin katërvjeçar kanë 42 provime, ndërsa studentët që janë me bachelor ose trevjeçare kanë 45 provime. A mund të na shpjegoni pse është ndodh kjo kështu dhe si do të jetë mundësia që në të ardhmen edhe studentët me bachelor të hyjnë në provimin e jurisprudencës pa master? Faleminderit!

KRYETARI: Ministri Ramë Buja e ka fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

E nderuar deputete Ganimete,

Ligji për provimin e jurisprudencës numër 02-L/40 i përcakton kriteret se kush ka të drejtën t'i nënshtrohet këtij provimi. Neni 2 pika 1 thotë se personat të cilët mund t'i nënshtrohen provimit të jurisprudencës duhet të jenë të diplomuar në Fakultetin Juridik sipas programit të vjetër katërvjeçar ose studimet master pa dallim race, ngjyre, feje, gjinie, opinionin politik e tjera.

Dhe neni 3 i këtij ligji mbi kushtet e veçanta për dhënien e provimit të jurisprudencës sqaron në tërësi kushtet për dhënien e këtij provimi. Pra, me ligjin në fjalë është paraparë që studentët të cilët kanë diplomuar në Juridik dhe kanë marrë thirrjen jurist i diplomuar me 4 vjet, kanë pasur të drejtën t'i nënshtrohen provimit të jurisprudencës, ndërsa studentët me sistemin 3 + 2, përkatësisht me studimet themelore bachelor është dashur që të kenë të përfunduar edhe masterin që të mund t'i nënshtrohen këtij provimi. Sipas njohurive që kam, ligji është në procedurë për t'u ndryshuar në Kuvend, por akoma nuk është ndryshuar dhe se si do të ndryshohet do të vendosni ju. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Kymete Bytyçi, pyetje për ministrin Dardan Gashi. Dardani s'është këtu. Deputete, doni ta parashtroni pyetjen? Nuk qenka as deputetja.

Deputeti Arsim Bajrami, pyetje për ministrin Ramë Buja.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër Buja,

Padyshim se vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për hapjen e universiteteve publike në disa qytete të mëdha është një vendim për t'u përshëndetur dhe në funksion të ofrimit të arsimit të lartë qytetarëve sa më afër vendbanimit.

Konteksti i pyetjes sime është ky. Zoti ministër, aktualisht në zonën e lartë të arsimit të lartë operojnë shumë universitete dhe kolegje private dhe publike. Unë e kuptoj që Ministria mund të ketë mungesë kapacitetesh për të kontrolluar cilësinë e mësimdhënies në institucionet private, por jam i sigurt se Ministria e ka për obligim që të kujdeset për respektimin e këtyre standardeve të arsimit të lartë në universitetet publike, ato të formuara dhe ato që do të formohen këtë vit shkollor.

Pyetja ime është kjo: A keni ndonjë analizë, a keni ndonjë studim mbi kualitetin e kuadrit mësimor, kualitetin e mësimdhënies në universitetet e porsaformuara, sepse ka informacione që aty-këtu si bartës të lëndëve në disa lënde në disa kurse janë edhe njerëzit pa titull të doktorit të shkencës, gjë që bie ndesh drejtpërdrejt me Ligjin për arsimin e lartë. Mbrojtja e standardeve universitare në këto universitete të porsahapura shumë me rëndësi për aderimin e Kosovës në proceset e Bolonjës, sepse në momentin kur ne do të bëhemi anëtarë fuqiplotë të procesit të Bolonjës do të ketë një ekspertizë ndërkombëtare të respektimit të standardeve ndërkombëtare sa i përket arsimit universitar. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar deputet Bajrami!

Pyetja u koncipua pak më ndryshe se sa që është bërë këtu drejtpërdrejt dhe u zgjerua si e tillë, por megjithatë përgjigja edhe mund të jepet, sepse pyetja është - a mund të na informoni cilat veprime po i ndërmerri për të mbikëqyrur standardet e mësimdhënies dhe kuadrit në universitetet e sapo formuara publike. Kështu është decidivisht e shkruar pyetja.

Faleminderit edhe për ato të shtuara, sepse në fakt përgjigja mund të jepet pa pikë problemi.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë i ka zbatuar të gjitha procedurat ligjore për themelimin e dy universiteteve publike në vend, siç është Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren dhe Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka zhvilluar procedurat për funksionalizimin e universiteteve të reja në vend duke formuar bordet udhëheqëse të

këtyre dy institucioneve arsimore të cilat kujdesen për funksionimin dhe mbarëvajtjen e të gjitha procese mësimore. Pas konsolidimit të bordeve, ju është rekomanduar që të aplikojnë në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës për akreditimin e programeve të tyre dhe këtë e kanë bërë.

Të dy universitetet fillimisht kanë shfrytëzuar stafin akademik të UP-së, por me kalimin e kohës këto dy universitete kanë filluar procedurat e rekrutimit të stafit të ri akademik.

Universitetet publike të sapoformuara, Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren dhe Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë kanë akte ligjore të mjaftueshme ose infrastrukturë ligjore të mjaftueshme, gjegjësisht statute të përkohshme dhe vendime të organeve kompetente të këtyre dy universiteteve mbi bazën e të cilave bëhet përzgjedhja e stafit akademik.

Të dyja këto universitete tash kanë të formuara edhe zyrat për cilësi ku vlerësimi i studentëve bëhet nëpërmjet pyetësorëve, të cilët përmbajnë një seri pyetjesh për performansën e mësimdhënësit, përshtatshmërinë, literaturën, interaktivitetin dhe një seri çështje specifike, këto pra janë në raportet që plotësohen nga studentët në mënyrë anonime në këto dy institucione.

MASHT-i ka edhe zyrat rajonale të inspektorëve, në Prizren e Pejë, të cilët janë të obliguar për inspektimet e kohëpaskohshme edhe në këto dy institucione, kurse me organogramin e ri MASHT-i ka paraparë që në Departamentin e Arsimit të Lartë të formohet edhe Divizioni për sigurim të cilësisë në institucionit të arsimit të lartë.

Ndërkohë ne u kemi rekomanduar të dy institucioneve që konkurset që e kanë të paraparë t'i mbajnë, në të vërtetë t'i japin dy herë në vit, këto konkurse meqë kanë mungesë të kuadrove t'i kenë përherë të hapura edhe kur vijnë profesorë cilësorë të kenë mundësi të aplikojnë dhe të realizojnë mundësinë e punësimit të tyre, kështu që nëse doni për numrin e angazhimit të profesorëve dhe të niveleve të tjera në këto institucione është kështu: Në Universitetin Publik të Prizrenit, në të vërtetë Ukshin Hoti, në Prizren momentalisht ka 149 veta si staf akademik, prej tyre 12 profesorë asistentë dhe dy ligjërues të rregullt, 41 bashkëpunëtorë të jashtëm dhe 94 ligjërues të angazhuar. Përzgjedhja e tyre është bërë përmes konkursit publik....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë?

ARSIM BAJRAMI: Do ta bëj edhe një pyetje shtesë, jam shumë i kënaqur me përgjigjen në segmentin e parë, në segmentin kur ministri na informoi që janë instaluar mekanizmat e vetëvlerësimit të kualitetit të mësimit dhe ato janë plotësisht me standarde evropiane, por unë do të doja të di që a ka në plan ministri ta mbajë permanent konkursin e hapur në këto universitete deri sa lëndët të plotësohen me kuadro, me titull të doktorit të shkencës në mënyrë që këto dy universitete që nga themelimi të kenë standarde të larta të mësimdhënies që edhe ka qenë qëllimi i themelimit. Pra, jo të kemi 94 me kontrata dhe

vetëm 2 ligjërues, por unë mendoj, nuk mjafton 2 herë në vit konkursi, por ato konkurse të jenë permanent të hapura deri sa të plotësohen me profesorë që Ligji për arsimin e lartë e parasheh. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë, zoti ministër!

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar deputet Bajrami,
Unë thashë se ju kam sugjeruar këtyre dy institucioneve që konkursi të jetë përherë i hapur me këtë qëllim çfarë ju e sugjeroni, por mbeta pa e thënë përgjigjen për Universitetin Publik “Haxhi Zeka” në Pejë. Janë gjithsej 114 staf akademik në këtë Universitet, prej tyre janë 56 të rregullt dhe 58 ligjërues të angazhuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë me ministrat që janë prezentë. Deputetja Hykmete Bajrami, pyetje për ministrin Besim Beqaj. Deputete e ke fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit kryesues!

Ministër, siç e keni parë edhe pyetjen, në deponinë e hirit të KEK-ut në vendin e quajtur Fusha e palosjes së hirit, që shtrihet në mes fshatit Orlovic - Dardhishtë dhe Dragodan, përballë drejtorisë së Divizionit për prodhimin e qymyrit po kultivohet grurë. Në këtë deponi, e cila nga ekspertët konsiderohet se është shumë e kontaminuar për shkak të pranisë së metaleve të rënda, janë mbjell rreth 15 hektarë grurë të cilët pas shirjes sigurisht se do t’i destinohen tregut.

Ajo çka është befasuese është se për shkak të nivelit të lartë të kontaminimit kjo zonë është nën mbikëqyrjen e sigurimit të Korporatës Energjetike të Kosovës dhe aty nuk mund të hyhet pa një leje të posaçme nga Korporata Energjetike e Kosovës, po pavarësisht kësaj, dikush ka hyrë dhe i ka mbjell 15 hektarë grurë.

Nga zyrtarët e KEK-ut ky rast konsiderohet si uzurpim i pronës, por uzurpimi i pronës publike në këtë rast nuk është shumë shqetësues sa është rasti se gruri i kontaminuar në këtë vend me veti kancerogjene sipas ekspertëve nëse nuk ndërmerren masa, qoftë nga ana e juaj, Ministrisë së Punëve të Brendshme apo dikush tjetër do t’i destinohet tregut.

Pyetja është: A jeni në dijeni rreth kësaj problematike dhe a keni ndërmarrë ndonjë hap? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete,

Sigurisht që shqetësimet e ambientit janë shqetësime të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Unë kam komunikuar me KEK-un dhe nuk kam informatë zyrtare që KEK-u ka ndonjë dokument që prona është e uzurpuar dhe në raste kur prona është uzurpuar duhet të ndiqen forma ligjore për trajtimin e kësaj dhe do të isha shumë mirënjohës nëse keni

çfarë do lloj dokumenti zyrtar nga ana e KEK-ut që është uzurpim i pronës dhe që është jashtë kompetencave të tyre kjo punë duke ndodhur. Për më shumë për mbrojtjen e ambientit dhe trajtimin e elementeve të çfarëdolloj ndotjeje të ambientit është Ministria e Ambientit dhe e cila i trajton ato bashkë me Ministrinë e Bujqësisë. Ju e dini që vitin e kaluar kemi pasur një raport rreth kontaminimit sepse është bërë modë të flitet për kontaminim të tokës në Kosovë. Nuk kisha marrë guximin të them se ajo është e kontaminuar apo jo e kontaminuar pa pasur ndonjë vlerësim të saktë me shkrim të ekspertëve të cilët do ta jepnin një vlerësim të tillë.

Mendoj që një qasje e tillë është qasje që duhet të shkojmë në të ardhmen që të kemi konfirmim nga ekspertët të cilët janë të thirrur për këto dhe pastaj së bashku me Ministrinë e Ambientit edhe në Ministrinë e Bujqësisë ne do ta trajtojmë, por kjo çështje - mbrojtja e ambientit, trajtimi dhe mbrojtja nga rreziqet e natyrës së tillë nuk është punë e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit kryesues.

Ministër, me të vërtetë nuk është përgjigja që e pritja dhe këtu nuk është çështja vetëm e kontaminimit të ambientit, është fjala që 15 hektarë grurë po kultivohen në fushën e palosjes së hirit, do të thotë, në një deponi të hirit ku koncentrimi është tepër i madh përtej çdo mase i fenolëve, metaleve të rënda dhe po kultivohet grurë, nuk po flasim vetëm për ndotje të ambientit.

Ju si Ministri e Zhvillimit Ekonomik e keni Njësinë për monitorim të politikave të ndërmarrjeve publike. Kjo është kompetencë e KEK-ut. KEK-u para disa ditësh e ka ngritur. Kanë qenë artikujt nëpër gazeta. Unë kam shkuar në vendin e ngjarjes dhe e kam parë, janë rreth 15 hektarë grurë. Aty nuk mund të hyhet, do të thotë nuk mund të hyhet në fushën e grurit, sepse nuk lejon sigurimi. Dikush ka hyrë. Unë nuk kam dokument që është uzurpuar por ju shpjegomani, nëse nuk është uzurpim kush i ka mbjellë, a i ka mbjell Qeveria, a i keni mbjell ju, a i ka mbjellë KEK-u?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Kolege e nderuar,

Besoj që është jashtëzakonisht e rëndësishme që kur flasim para qytetarëve të flasim me kompetencë të plotë, edhe institucionale edhe profesionale. Ju thatë që ka uzurpim. Unë për pjesën e uzurpimit jam marrë me kompaninë, sepse kjo është detyrë e imja. Nuk kam asnjë dokument se ka uzurpim. Në ndërkohë, ju lutem, në ndërkohë ju po thoni që ka kontaminime. Unë po them që pa pasur respektim të procedurave profesionale për kontaminim nuk mund të flas. Prandaj, ju lutem të gjitha shqetësimet të cilat i keni janë institucionet të cilat merren me këto procedura dhe me këto problematika. Prandaj në këtë kontekst, unë thashë është shqetësim i madh për të gjithë qytetarët në rast se ndodhë një procedurë e tillë, por nuk guxoj të marr guximin dhe të them që sot ne konstatojmë se grurë është mbjell në një hapësirë të uzurpuar dhe të kontaminuar, sepse as nuk e dimë a është e uzurpuar dhe as që kemi raport të ekspertëve për kontaminim. Faleminderit!

KRYETARI: U krye. Megjithatë, ministri është dashur të thotë, a është uzurpuar apo nuk është e uzurpuar, a ka grurë apo s'ka grurë. Përgjigja duhet të jetë më decitive. Vazhdojmë.

Deputetja Hykmete Bajrami, pyetje për ministrin Fehmi Mujota.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Nuk mund pa u kthye edhe një herë. Është hera e dhjetë ose me dhjetëra herë ministri i Zhvillimit Ekonomik më drejtohet mua që nuk jam profesioniste, nuk jam kompetente. Ndërkohë që ai me përgjigjet e ti tregohet pikërisht i pakulturuar, i pa kompetent. Edhe kjo është e patolerueshme dhe nuk është në etikën e gjuhës parlamentare.

Nëse nuk është në gjendje për të dhënë përgjigje, të mos gjuhet, që unë s'qenkam, s'paskam kompetencë ose profesionalizëm, ose diçka. Prona është e KEK-ut, duhet ta dijë a është e uzurpuar, a ka grurë a nuk ka? Unë kam shkuar atje, e kam parë që ka uzurpim të pronës...

KRYETARI: Deputete, urdhëro për pyetjen e dytë.

KYMETE BAJRAMI: I nderuar ministër i Infrastrukturës!

Rrugët magjistrale Prishtinë - Mitrovicë dhe ajo Prishtinë - Pejë, janë rrugë që kanë filluar qe disa vite. Qytetarët e Kosovës do të ishin shumë më të kënaqur që Qeveria të fillonte më pak projekte dhe të njëjtat t'i përfundonte me kohë.

Siç e dini në buxhetin e vitit 2012 ka pasur mjete të ndara për këto dy rrugë dhe nuk janë shpenzuar të tërat. Po ashtu në buxhetin e vitit 2013, Qeveria ka ndarë 14.3 milionë për zgjerimin dhe rehabilitimin e rrugës magjistrale Prishtinë-Mitrovicë dhe ka ndarë rreth 9 milionë për zgjerimin dhe rehabilitimin e rrugës magjistrale Prishtinë-Pejë. Përkundër kësaj, punimet në këto dy rrugë nuk kanë filluar ende.

Pyetja është, kur do të fillojë puna e lënë gjysmë në këto rrugë dhe a pritet që në këtë vit të kryhet punë për aq sa ka mjete buxhetore?

KRYETARI: Ministër Mujota, e ke fjalën!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Bajrami,

Rrugët nacionale kanë rëndësi jetësore në secilin vend dhe për secilën shoqëri dhe nuk mund të mendohet zhvillimi dhe modernizimi i një vendi pa ndërtimin, zgjerimin dhe modernizimin e infrastrukturës në tërësi, ndërsa për atë të infrastrukturës rrugore në veçanti.

Bazuar në këtë, Qeveria e Republikës së Kosovës, në objektivat e saj zhvillimore e ka përcaktuar ndërtimin e rrugëve në tërë territorin e vendit tonë, përfshirë rrugët nacionale, rajonale, lokale dhe autostradat si prioritet parësor.

Ministria e Infrastrukturës po vazhdon të punojë në realizimin e një numri të madh të projekteve kapitale infrastrukturore ku hyjnë edhe zgjerimi dhe rikonstruktimi i rrugës nacionale N2 dhe N9, përkatësisht rruga Prishtinë-Mitrovicë dhe Prishtinë-Pejë.

Përkundër vështirësive ne kemi arritur që të bëjmë progres të madh në ndërtimin e segmenteve në këto rrugë dhe përkundër pengesave që ka pasur dhe do të ketë gjatë procesit të shpronësimeve të pronave të shumta të cilat janë përgjatë këtyre rrugëve.

Për informimin tuaj dhe qytetarëve tanë, dua të theksoj se segmenti rrugor në drejtim të Mitrovicës po thuaj se është përfunduar deri në Milloshevë, ndërsa këtë vit do të vijojmë zgjerimin edhe në tri segmente të reja në gjatësi prej 7,5 kilometra në drejtim të Vushtrrisë. Janë shpallur tenderë përkatës dhe po punohet në vlerësimin e ofertave. Shpresojmë do të kemi një konkurrencë të mirëfilltë për realizimin e këtyre projekteve.

Po kështu, në vitin 2012 kanë përfunduar po thuaj se të gjitha punimet në zgjerimin e rrugës nacionale N9 deri në fshatin Gjurgjicë, lidhja me autostradën, ndërsa janë edhe disa punë finale në sektorin C Loti-1 në Komaran dhe sektorit C Loti-3 në Gjurgjicë, shtresa finale e asfaltimit. Edhe në këtë rrugë sivjet do të vazhdojmë zgjerimin me tri segmente të reja në gjatësi rreth 8 kilometra, duke i ofruar komunës së Klinës, ndërsa në të ardhmen, sipas mundësive buxhetore zgjerimi do të vazhdojë deri në Pejë.

Dua të theksoj se Ministria e Infrastrukturës në vitin 2012 ka realizuar buxhetin në masën 99,58%, ndërsa për rrugën N9 Ministria e Infrastrukturës vjet ka pas në disponim 7 milionë e 384 000 euro mjete të shpenzuara në tërësi, ndërsa që kemi pasur edhe 1 milion e 360 000 euro obligime të pambuluara që janë paguar nga buxheti i sivjet, ndërsa për rrugën N2 vitin e kaluar kemi pasur 1 milion e 736 mijë euro, ndërsa nga buxheti 2013 janë paguar rreth 413 000 euro obligime të mbetura nga viti i kaluar.

Të nderuar deputetë,

Dua të përmend se problemet t theksuar në secilin projekt veçmas rrugët nacionale përbën procesi kompleks i shpronësimeve. Vonesat e kompletimit të dokumenteve nga pronarët, mungesa e tyre në tërësi ndonjëherë, si dhe pakënaqësitë e tyre në disa raste me shumën e vlerësimit dhe kompensimit të cilat janë gjithsesi sfidë për ne. Përkundër këtyre, falë bashkëpunimit me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ambientit, me autoritetet lokale kemi arritur që me sukses t'i përballojmë këto vështirësi dhe të realizojmë projektet siç janë paraparë.

(Drejtmin e e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Mujota! Zonja deputete, a keni pyetje shtesë?
E ka fjalën Kymete Bajrami.

KYMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar ministër,
Shpresojmë se ato tenderët që i keni shpallur të bëhet përzgjedhja sa më shpejt dhe të fillojë puna, të shihet diçka në praktikë.

Pyetja shtesë është rreth magjistrates Prishtinë-Pejë, devijimit që po i bëhet kësaj rruge sipas të gjitha informatave, në segmentin Mleqan - Kijevë, a mund ta shpjegoni, e ka ngritur kolegu im Salih Morina javën e kaluar, a mund ta shpjegoni ju lutem pse po bëhet devijimi, sa po kushton shpronësimi i tokës në trasenë e re dhe pse ky devijim, kur të gjithë parametrat tregojnë se për buxhetin edhe të Ministrisë suaj edhe buxhetin e Kosovës në përgjithësi zgjerimi dhe rehabilitimi i rrugës kushton shumë më lirë dhe është shumë ekonomikisht më i arsyeshëm, se sa me e que rrugën tash arave dhe fushave, me ble Qeveria tokë prej militantëve dhe partizanëve politikë. A mundesh të na japësh arsyeshmërinë ekonomike të devijimit të trasesë?

MINISTRI FEHMI MUJOTA: E nderuara deputete Bajrami,
Edhe në seancën e kaluar kam dhënë një shpjegim bukur të hollësishëm rreth këtij projekti. Po ashtu dua të përsëris edhe sot se projekti nuk është çështje e ministrisë që duhet të vendosë se cilat janë parametrat teknik, cilët janë parametrat ekonomikë në kuptimin e asaj që të përzihem në punë profesionale të njerëzve. Pra, projekti dëshmon se do të realizohet sipas standardeve që kërkon rruga nacionale dhe aksi rrugor të cilës ju i referoheni dhe ne e kuptojmë shqetësimin edhe të banorëve edhe të tjerëve, është një aks rrugor i cili ka siguri shumë të vogël në kuadër të asaj që quhet numër i madh i banorëve, nxënësit që janë përreth kësaj rruge dhe po ashtu shpronësimi do të jetë shumë më i shtrenjtë se sa në pjesën ku ka vendosur projekti të shkojë. Prandaj, nuk është çështje e ministrit të vendosë se a duhet të shkojë në drejtimin, të mbajë patjetër drejtimin e rrugës ekzistuese apo të bëjë një devijim i cili është shumë më ekonomik, është shumë më i sigurt dhe mbi të gjitha do të ndikojë në cilësinë e rrugës, prandaj deri në shmangien e Kijevës, rruga sipas shpjegimeve profesionale duhet të ketë devijim të domosdoshëm nëse duam sigurinë në këto rrugë dhe nëse duam rrugë cilësore, prandaj edhe kështu do të ndodhë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Deputeti Hashim Deshishku, pyetje për ministrin Mujota.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti ministër Mujota,

Zoti ministër,

Ndërtimi i autostradës "Ibrahim Rugova" ka filluar me shumë paqartësi dhe si duket kështu, do të vazhdojë deri në fund, kurrë nuk është e bërë dhe qartë se cila do të jetë kostoja përfundimtare dhe kah do të shtrihet traseja.

Këto dilema vazhdojnë edhe sot. Ende nuk e kemi një pasqyrë të qartë se si po ecin punët në këtë projekt, sa para janë investuar deri më tani, sa kilometra kanë përfunduar, cila është kostoja për një kilometër apo për problemet e shpronësimit?

Kohët e fundit janë plasuar informata, që edhe me shumë i rritin paqartësitë. Është fjala për vazhdimin e autostradës dhe për ndryshimet që po ndodhin aty për aty. Së paku nuk kemi informatë të saktë se çfarë me standardi do të jetë autostrada nga Gjurgjica deri në Sllatinë, si do të vazhdojë nga Sllatina deri në Fushë-Kosovë, si do të dilet nga Zona Industriale në Prishtinë dhe nga zonat që kanë rëndësi për zhvillimin e energjetikës. Deri ku do të vazhdojë autostrada dhe cila do të jetë pika dalje nga Kosova, Merdari apo Mutivoda? Dilemat vazhdojnë.

Pyetja ime, zoti ministër, është: Duke pasur parasysh të gjitha këto dilema, nga ministri Mujota kërkoj përgjigje për zhvillimet e deritashme në autostradën “Ibrahim Rugova”, si dhe për vazhdimin e punimeve. Konkretisht, sa para janë investuar dhe sa kilometra kanë përfunduar? Me çfarë standardi do të jetë ajo për Gjurgjicën deri në Vragoli? A është dëmtuar standardi i autostradës dhe i korridorit me mospërfshirjen e këtij segmenti në projekt? A do të vazhdojë autostrada për Merdar apo për Mutivodë? Nëse ndryshon traseja, përkatësisht nëse autostrada vazhdon për Mutivodë, pse ka ndodhur ky ndryshim dhe cila është përparësia, në krahasim me drejtimin për Merdar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Mujota e keni fjalën për përgjigje.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputet Deshishku,

Ju falënderoj për pyetjen dhe interesimin tuaj lidhur me ndërtimin e autostradës.

Ju njoftoj që nga nisja e punimeve e deri më tani janë përfunduar dhe shfrytëzohen për qarkullim 60,4 kilometra, përkatësisht 5 segmentet e para nga Vërmica deri në Gjurgjicë, që është lidhja me rrugën nacionale M9, Prishtinë-Pejë.

Autostrada jonë ndërtohet sipas standardeve më të larta ndërkombëtare, e për këtë dëshmon edhe ndarja e çmimit të parë nga Federata Ndërkombëtare e Rrugëve në Uashington, në vitin 2012.

Këtë vit është duke punuar në segmentet 8 dhe 9, ndërsa së shpejti puna do të nisë në segmentit 7, me të cilin kompletohet autostrada sipas kontratës së aprovuar nga grupi ndërmintor dhe nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në vitin 2010.

Progresi i deritashëm dhe dinamika e punimeve janë përtej planifikimit që kemi dhe kemi avancuar me punë para afatit të paraparë.

Duhet përmendur se 5 segmentet e para janë realizuar rreth 8 muaj para këtij afati. Kemi arritur që me gjithë vështirësitë e shumta dislokimit të instalimeve, si të rrymës, ujit, kanalizimit, sistemit të ujitjes, telefonisë, kabllave optike e të tjerë dhe dislokimit të shumë varrezave, sidomos segmenti 1 dhe 2, deri tani të lëshojmë në qarkullimi 60,4 kilometra dhe për informimin tuaj ju njoftoj se nga kufiri në Vërmicë, udhëkryqi M9 në

Gjurgjicë, janë ndërtuar edhe 14 ura, me gjatësi prej 2 580 metrash, pesë udhëkryqe, 23 mbikalime, 20 nënkalime, 37 kilometra rrugë lidhëse lokale.

Nga fillimi i punimeve deri më tani janë paguar 646 milionë e 314 mijë euro, ndërsa me buxhetin e lejuar për vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2013, buxheti është 798 milionë e 916 euro.

Segmenti rrugor nga lidhja me rrugën nacionale M9 në Gjurgjicë deri në kyçjen e sesionit 7 në Bresje është segment që do të shfrytëzohet për qarkullim si rrugë ekzistuese. Ky segment ka parametra tjerë teknikë sa i takon shpejtësisë, sigurisë dhe qasjes në rrugë. Për këtë arsye, Ministria e Infrastrukturës ka bërë investime plotësuese në kuptimin e lehtësimit të qarkullimit dhe krijimit të kushteve për qytetarët e zonës, duke ndërtuar nënkalime, mbikalime dhe shtim të mburojave dhe sinjalistikës përkatëse.

Ky segment rrugor është realizuar me kontratën e zgjerimit të rrugëve nacionale dhe nuk është pjesë e kontratës së ndërtimit të autostradës.

Në kuadër të rrjetit bazik të transportit të Evropës Juglindore janë definuar drejtimet kryesore rrugore, ku përfshihet edhe korridori Prishtinë-Medar-Nish.

Pas definimit të pikës lidhëse me Serbinë, nevojitet të punohet studimi i fizibilitetit dhe ndikimi ambiental, ku do të përcaktohen përparësitë dhe mangësitë e secilit drejtim dhe tek pastaj do të pasojë vendimi dhe projekti zbatues në këtë drejtim.

Nuk ka vendim për ndryshim të korridorit, ndërsa Ministra e Infrastrukturës është e gatshme që ta japë kontributin e saj...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Deshishku?

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti ministër,

Meqenëse edhe në fillim the që është filluar autostrada, autorruga të themi ashtu “Ibrahim Rugova” me shumë paqartësi, tash ende e kam të paqartë.

Ndryshimet e trasesë që po ndodhin, a po ndodhin në bazë të projektit, që po ndryshojnë në çdo moment për momentin, apo është për interesa të buxhetit shtetëror.

Dhe e dyta, unë kam dëgjuar nëpërmjet informacioneve të gazetave dhe televizioneve, që traseja do të ndryshojë, nuk do të hyjë në Sllatinë, por do të vijojë deri në Vragoli. Sa është kjo rrugë e qëndrueshme të vijë deri në Vragoli, kur e dimë sesa fyt i ngushtë është të bëhet një autostradë deri në Vragoli? Sipas informatave që kam, është dashur të hyjë në Sllatinë, e jo në Vragoli. A është e vërtetë kjo, apo nuk është?

KRYESUESI: Zoti Mujota, e keni fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Edhe një herë dua të konfirmoj para deputetëve të Parlamentit të Kosovës, se projekti i autostradës, i rrugës nacionale nga Morina në Merdar, është zhvilluar gjithnjë sipas mënyrës ‘projekto - ndërto’. Ka pasur paqartësi rreth asaj se ka qenë projekt i detajuar. Nuk ka qenë. Ka qenë një projekt, i cili i ka përmbushur kriteret paraprake, por më tutje është punuar vazhdimisht në formën ‘projekto - ndërto’. Edhe tani ndërtohet sipas këtij standardi dhe kompania projektuese ka bërë ridizajnimin, përkatësisht projektimin sipas asaj që nënkupton kyçjen te Vragolia dhe kalimi përgjatë Zonës Industriale mbi Prishtinën dhe Fushë-Kosovën, dhe më tutje deri në Besi, ku do të përfundojë kontrata.

Devijimi që ka ndodhur në pjesën te Gazimestani, për një gjatësi afërsisht 700-800 metra, është e njohur për publikun, është e njohur për Parlamentin, se ka qenë obligim që duhet t’i përmbahemi zonës së mbrojtjes sipas Pakos së Ahtisarit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lama, pyetje për ministrin Agim Çeku. Zonja Lama, e keni fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Më 26 prill 2013, Policia e Kosovës ka arrestuar dy persona spiunë serbë, të cilët janë kapur derisa po i fotografonin objektet e FSK-së në Gjilan. Policia i kishte bërë këto arrestime, pasi e kishte marrë një informatë se nëpërmjet rrugëve operative, këta dy persona po bënë fotografimin e objekteve të FSK-së në Gjilan dhe objekteve tjera me rëndësi, si fabrika, depo e të tjerë.

Këta dy të dyshuar, shtetas të Kosovës, gjatë intervistimit nga Policia, e kanë pranuar se kanë bërë fotografi rreth objekteve të FSK-së, si dhe objekteve tjera, por nuk e kanë treguar qëllimin e tyre. Është e qartë se FSK-ja është në fokusin e shërbimeve sekrete serbe që veprojnë në Kosovë. Ruajtja e sekretit të FSK-së, e cila pretendon të bëhet Ushtri e Kosovës, është esenciale, veçanërisht tani jemi në kohën e dialogut dhe implementimit të marrëveshjes së arritur në Bruksel.

Prandaj, çfarë masash ka marrë ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në mënyrë që informacionet që lidhen me çështjet e sigurisë, me armatimin, municionin, shtrirjen, kazermat e FSK-së e të tjerë, që përbëjnë sekrete shtetërore, të mos bien në duart e agjentëve sekretë.

Zoti ministër, a keni pasur raste të tjera të ngjashme, kur ju kanë rrjedhur informata të tilla mbi FSK-në?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI AGIM ÇEKU: I nderuar kryesues!

E nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

Siguria e pjesëtarëve të FSK-së, reparteve, pajisjeve dhe informacionit në FSK është një nga prioritetet dhe detyrat kryesore të Ministrisë së FSK-së. Mu për këtë, ne kemi marrë disa masa:

E para, i kemi ngritur strukturat për mbrojtjen e informacionit dhe të reparteve të FSK-së. Në kuadër të Ministrisë vepron Departamenti i Inteligjencës dhe Sigurisë, kurse në kuadër të çdo komande të njësive deri në njësi batalioni janë sektorët e inteligjencës së sigurisë, të njohur si G2 në Ministri, apo S2 për njësi, dhe këto gjithnjë janë duke ngritur kapacitetet e tyre vepruese profesionale.

E dyta, pas ligjeve në fuqi, e kemi krijuar bazën ligjore, rregulloret e ndryshme, udhëzues të ndryshëm, elaborate të ndryshme dhe kemi bërë vlerësimin e rrezikut për çdo objekt të FSK-së dhe, së fundi, kemi marrë masa konkrete për sigurinë e pjesëtarëve, e reparteve të informacionit.

Sa i përket sigurisë së informacionit, ne jemi duke e implementuar Ligjin për klasifikim të informacioni. Në bazë të këtij ligji e kemi bërë edhe llojin, edhe listën e dokumenteve dhe informacioneve, të cilat janë të klasifikuara, duke e përcaktuar afatin e ruajtjes, mënyrën e ruajtjes, e tjerë e tjerë.

E dyta, çdo pjesëtar i FSK-së, për të qenë pjesë e FSK-së apo e Ministrisë së FSK-së duhet të pajiset me certifikatën e sigurisë, i bëhet i ashtuquajti ‘vetting’ nga njësi për ‘vettingun’ e njësive, që është në kuadër të KFOR-it.

Gjithashtu, tani kemi fillua edhe me ‘vettingun’ apo certifikatën e sigurisë për çdo operator ekonomik për kompani, por edhe për punëtorët e kompanisë, që kryejnë shërbime brenda objekteve të FSK-së.

E treta, për çdo artikull apo pajisje që duhet ta pajisim FSK-në dhe që vlerësojmë se publikimi i kriterëve, i kërkesave që kërkojnë mund ta dëmtojë sigurinë e FSK-së, prandaj kërkojmë nga Qeveria që në bazë të nenit 3 të Ligjit për prokurim publik të lejohet që të shkohet në prokurim, jo me tender publik. Është fjala për armatim, municion, pajisje speciale, mjete të komunikimit dhe disa pajisje tjera që janë më specifike dhe që vlerësojmë se do të ndikonin negativisht në sigurinë e përgjithshme, në sigurinë kombëtare apo në ruajtjen e sekretit, në qoftë se shkojmë me tender publik.

Dhe, këto janë disa masa për mbrojtjen e informacionit.

Tjetër, masat për mbrojtjen e pjesëtarëve, të reparteve, kemi vendosur çdo objekt i Ministrisë së FSK-së është i rrethuar me tela gjemborë, çdo objekt është i pajisur me vëzhgimore, me vrojtore, çdo objekt është i ndriçuar, para çdo objekti janë vendosur shenjat ku shihet qartë se është i ndaluar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Po besoj se dekonspirove mjaft. Zonja Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit!

Jo nuk është dekonspiruar tamam. Në fakt, nuk iu përgjigj pyetjes së dytë që bëra. A keni pasur raste të tjera të ngjashme, kur ju kanë rrjedhur informata të tilla për FSK-në.

Zoti ministër, ju nuk na raportuat këtu të vërtetën, sepse e keni pasur një rast tepër skandaloz, kur zëvendësministri juaj nga radhët e komunitetit serb, Slavisha Filipović, është kapur duke dërguar informacione në Beograd në lidhje me armatimin e FSK-së. Nuk besoj se mund ta mohoni këtë. Kjo është një vepër penale. Kodi Penal i Republikës së Kosovës në nenin 131 për veprën e spiunazhit thotë kështu: Kushdo që sekretin shtetëror ia komunikon, ia dorëzon apo ia bën të arritshme shtetit të huaj, organizatës së huaj apo personit që u shërben atyre, dënohet me burgim prej 5 deri në 12 vjet burg. Neni është shumë i gjatë dhe i parasheh të gjitha këto situata të mundshme.

Në fakt, ajo që bëtë ju tani, ose çfarë keni bërë, keni bërë moskallëzim të krimit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti ministër, në përputhje me ligjin mund të flasësh.

MINISTRI AGIM ÇEKU: Në radhë të parë, këta dy persona që janë gjetur duke filmuar janë vërejtur nga pjesëtarët e FSK-së dhe pjesëtari i FSK-së ka qenë ai që ka shkuar në Polici, i ka paraqitur, dhe Policia ka vepruar.

Në rastin konkret, është e vërtetë që strukturat tona përgjegjëse kompetente gjithashtu e kanë vërejtur një korrespondencë, shkëmbim e-mail-ash të zëvendësministrit, me një zyrtar të një partie politike në Beograd dhe në atë shkëmbim e-mail-ash kemi vlerësuar se nuk ka zbulim të sekretit.

Kështu, kjo dëshmon se ne jemi në ngjarje, e kemi zbuluar vetë. Kemi bisedua me zëvendësministrin dhe kemi vlerësuar se nuk është zbulim i sekretit të FSK-së.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Tani ishit më të saktë. Deputeti Halit Krasniqi, pyetje për ministrin Fehmi Mujota.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Sot dua ta drejtoj një shqetësim te ministri i Infrastrukturës për një pjesë të qytetarëve të Kosovës, pas shqetësimeve që u shtruan këtu për qytetarët e Kijevës dhe të fshatrave përreth në aksin jugor, që është planifikuar dhe ku janë ngrehur këto shqetësime, dhe pas sqarimeve për aksin e autostradës, i vjen radha një shqetësimi të qytetarëve në aksin rrugor Klinë-Pejë, kryesisht pas urës së Drinit, aty përnjëherë në Zajmovë, meqë në vërshimet e fundit kishim natyrisht probleme, të cilat u manifestuan me ujën e

grumbulluar në atë sipërfaqe të një pjese të fshatit dhe vërshimin e shtëpive përdhese dhe kateve nën dhe, të cilat e dëmtuan amvisërinë e qytetarëve dhe pajisjet tjera me mobilieri, dhe të cilat u shkaktuan dëme të mëdha qytetarëve dhe tani shqetësimi i tyre ka mbetur pezull.

Një pjesë e tyre edhe nuk mund t'i përtërijë ato amvisëri dhe pajisje mobilieri, kurse një pjesë tjetër që mund ta bëjnë këtë nuk guxojnë ta bëjnë një gjë të tillë, sepse dyshojnë në vërshimet e reja të mundshme. Për këtë arsye, një pjesë e fshatarëve, e qytetarëve të familjes Hoti dhe të tjerë, më kanë sensibilizuar që ta ngre këtë shqetësim para Qeverisë, përkatësisht para ministrit të Infrastrukturës, që t'i drejtohem me një pyetje parlamentare këtu.

I nderuar ministër, a ka mundësi të hapet një nënkalim në atë sipërfaqe, sepse për banorët...

KRYESUESI: Zoti Mujota, e keni fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Krasniqi,

Unë e vlerësoj shumë interesimin tuaj rreth shqetësimeve të shfaqura pas vërshimeve që kanë ndodhur ditë më parë në komunën e Klinës.

Ministria e Infrastrukturës e ka analizuar këtë çështje dhe me ndihmën e qytetarëve do ta ngrejë një komision profesional, në të cilin do të përfshihen edhe zyrtarët e Komunës së Klinës dhe zyrtarët e Ministrisë së Ambientit.

Komisioni sigurisht do të ofrojë një zgjidhje teknike për ndërtimin e lëshesës dhe zgjidhjes së problemit të rrjedhës së ujit deri te lumi Drin.

Por, i nderuar deputet, duhet theksuar se edhe në të kaluarën ka pasur dy lëshesa në këtë aks rrugor, të cilat janë mbyllur nga vetë banorët nga ndërtimet që kanë ndodhur në këtë zonë. Prandaj, këtu kërkohet ndihma, edhe e banorëve, por edhe e autoriteteve të lokaleve të Ministrisë së Ambientit për t'i dhënë një zgjidhje kësaj çështjeje që është paksa e ngutshme.

Pas vlerësimit të komisionit, të të gjitha institucioneve që duhet përfshihen në këtë, ne do t'i japim një zgjidhje të shpejtë këtij problemi, i cili shpresojmë të mos jetë me pasoja në të ardhmen, pas vërshimeve që ndoshta mund të ketë në situata të caktuara. Sidoqoftë, në këtë aks rrugor dhe në shumë akse tjera rrugore problemet shkaktohen, në të shumtën e rasteve, nga ndërtimet që nuk janë sipas standardeve dhe shpeshherë jo në përputhje me rregullat dhe procedurat e urbanizmit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Krasniqi?

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministër,

Në përgjigjen tuaj kishte korrektësi të plotë dhe duke shpresuar, edhe unë, edhe qytetarët, në korrektësinë tuaj, këtë problem shpresoj që do ta trajtoni në Qeveri dhe do t'i ndani mjetet e nevojshme për ta bërë të mundur që ky ujë të ecën përtej asfaltit, e të mos ngelë në sipërfaqen e shtëpive aty, meqë ka mundësi t'i dëmtojë përsëri. Dhe, unë shpreh edhe besimin e qytetarëve në korrektësinë tuaj dhe në përkushtimin tuaj me shpresë se kjo vepër e mjaftueshme, sado e vogël që është, por e madhe për qytetarët, do të kryhet nga Ministrisë juaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Krasniqi! Deputeti Liburn Aliu, pyetje për ministrin Besim Beqaj.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Më 15 prill 2013, ministrit të Zhvillimit Ekonomik, zotit Besim Beqaj, i kemi kërkuar që në bazë të Ligjit për qasje në dokumentet publike në Kosovë, konkretisht sipas dispozitave të nenit 4, paragrafi 1, në lidhje me paragrafin 2 të Ligjit 03/O-215 për qasje në dokumentet publike në Kosovë, si dhe të nenit 13, paragrafi 2 të Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve, të na njoftojë dhe të kemi qasje në listën e aseteve që do të kalojnë në pronësi të konsorciumit “Çalik&Limak”.

Më herët, koalicioni i shoqërisë civile po ashtu nuk kishte lejuar ta shohim dhe regjistrojmë listën e këtyre aseteve.

Kompania kosovare për Distribuum dhe Furnizim do të kalojë në menaxhim të “Limak&Çalik” në fillim të këtij muaji. Pyetja: Ministër, a mund të na tregoni se cilat asete do të kalojnë në pronësi të konsorciumit “Çalik&Limak” si rrjedhojë e procesit të privatizimit të kompanisë kosovare për Distribuum dhe Furnizim? Pra, meqenëse çmimin e dimë, do të donim ta dinim edhe cilat janë asetet.

KRYESUESI: Zoti ministër Beqaj, e keni fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Deputet Aliu,

Unë edhe më herët kam bërë sqarime rreth procesit të privatizimit dhe obligimet të cilat dalin nga ky proces i privatizimit, obligime të cilat janë që asetet e rregulluara sipas Rregullatorit transferohen, që janë pronë e furnizuesit publik.

Lista është shumë e gjatë, të cilën mund ta shohë secili prej jush. Nuk është e vërtetë që shoqëria civile, përfaqësuesit e GAP-it kanë qenë dhe nuk i kanë parë.

Dokumentet të cilat nuk janë ende të aprovuara si të tilla, nuk mund të merren për shfrytëzim dhe kopjim, por përfaqësuesi i shoqërisë civile ka pasur qasje, ka mundur t'i shikojë. Edhe ju mund të vini dhe t'i shikoni të gjitha asetet. Por, po ju them edhe një

çështje edhe një herë, që asetet të cilat janë të rregulluara nga Zyra e Rregullatorit të Kosovës, të cilat i dedikohen furnizuesit publik, për më tepër prapë, po ju them, ejani, urdhëroni, shikoni. Derisa të bëhen publike, derisa të jetë dokument me fuqi të dokumentit publik, por si deputetë dhe si të tjerë, aq sa na lejon më ligji për qasje në dokumentet, të cilat janë të papërfunduara, mund të vini t'i shihni, por jo t'i merrni dhe t'i kopjoni. Kjo është forma konform ligjit se si mund të qaseni.

Dhe një informatë më shumë, asetet të cilat do të jenë në proces, pra të cilat do të transferohen, ato nuk transferohen me të drejtë të shitjes. Këtë e kam thënë disa herë. Sepse, nga shitja e këtyre aseteve në të ardhmen, shuma e marrë nga këto asete do t'u kthehet qytetarëve nëpërmjet tarifave energjetike. Prandaj, po ju lus edhe një herë - mos tentoni të manipuloni qytetarët se është bërë shitja e aseteve. Asetet janë në pronë të furnizuesit publik dhe furnizuesi publik, në këtë rast kompani për Distribucion, e ka për obligim të vet furnizimin me energji elektrike për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe në rast se nuk i plotëson këto, atëherë i merret licenca dhe në rast se dëshiron t'i shesë këto asete, të cilat nuk e dëmtojnë funksionin, ato mjete do t'u kthehen qytetarëve nëpërmjet tarifave, të cilat janë të parapara në Zyrën e Rregullatorit për Energji Elektrike.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Aliu?

LIBURN ALIU: Në gazetën “Zëri” është publikuar një listë e aseteve, ku përmendet ndërtesa e “Elektrokosovës” në Prishtinë, me 10 703 metra² dhe 34 arë tokë. Depoja qendrore në Zonën Industriale në Prishtinë me një sipërfaqe prej 4 hektarësh, 53 arë e 29 metra katrorë. 7 objekte në qendrat kryesore të Kosovës, 19 objekte të nëndistrikteve, 33 trafo aktive të tensionit 35/10 kilovolt, 7 000 trafo të tensionit 10/04 kilovoltë, 21 mijë kilometra përçues ajrorë dhe nëntokësorë.

Po më intereson pyetja konkrete për këto asete të cilat janë në këtë listë, a janë tani në pronësi të “Limak&Çalik”, se do të doja ta dija, ta zëmë, për Turqinë, a po e zhvat dhe sa po e zhvat edhe ajo këtë vend, duke e shfrytëzuar këtë situatë politike, kur edhe ju si ministër, edhe kryeministri, është një dobësi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti ministër Beqaj, e keni fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: I nderuar deputet,

Unë nuk do ta përdor gjuhën të cilën ju e përdorini si parti politike, sepse është e drejtë juaja. Unë po flas me dokumente zyrtare, po flas me dokumente të cilat janë të verifikuara dhe keni mundur t'i shikoni. Pra, nuk është e vërtetë ajo që po pretendohet të thuhet që nuk ka qasje në dokumentet. Ka qasje, mund të shihen dokumentet. Unë nuk flas me dokumente, të cilat bëhen në mënyrë parciale publike nëpërmjet medieve të ndryshme. Unë po e them edhe një herë që asetet të cilat transferohen nuk transferohen me të drejtën për shitje, sepse janë për shfrytëzim të furnitorit publik, të furnizuesit publik, i cili nënkupton që në rast se ato asete dëshiron t'i shesë, fillimisht duhet ta marrë aprovimin nga Qeveria.

Dhe e dyta, pas këtij aprovimi, ato duhet t'u kthehen në formë të tarifës qytetarëve, të cilat janë të rregulluar sipas rregullave të Zyrës së Rregullatorit. Kjo është esenca, ky është realiteti, nëse doni ta kuptoni, e kuptoni, nëse nuk doni është diçka tjetër. Pra, nuk flasim as për falje të aseteve, nuk flasim as për sa kilometra, sepse nëse i heqim këta kilometra, atëherë kthehemi në kohëra tjera. Dhe ende nuk janë transferuar këto.

Kompania e cila do t'i marrë këto asete, do të jetë e obliguar për furnizim publik të qytetarëve të Republikës së Kosovës sipas Rregullatorit dhe rregullohet nga Rregullatori, që nënkupton se për çdo veprim jashtë bazës së licencës si furnizues publik atij mund t'i merret licenca pa kompensim. Këto janë pushtetet e kontratës.

KRYESUESI: Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Albin Kurti, pyetje për ministrin Beqaj.

ALBIN KURTI: Në emisionin "Interaktiv" në KTV, më 16 prill 2013, në pyetjen se a ka aksionarë vendorë, a ka kyçje vendore në "AXOS" dhe "Najafi", ministri Beqaj u përgjigj: Ne në Komitetin qeveritar për privatizim, që janë 5 ministri dhe që është një këshilltar i transaksioneve dhe një këshilltar strategjik, i kemi këto tri kompani, të cilat janë të listuara dhe nuk e kemi asnjë informatë tjetër zyrtare, prandaj të gjitha tjerat janë gjëra për të cilat as nuk kemi informatë, as nuk mund t'i dimë se kush mund të jetë.

Pyetja është: Ministër Beqaj, a nuk mendoni se jeni disi tepër i painformuar për këtë proces, e në këtë proces kaq të rëndësishëm, siç është ky i privatizimit dhe 75% të aksioneve të Telekomit.

KRYESUESI: Zoti ministër Beqaj, e keni fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar deputet Kurti,

Sigurisht që citimi ka mundur të jetë pak më i saktë. Sido që të jetë, unë mund ta parafrazoj prapë citimin tim dhe e kam bërë publike edhe atë ditë, e kemi diskutuar shumë gjatë këtë çështje. Shteti dhe institucionet nuk bazohen në informata, të cilat mbledhen nga burimet jozyrtare, kuluare të ndryshme, qofshin ato media, qofshin ato kafene të rrugëve, apo qofshin edhe vende tjera, restorante serioze, të cilat mund të rrjedhin si të tilla, por ne punojmë mbi parimin e dokumenteve zyrtare, të cilat janë paraqitur. Për më tepër, e kam thënë edhe më herët dhe po e them edhe sot, asnjë dokument zyrtar në asnjë rrethanë nuk e paraqet asnjë aksionar tjetër, përveç aksionarëve të cilët janë të dekretuar konform dokumenteve për parakualifikim dhe që janë "AXOS", bashkë me "Najafi", në përkrahje të teknike të "British Telecom"-it dhe kjo është konfirmuar. Për më tepër, këto kompani kanë obligim që 4 vjet të mbajnë 51% të aksioneve të veta, gjithmonë duke e ruajtur natyrën në katër vjetët e ardhshme të këtij funksionimi.

Edhe një herë po ju them, kjo është e vërteta zyrtare, ndërsa për ato, qofshin informata, të cilat vijnë nga kuluaret e caktuara, sigurisht që ju mund ta keni rrugën për t'i trajtuar, por

unë po ju them atë çka është zyrtare dhe ministri dhe shteti nuk flasin në bazë të thënave dhe gojëdhënave, por në bazë të dokumenteve.

KRYESUESI: Pyetje shtesë, zoti Kurti?

ALBIN KURTI: Ministër, ju m'u përgjigjët në një pyetje që nuk jua bëra. Nuk është çështja ku informohem unë, po pse ju jeni të painformuar. Pra, nuk është këtu çështja ku po informohem unë, por pse ju jeni kaq i painformuar. Tri herë e kam kontrolluar citimin, është i saktë. Ju thoni: "Nuk kemi asnjë informatë tjetër zyrtare, prandaj të gjitha gjërat, ato janë gjëra për të cilat as nuk kemi informatë, as nuk mund t'i dimë se kush mund të jetë". Unë nuk e kam hallin se ku po informohem vetë tash, e kam hallin pse ju nga pozita e ministrit jeni kaq të painformuar dhe mos m' përgjigjini në pyetje që nuk ua bëj. Dhe, mos flitni për restorante serioze, joserioze, sepse duhet të jeni më serioz ju vetë.

KRYESUESI: Zoti Beqaj, e keni fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë dhe institucionet shtetërore i marrim informacionet nga baza ligjore nëpërmjet institucioneve të rregullta, nëpërmjet konfirmimit të rregullt të dokumentacionit paraprak, në bazë të kriterëve të cilat janë parashikuar e nuk e marrim informacione në bazë të thashethemeve, edhe një herë po e them.

KRYESUESI: Zoti Kurti, prapë pyetje për ministrin Beqaj.

ALBIN KURTI: Në emisionin "Interaktiv" në KTV, më datën 16 prill 2013, në pyetjen se a i dini njerëzit që janë aksionarë në "AXOS", kush janë ata në Gjermani, ministri Besim Beqaj, tha: "Neve nuk na intereson ta dimë tani për aksionarët e 'AXOS'-it, ata mund të jenë të shumtë, por e dimë që kjo kompani është regjistruar në Gjermani, kompani e cila ka arritur të ngrejë para në nivel të caktuar për këtë proces, por edhe në proceset e mëhershme dhe ne dëshirojmë të besojmë dhe jemi të thirrur t'u besojmë të dhënave zyrtare, të cilat janë bërë nën deklaram, nën betim". Ministër Beqaj, Telekomit është ndërmarrje fitimprurëse publike, pasuri kombëtare dhe interes strategjik shtetëror.

Prandaj, si është e mundur që jeni indiferent për prejardhjen dhe për bërjen e kapitalit të blerësve, si dhe për identitetin e tyre?

KRYESUESI: Zoti ministër Beqaj!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit shumë për pyetjen, sepse kjo do të na ndihmojë t'i qartësojmë te qytetarët të gjitha këto shqetësime, të cilat po na vijnë, shqetësimet të cilat mund të kenë ndonjë bazë të caktuar, dhe ajo bazë duhet të na tregohet. Unë po flas edhe një herë në bazë të dokumentacioneve të cilat i kemi, dhe në bazë të parakualifikimeve të cilat i kemi bërë më herët. Kanë qenë tri kriterë themelore. Kriteri themelor, nën një, ka qenë që të jetë ose operator telekomit kompania, që mund të parakualifikohet, ose fond investiv me përvojë, apo edhe fond investiv në partneritet me dikë tjetër. Unë edhe një herë po e them se po dëgjoj këtu edhe kush janë, sepse është

“AXOS Capital”, me pronarë të prezantuar. Unë nuk di për aksionarë të tjerë, nuk kam as informacion zyrtar, e nëse ju e dini dhe nëse keni informacione burimore, urdhëroni shkoni dërgoni atje. Është “Najafi”, që i ka disa pronarë dhe në kuadër të këtij konsorciumi është “British Telecom”. Prandaj, kjo është e vërteta. Tash ju mund të thoni cilat janë opsionet tuaja në kokën tuaj, por nuk është e përfunduar. Unë jam mirë i informuar mbi bazën e informatës zyrtare dhe të verifikuar.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Kurti?

ALBIN KURTI: Ministër, nëse ky është informimi, atëherë ne nuk mund ta kuptojmë më mosinformimin. Ky është pikërisht përkufizimi i mosinformimit dhe “AXOS”-i është fond investiv. Ata menaxhojnë kapitalin e të tjerëve. Pyetja ime, në të cilën sërish nuk u përgjigjët, është: Përbërja, prejardhja e kapitalit dhe identiteti i blerësve? Kjo është çështja.

Unë ju citova në emisionin tuaj, prandaj do të duhej të përgjigjeshit në pyetjen që jua bëra, e jo sërish përgjigje në pyetjet që nuk ua bëra. Mund të bëjë edhe pyetje tjera, por aman përgjigjuni në këtë pyetje, jo në të tjera. Na kurseni nga përgjigjet në pyetjet që nuk jua bëra.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqaj!

MINISTRI BESIM BEQAJ: I nderuar deputet!

Unë u përgjigjem pyetjeve sipas bazës ligjore, e jo sipas dëshirës së askujt. Pyetjet të cilat bëhen, janë pyetje të cilat janë me fokus. Ju keni kërkuar cilat janë kompanitë, të cilat e kanë privatizuar, unë u jam përgjigjur, cilët janë aksionarët e “AXOS”-it, ju thashë që është kompani, e cila me aksionarë Jan Buden, kemi kompaninë tjetër, e cila është “Najafi Kompani”, është prapë një kompani nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në bashkëpunim me “British Telecom”. Për të gjitha ato ide tjera, të cilat mund të rrjedhin, po e them, me të vërtetë nuk informohem në bazë të informacioneve të pakonfirmuara. Ky është roli i informimit, ndërsa çështja e informimit, nëse hyn te definicioni i informimit, do të jua jap edhe unë një definim të informimit. Informimi është për atë që dikush ka mundësi dhe bazë ligjore për ta ndarë informacionin dhe gatishmërinë e tjetrit për ta kuptuar realitetin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri, pyetje për ministrin Beqaj.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Po e marrë të drejtën ta ndryshoj renditjen e pyetjeve, meqenëse lidhet me temën që u shtrua deri tash. Pra, të dyja pyetjet që i kam janë për ministrin Beqaj dhe janë për çështjen e njëjtë, dhe po e vazhdoj me pyetjen e njëjtë.

Pra, prej 16 prillit, kur Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që 75% të aksioneve të PTK-së t’ia shesë konsorciumit të kryesuar nga “AXOS Capital”, ku është edhe “Najafi” dhe si partner strategjik thuhet se është edhe “British Telecom”. Vetëm një qartësim këtu, për shkak se e përmenda, ne e kemi pasur si komision një takim me “British Telecom”.

“British Telecom” nuk është aksionar, është kompani që ofron shërbime teknike profesionale për konsorciumin, në bazë të kërkesës. Kështu e kanë thënë ministër, përfaqësuesit e “British Telecom”. Mbase ti po dije më shumë se ata.

Pyetja ime ka të bëjë me atë, ministër Beqaj, a mund të na tregoni kush janë aksionarë prapa konsorciumit “AXOS Capital” dhe prapa “Najafi”-t?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqaj e keni fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Po them edhe një herë faleminderit për pyetjen, sepse qytetarët kanë pasur nevojë që të dëgjojnë shumë e shumë herë, derisa ta kuptojnë me të vërtetë këtë çështje. Sa i përket “British Telecom”-it, unë në prononcimet e mia dhe në dokumentacion e kam thënë shumë qartë, zoti deputet, që është i përkrahur teknikisht nga “British Telecom”-i. Edhe kjo është në dokumente. Unë jam shumë i saktë në adresimin të cilin flas, ndërsa sa i përket se kush është prapa aksionarit, po e them edhe një herë - Qeveria dhe as unë personalisht, as ministri, nuk merret me prapaskena dhe paraskena. Nen merremi në bazë të dokumentacionit zyrtar, i cili na është adresuar. “AXOS”-i dhe “Najafi” janë në konsorcium të përkrahur teknikisht nga “British Telecom”-i.

KRYESEUSI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Ymeri?

VISAR YMERI: Faleminderit, zoti kryesues!

Vetë Qeveria, e edhe ministri, disa herë e kanë theksuar që privatizimi i PTK-së është një prej privatizimeve më të rëndësishme strategjike, apo jo? Strategjike domethënë një lloj strategjie afatgjate për zhvillimin e vendit dhe në këtë pikë neuralgjike të strategjisë të zhvillimit të vendit, ministri po thotë që mua nuk më intereson se kush e bën atë zhvillim. Kjo është tepër brengosëse. Unë nuk mendoj se një Qeveri e tillë mund ta dëshmojë që është përgjegjëse kur flet kështu.

Çështja e dytë është: Në gazetën “Zëri”, më 23 prill 2013, Lavdim Hamiti ka thënë që sipas informatave, të “Zërit”, që Xhejms Pardju i është thënë nga kryeministri Thaçi se ai dyshon pra që kompania gjermane “AXOS” mund ta kompletojë procesin e ofertimit për privatizimin e PTK-së për shkak të, siç ka thënë zoti Thaçi, aksionarëve të dyshimtë shqiptarë. Pra, a e keni pyetur ndonjëherë kryeministrin se kush janë këta aksionarë të dyshimtë shqiptarë, me qenë se ai po i dika, e ti nuk po i dije. Do të ishte mirë të ishe informuar nga ai.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e thashë shumë herë, por çështja e fjalës publike duhet ta ketë peshën e vet dhe po e them edhe një herë: neve na intereson dhe unë po flas në bazë të dokumentacionit, ndërsa ju po flisni diçka që keni dëshirë për ta thënë dhe keni dëshirë të vërtetohet teza juaj, prandaj në atë kontest unë nuk mund të ju përgjigjem dëshirave tuaja dhe kërkesave tuaja, për të imagjinuar diçka për të cilën unë nuk kam informacion. Ndërsa sa i përket pyetjes rreth takimit, apo rreth atyre gjërave, të cilat po i thoni ndërmjet takimit të kryeministrit

dhe Xhejms Pardju, unë nuk kam informacion të tillë, prandaj mund ta pyetni dike tjetër. Por, po them që konsorciumi në fjalë është konsorcium, i cili është dashur të kalojë nëpër filtra edhe nëpër vendet e tyre, edhe nëpër vendet tona. E kemi pasur një proces plotësisht transparent ligjor, i cili ka sjellë deri këtu. Tash prioritetet politike janë të natyrave të ndryshme të partive politike, sigurisht që dallojnë. Është mirë që dallojnë, sepse e pasurojnë ambientin në të cilin jetojmë.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetja tjetër e zotit Ymeri, sërish për ministrin Beqaj.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Nuk është këtu çështja e agjendave politike, por besoj mbase këtu edhe ku dallojmë, ne dhe ju, është që ne e duam një Kosovë republikane, e cila ndërtohet nga populli dhe në bazë të interesave të popullit, në ndërkohë që ju e doni një Kosovë sipas interesave tuaja dhe klaneve tuaja. Dhe, këtu po. Këtu kemi dallime goxha të thella me ju. Pra, është dallimi te qasja ndaj shtetndërtimit. Ne duam shtetndërtim, ju doni ta shkatërroni shtetin. Ky është dallimi.

Po ashtu, nga një deklaratë e Qeverisë, që është publikuar pas marrjes së vendimit për privatizimin, keni thënë, ndërmjet tjerash, ose është thënë në deklaratë, tash nuk e di a keni thënë ju, por po ju pyes juve, që është deklaruar se edhe shtetet e origjinës së këtij konsorciumi, pra konsorciumit “AXOS”, meqenëse janë tri kompani, atëherë janë tri shtete: Gjermania, SHBA-të dhe Britania e Madhe, kanë dhënë garanci për kredibilitetin e këtyre investitorëve, apo jo? Dua të di, çfarë garancish keni marrë nga këto shtete dhe në çfarë forme kanë garantuar ato?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqaj e keni fjalën!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryesues!

I nderuar deputet,

Para se të përgjigjem për garancitë, ju thatë që ju jeni për një shtet të mirëfilltë dhe dallimi ndërmjet nesh dhe jush është që ne po e bëjmë shtetin, ndërsa ju po flisni për gjëra, të cilat kanë kaluar shumë më herët dhe kur keni pasur mundësi të argumentoni. Prandaj, në këtë kontest, në kontestin politik, sigurisht se nuk jemi në rrafsh të barabarta. Është e vërtetë. Ndërsa ju po thoni se ne nuk i njihni këto vendime. Edhe ajo është e vërtetë, sepse ju nuk e njihni as Kushtetutën, as flamurin e këtij vendi, por jeni në Kuvend, punoni sipas kësaj Kushtetute, punoni sipas këtyre institucioneve, të cilat i ka formuar ky Kuvend. Prandaj, në atë kontest as që dua të tentoj të ju bind për atë, sepse është çështje të cilën ju e dini vetë. Ndërsa sa u përket garancive, duhet të ju them që në ekonominë e tregut, garanci shtetërore nuk jepen nga shtetet për investimet private, por e dini shumë mirë që deklaratat e shteteve, të cilat kanë qenë të involvuara, kanë bërë prononcime publike. Këto prononcime publike, po flas se si funksionon shteti, nuk bëhen pa pasur shteti informacion të plotë mbi atë se çka ka ndodhur dhe pse po ndodh, dhe pse shteti interesohet për një kompani. Për ne ka qenë shumë e rëndësishme dhe shumë reputative që të tri ambasadat, të cilat i kanë interesat e ndërmarrjeve të tyre, kanë qenë të interesuara dhe e kanë përshëndetur si proces transparent, si proces të plotfuqishëm, si proces i cili i hap rrugë ekonomisë drejt ekonomisë së tregut.

Prandaj, këto janë format dhe kjo është reflektuar edhe në një takim tjetër, i cili ka ndodhur atyre ditëve, pas privatizimit, ndërmjet ministrit Hoxhaj dhe ministrit të jashtëm, Vestervelle, kur është mirëpritur në mënyrë të fokusuar konsorciumi në fjalë për privatizimin e kësaj kompanie. Prandaj, po e them edhe një herë, shtetet serioze nuk flasin publikisht në emër të qeverive të tyre pa pasur garanci paraprake.

KRYESUESI: Faleminderit? Pyetje shtesë, zoti Ymeri?

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Më shumë si lloj komentit sesa pyetje. Tash ministri filloi të flasë, domethënë në njëfarë mënyre ta përmbledhë sipas mendjes së tij atë çka është Lëvizja “Vetëvendosje” dhe çfarë qëndrimi ka Lëvizja “Vetëvendosje” ndaj shtetit të Kosovës. Mendoj që nuk ka nevojë për ta komentuar këtu për shkak se nuk e shoh si njeri të aftë për ta kuptuar atë çka e themi ne shumicën e kohës. Sa u përket garancive, ky vetë e dëshmoi se nuk ka garanci. Pra, vetë e tha se nuk ka garanci, edhe pse Qeveria më herët ka thënë nëpërmjet komunikatave të tyre publike që edhe këto shtete kanë garantuar dhe tash mirë që e paske kuptuar çka është garancia në ekonomi. Po të përgëzoj për këtë avancim intelektual tëndin. Dhe, nuk paska garanci në ato shtete?!

KRYESUESI: Zoti Beqaj, urdhëroni!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Vetëm edhe unë sa për koment, jo për t’u përgjigjur. Aftësia intelektuale dhe profesionale për të vlerësuar për dikë, duhet të jetë së paku i barabartë me dikë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Vesna Mikiq, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi. Ministri nuk është këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen? Urdhëroni!

VESNA MIKIĆ: Ne. Sačekaću ipak da gospodin ministar bude prisutan.

KRYESUESI: Në rregull. Atëherë konstatoj se pika me pyetje për ministrat, pyetjet parlamentare është shteruar. Kalojmë në pikën e tretë:

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Të nderuar deputetë, a keni vërejtje lidhur me procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 25 prill? Në sallë janë 76 deputetë. Vërejtje nuk ka. Atëherë konstatoj që procesverbali miratohet pa vërejtje.

Para të shkojmë në pauzë prej 10 minutave ose më pak, ju kish lutur që grupet parlamentare, respektivisht kryetarët e grupeve parlamentare ta kenë parasysh që menjëherë pas seancës solemne, që e kemi në orën 12:00, është votimi lidhur me marrëveshjen e Grupit Parlamentar të pakicave dhe do të, nuk janë shumica e deputetëve brenda në sallë.

(Reagim)

Mirë, në qoftë se hyjnë brenda, unë e hedh në votim menjëherë, nuk ka ndonjë problem. Atëherë kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Miratimi i marrëveshjes së deputetëve nga radha e komuniteteve joshumicë dhe zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit nga këto komunitete

Ne e dimë që për të gjithë deputetët, kjo është kategori kushtetuese, nuk është përzgjedhje veçanërisht e deputetëve që nuk kanë të bëjnë me këtë çështje, prandaj marrëveshja dhe protagonistët që propozohen nga grupet parlamentare përkatëse janë valid.

Ju lus që të bëjmë votim për praninë. Votojmë tash! Në sallë janë 79 deputetë, në fakt janë 81, u bënë 88.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim për marrëveshjen. Votojmë tash! Faleminderit!

Me 76 vota për, 6 kundër, një abstenim, konstatoj që Kuvendi e zgjodhi zotin Rasim Demiri nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radha e komuniteteve tjera që nuk janë shumicë, joserbe, nga data 1.4.2013 deri me 30.9.2013, pastaj vazhdon sipas marrëveshjes ndërmjet komuniteteve të radhës. Faleminderit!

I kemi 10 minuta pauzë. Ju kisha lutur të mos qëndroni më shumë se 7 minuta për shkak se duhet të bëhemi gati t'i presim mysafirët. Faleminderit!

* * *

*Vazhdimi i mbledhjes pas mbledhjes solemne
Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.*

Vazhdojmë me seancën e filluar paradite.

Pika e pestë e rendit të ditës është:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës jashtë vendit

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, jashtë vendit dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Punë të Jashtme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, deputetin Ahmet Isufi, që ta arsyetojë raportin me rekomandime, në qoftë se dëshiron. Zoti Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Janë plotësuar të gjitha kushtet që të aprovohen amendamentet të cilat janë amendamentuar në komision, të përkrahura nga komisionet tjera dhe vetëm duhet ta bëjmë votimin në Parlament. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani vazhdojmë miratimin e amendamenteve një nga një. Kuorum ka.

Amendamenti 1.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

E votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë, tani. Ju lus votoni të gjithë. Votojmë edhe një herë. Në sallë janë 64 deputetë, votojmë për prezencën sepse, sipas rekomandimit që na i ka dhënë Gjykata Kushtetuese, në qoftë se nuk votojnë mbi 60, domethënë 61, atëherë mund ta kontestoj dikush. Votojmë për prezencën edhe një herë, pra.

62 deputetë janë në sallë, ju lus që të votojmë tani dhe një herë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

Atëherë, konstatoj se me 63 vota me kartelë, një pa kartelë, Kuvendi e miratoi Ligjin për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit. Faleminderit!

Pika e gjashtë e rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Avokatinë

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për Avokatinë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Legjislacion, zotin Gashi, që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar Ligjin për Avokatinë dhe ka propozuar gjithsej 16 amendamente. Besojmë se Ligji i plotëson kriteret e nevojshme dhe të domosdoshme për funksionimin e këtij shërbimit të avokatisë në Kosovë, prandaj me këto amendamente besojmë se kemi ngritur kualitetin e ligjit, përveç një problemi teknik që është vërejtur te amendamenti i 11-të, i cili propozoi që të hiqet fare ose kur të vijmë te amendamenti 11, ta heqim si amendament dhe tjerat mund të votohen. Amendamenti 7 e ka një problem teknik edhe ai, kur të vijmë aty, do ta sqaroj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Ne si subjekt politik nuk pajtohemi me këtë procedurë të votimit pra të projektligjeve, pa u analizuar fare. Këtë kundërshti e kemi pasur edhe javën e kaluar, pra të enjten kur u shqyrtua në parim pra ky projektligj. Pra ky Kuvend po i kalon ligjet në të gjitha procedurat përbrenda vetëm një jave. Nuk guxojmë të lejojmë miratimin e ligjeve kësisoj dhe assesi kur kemi të bëjmë me një projektligj shumë të rëndësishëm. Pra ju e dini që i njëjti do të duhej t'i mbrojtë të drejtat e palëve në procedurën gjyqësore si dhe është i lidhur me sferën e ushtrimit të lirë të profesionit, pra të profesionit të avokatisë e që në përmbajtje të tij, pra në përmbajtjen e këtij projektligji, as nuk mbron të drejtat e palëve në procedurën gjyqësore dhe as nuk lejon ushtrimin e lirë të profesionit të avokatisë. Pra, edhe ne subjekt politik kemi pasur shumë vërejtje përmbajtjesore në lidhje me këtë

projektligj, e gjithashtu edhe Oda e Avokatëve dhe Shoqëria Civile, mirëpo fatkeqësisht nuk janë marrë parasysh vërejtjet e tyre meqë nuk është organizuar dëgjimi publik si është praktikë për shqyrtimin e të gjitha ligjeve.

Pra, vërejtjet tona kanë qenë në nenin 10, paragrafi 4, kushtet për regjistrimin në Odën e Avokatëve, më tej neni 21, paragrafi 3 që ë ka të bëjë me dokumentet ekzekutive. Neni 23, paragrafi 1.5 ku janë të përfshira kushtet për regjistrimin e avokatëve dhe praktikantëve, neni 29 dhe 30 ku janë të konceptuara dy format e ushtrimit të avokatisë, e që kjo bie në kundërshtim me ligjet tjera që janë në fuqi. Neni 36 ku parashihet heqja e lirisë së avokatit dhe bastisja e zyrës së tij, por edhe tek neni 48 paragrafi 1 ku flitet për mbikëqyrjen dhe përcjelljen e punës së Odës së Avokatisë. Pra, jemi thirrur nga Komisioni për Legjislacion për t'i bërë amendamentet për vetëm 2 orë, pra të hënën jemi thirrur në orën 10:00 t'i bëjmë amendamentet deri në 12:00, sepse Komisioni duhet ta shqyrtojë, pra për shqyrtimin e dytë këtë projektligj dhe ta dërgojë në seancë. Pra kjo është mendësi e mbrapshtë e bërjes së ligjeve dhe ne mendojmë që duhet të ndalet kjo mënyrë e bërjes së ligjeve. Ne e kemi pra përvojën e miratimeve të ligjeve në procedurën e përshpejtuar dhe fatkeqësisht ato ligje kanë mbetur në sirtarët e Qeverisë dhe nuk janë zbatuar fare. Pra për arsye të procedurave dhe përmbajtjen e këtij projektligji, ne do të votojmë kundër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Unë po besoj që tani janë paraqitur, nuk e di Halit, nuk po e marr vesh pse dëshironi të diskutoni, por sidoqoftë ekziston një hapësirë kohore kur komisionet e shqyrtojnë dhe e drejta për amendamentim dhe për të propozuar. Tani kemi ardhur në fazën kur ne duhet t'i votojmë amendamentet dhe fjala e fundit, është fjala e Komisionit. Për çdo amendament keni të drejtë t'i jepni vërejtjet dhe të propozoni, unë nuk kam mundësi t'i ndryshoj procedurat që janë të parashkruara me Rregullore. Prandaj, vazhdojmë me votimin e amendamenteve veç e veç.

Amendamenti 1.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Në qoftë se dikush dëshiron për ndonjë amendament të ndalet dhe ta diskutojë , e drejta është e të gjithëve

Amendamenti 4.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet. 71 deputetë janë në sallë.

Amendamenti 5.

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Për amendamentin e 7-të, e ka fjalën zoti Gashi, kryetari i Komisionit, në emër të Komisionit.

ARBEN GASHI: Faleminderit, në amendamentin 7 bëhet fjalë për rirenditje, domethënë nenet 31, 32 dhe 33 hiqen dhe bëhen paragrafë, ndërsa radhitja vazhdon pastaj. Ky është një sqarim, sepse si duket ka krijuar një keqkuptim dhe pat disa shqetësime prej deputetëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, atëherë votojmë

Amendamenti 7.

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet, me vërejtjet e kryetarit të Komisionit.

Amendamenti 8.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Për amendamentin 11, zoti Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit! Propozoj që amendamenti 11 të hiqet, sepse është krijuar një dualizëm këtu dhe është i panevojshëm, thotë: neni 45, paragrafi 3 formulohet si në vijim: Oda i ka degët rajonale: në Prishtinë, në Pejë, në Gjakovë, në Prizren, në Gjilan, në Ferizaj dhe në Mitrovicë. Kompetencat dhe numri i degëve përcaktohet me statutin e Odës. Është një gabim këtu te numri i degëve, sepse numri i degëve është përcaktuar tashmë sa degë do të jenë, që do të thotë do të jenë: dega Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Gjilan, Ferizaj dhe Mitrovicë. Domethënë, fjala dhe numri i degëve hiqet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Unë desha të sqaroj sa i përket edhe nenit, amendamentit 11, por së pari dua të them që ato dy orë që kam punuar edhe si udhëheqës i grupit punues, mendoj që nuk është dashur shumë të punohet në këtë projektligj pasi i ka pasur vetëm 69 nene të caktuara dhe pikërisht edhe ky ndryshim që po kërkon kryetari ta bëjë, ka qenë si propozim i Odës së Avokatëve. Ne i kemi shqyrtuar edhe propozimet e tyre, i kemi shqyrtuar edhe të shoqërisë civile, ato që kanë qenë përmbajtjesore dhe të cilat kanë qenë të nevojshme të inkorporohen në këtë projektligj.

Disa shqetësime që janë ngritur edhe në seancë plenare nga njerëz profesionistë që kanë të bëjë edhe me disa amendamente që i përmendi edhe kolegja deputete, por edhe tash Arbeni, janë inkorporuar në këto amendamente që veç tash po votohen. Këto desha vetëm për hir të korrektësisë dhe të punës që është bërë, por sido që të jetë edhe këtu në Kuvend është e drejta të paraqiten dhe të bëhen amendamente dhe atëherë përcaktohen edhe me votën e Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë votojmë për propozimin që të tërhiqet amendamenti 11. A ka kundër? Nuk ka. Miratohet

Amendamenti 12.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Ju lus që të përgatiteni për votim. Votojmë tash! Në sallë 75 deputetë. Faleminderit!

Me 60 vota për, 9 vota kundër, 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për Avokatinë.

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës-

(Reagime)

Jo, pauzën në orën 13:30 zakonisht e marrim, për mua nuk ka problem. E doni. Fillojmë pastaj fillojmë me deklaratat e kryetarëve të grupeve parlamentare, pastaj vazhdojmë.

7. Interpelanca e ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z.Ramë Buja, sipas kërkesës së deputetit Burim Ramadani, mbështetur nga 7 deputetë tjerë lidhur me çështjen e arsimit në Kosovë

Deputeti Burim Ramadani dhe grupi i deputetëve nënshkrues, në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit, ka parashtruar kërkesë për të ftuar në interpelancë ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, zoti Ramë Buja lidhur me çështjen e arsimit në Kosovë.

Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë deri në 3 orë. Përfaqësuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në 10 minuta dhe në mbyllje të debatit, deri në 5 minuta, neni 44, pika 7 e Rregullores.

Në bazë të nenit 44, pika 8 e Rregullores së Kuvendit, ministri Ramë Buja paraqet dhe arsyeton qëndrimin e Qeverisë së Kosovës për çështjen e shtruar në interpelancë në kohëzgjatje prej 15 minutash. Koha është e ndarë, prandaj vazhdojmë.

Ftoj deputetin Burim Ramadani, që në cilësinë e propozuesit të interpelancës ta marrë fjalën 10 minuta.

Dua të ju informoj që për dallim nga seanca e kaluar, çdo replikë llogaritet në kohën e deputetëve që e kërkojnë replikën, në kohën e llogaritur për grupet parlamentare. Zoti Ramadani, e keni fjalën.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

I nderuari, zoti ministër,

Më lejoni që edhe një herë të përsëris se kjo nuk është hera e parë që Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës po e ngrit këtë çështje në këtë Kuvend sikurse dhe në të gjitha platformat e mundshme publike si shqetësim jashtëzakonisht serioz me nivelin e lartë dhe tejet dëmtues të shpërndarjes dhe të përdorimit të drogave nëpër shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës.

Të dhënat dhe vlerësimet e përgjithshme të kohëve të fundit tregojnë për një nivel tepër të lartë të përdorimit të drogave nga nxënësit e që janë fëmijët tanë për të cilët ne gjithë duhet të angazhohemi për t'iu mundësuar një jetë më të mirë dhe tek e fundit ky është misioni i politikës.

Është evidente se mungojnë statistikat e plota dhe mungojnë statistikat gjithëpërfshirëse nga institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, prandaj krejt çka kemi dëgjuar deri më tash nga Qeveria e Kosovës, pra vlerësimet publike institucionale nuk janë të sakta, sepse nuk kanë të dhëna bazike për këtë dukuri negative. Porse statistikat e nxjerra nga institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, të cilat trajtojnë profesionalisht çështjen e varshmërisë nga drogat, janë këto:

Rreth 20% e nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme përdorin lloje të ndryshme të drogave, kryesisht drogave të lehta, kjo i bie fatkeqësisht që sidomos në shkolla të mesme numri varion deri rreth çdo i pesti nxënës në shkolla të mesme që është pre e kësaj dukurie negative.

Mosha e fillimit të përdorimit të drogave ka rënë dhe tashmë prek edhe moshën 12 vjeçare, përkatësisht i bie diku në klasën e tetë të shkollës fillore.

Derisa marihuana shpërndahet në shumicën e lokaleve rreth shkollave fillore dhe të mesme, nxënësit largohen nga shkolla, për shkak të mungesave që i bëjnë në mësim e jo

për shkak të përdorimit të drogave dhe jo për shkak të mundësisë së trajtimit të tyre. Kjo është detyrë e Ministrisë së Arsimit dhe kjo është detyrë e përbashkët me Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Mësimdhënësit nuk janë trajnuar për çështjen e drogave. Prandaj, edhe nuk mund të kujdesem në mënyrën më të mirë dhe kjo është detyrë e Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Nuk ka Institut Kombëtar për Trajtimin e Sëmundje të Varshmërisë në Kosovë dhe kjo është detyrë e Ministrisë së Shëndetësisë. Ata të cilët janë të varur nga droga dhe kërkojnë ndihmë, qoftë edhe në formë vullnetare, besoni ose jo dërgohen në psikiatri, kjo nuk është mënyra më e mirë dhe për këtë sigurisht se do të largohen prej tentimit dhe dëshirës që të shërohen prej varshmërisë nga droga.

Dhe krejt në këtë situatë, tema e përdorimit të substancave narkotike nga nxënësit që janë fëmijë tanë nuk është ngritur asnjëherë në mbledhje të Qeverisë së Kosovës e mos të flasim për veprime. Pra, nuk është thënë asnjë fjalë për këtë, e të mos flasim për veprime institucionale të duhura.

Veprimi adekuat dhe i shpejtë i Qeverisë së Kosovës do të paraqiste kujdes të domosdoshëm për mbrojtjen e të rinjve të Kosovës.

Ne e kemi të qartë se ekziston një strategji kombëtare e Republikës së Kosovës kundër drogave, por kjo strategji kombëtare nuk është duke u realizuar dhe arsyeja kryesore është kjo. Ka mungesë të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërsektorial brenda Qeverisë së Kosovës, sidomos ajo që njihet si trekëndëshi kryesor që është Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme, prandaj edhe strategjia nuk është funksionale.

Ne e kemi thirrur ministrin e Arsimit në këtë interpelancë për të drejtuar e adresuar këtë çështje, pra përdorimin e drogave tek nxënësit në shkollat fillore dhe të mesme duke qenë vetëdijshëm se kjo çështje është e tri ministrive, prandaj normalisht se edhe mocioni ose pikat e mocionit që i kemi propozuar kanë të bëjnë me të tri ministrinë, kryesisht me Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Shëndetësisë.

Qëllimi i kësaj interpelance është që të nxisim Qeverinë e Kosovës që të veprojë shpejt kundër kësaj dukurie negative. Ne po i ofrojmë idetë tona, propozimet tona, planin, projektin tonë për ta luftuar shpërndarjen dhe përdorimin e drogave te nxënësit.

Objektivi ynë si Aleancë është që ta adresojmë këtë veprim në mënyrë efektive dhe dinamike, në paktën në katër fusha bazë.

Një, të përballimit të problemit,
Dy, zbatimit të ligjit,
Tre, të parandalimit, trajtimit e zvogëlimit të dëmit, dhe
Katër, edukimin.

Ne besojmë se ky objektiv është i arritshëm. Me këto veprime nuk do të lejohej që droga t'i shtrijë edhe më shumë rrënjët nëpër shkolla. Mesazhi ynë që besoj duhet të dalë edhe prej kësaj seance është që t'i drejtohem të rinjve, fëmijëve që mos të mashtrohen nga një gëzim i momentit që mund t'u sjellë një dozë droge ose një dozë substance narkotike, por të mendojnë më gjatë, të mendojnë për jetën, sepse kjo ia shkatërron të ardhmen e tyre.

Edhe një herë po e them se trekëndëshi, Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, nuk po funksionon, asnjë fjalë dhe asnjë veprim nuk është bërë dhe të nderuar ministra, ministër i Arsimit, ministër i Shëndetësisë, kjo është gabim, këto janë veprime të gabueshme, sepse mosveprimi për parandalimin dhe ndaljen e përdorimit të substancave narkotike tek fëmijët, është gabim shumë më i madh se sa çështje tjera.

Edhe një herë më lejoni që në fillim t'i lexoj pesë pikat e mocionit, të cilat ne i kemi propozuar po i them qartë se janë pika krejt modeste, sepse besojmë se me këtë mund të fillohet të paktën të fillohet diçka të bëhet nga kjo Qeveri, sepse nuk presim që të ketë më shumë veprime për të parandaluar dhe ndaluar në mënyrë të saktë krejt çështjen e përdorimit të substancave narkotike.

Propozojmë që Kuvendi i Kosovës të kërkojë nga Qeveria e Kosovës t'i ndërmarrë këto pesë veprime.

1. Të organizojë trajnimin e mësimdhënësve në tërë Kosovën për fushën e drogave dhe kjo të ndodhë për secilin vitit shkollor. Arsyeja e kësaj pike të mocionit është fakti se nuk ka pasur dhe nuk ka edhe më tutje program të veçantë Ministria e Arsimit për trajnimin e mësimdhënësve për fushën e substancave narkotike, program i cili do të duhet të bëhet bashkë me Ministrinë e Shëndetësisë, asnjëra ministri nuk e ka bërë.
2. Të investojë në hulumtime mbi të cilat do të ndërtoheshin veprime, strategji dhe politika efektive. E vërteta është sikurse që thashë më parë se nuk ka të dhëna të sakta të institucioneve publike të Kosovës, prandaj edhe strategjia që është bërë, është bërë në mungesë të të dhënave bazike, prandaj është tepër e qartë se strategjia e tillë edhe nuk mund të funksionojë.
3. Të bashkëpunojë ngushtë me shoqërinë civile dhe organizatat e profesionalizuara në këtë fushë.
4. Të ndërmerret një fushatë sensibilizuese ose e vetëdijesuese me nxënësit për rreziqet e drogave dhe pasojat që ajo lë në mentalitetin dhe edukimin e brezave, dhe
5. Të ndërtohet Institutit Kombëtar për Trajtimin e Sëmundjeve të Varshmërisë dhe kjo të ndodhë gjatë vitit 2013, sepse është koha kur mund të bëhet dhe bëhet rishikimi i Buxhetit të Kosovës.

Më lejoni që në fillim të kësaj seance të përshëndes dhe të falënderoj për punën që po bën OJQ “Labirinti”, Këshilli i Rinisë Evropiane të Kosovës, Këshilli i Rinisë së Kosovës, Këshilli i nxënësve të Kosovës dhe Aleanca e të Rinjve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ftoj ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, zotin Ramë Buja, që të paraqesë qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me çështjen e shtruar për interpelancë.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryesues,

I nderuar koleg ministër,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Ramadani, faleminderit shumë për këtë nismë për t’u trajtuar në Kuvend kjo çështje, për t’u sqaruar dhe shpjeguar, edhe pse është e vërtetë ajo që e thatë edhe mund ta përsëris që është çështje që nuk i përket vetëm Ministrisë së Arsimit, por u përket edhe ministrive të tjera dhe Qeverisë përgjithësisht, andaj në kuadër të kësaj ne kemi bërë punë dhe angazhim dhe unë besoj nuk kam nevojë që t’iu përgjigjem atyre që shënova këtu si pyetje një farë forme të bëra në fjalën tuaj të nismës, por po e lexoj një qëndrim dhe punët dhe angazhimet që kemi bërë si Ministri e Arsimit dhe pastaj aty do të jetë edhe përgjigja.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, po angazhohet që Kosova të jetë një shoqëri demokratike e integruar në rrjedhat evropiane, që ofron kushte dhe mundësi të barabarta për zhvillim personal të të gjithë qytetarëve ku qasja në përfitim të dijes të aseteve kërkimore- shkencore dhe të përfitimit të shkathtësive janë për të gjithë të interesuarit të ofruara dhe në funksion të zhvillimit të përshpejtuar dhe të qëndrueshëm.

Meqenëse cilësia e arsimit konsiderohet si prioritet i MASHT-it, MASHT-i po punon vazhdimisht në përmirësimin e cilësisë së arsimit që nxënësit që mbarojnë shkollimin në Kosovë, të zotërojnë njohuri, shkathtësi dhe shprehje që janë të krahasueshme me bashkëmoshatarët e tyre në Evropë.

Me qëllim të shtimit të efikasitetit për implementimin e Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë, 2011-2016 dhe njëkohësisht duke marrë parasysh problemet me të cilat është ballafaquar arsimi në të kaluarën, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë, po angazhohet të përkrahë, të bashkërendisë, të rregullojë dhe të promovojë arsimin cilësor për të gjithë duke filluar nga edukimi para fillor, arsimi para universitar, arsimi dhe aftësimi profesional, zhvillimi profesional i mësimdhënësve, arsimi i lartë, arsimi dhe aftësimi i të rriturve dhe teknologjia e informimit.

Sa i përket problemit të shtruar sot në këtë interpelancë, mund të themi se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, ka aprovuar dhe nënshkruar strategjinë kombëtare për programin “Shkollat promovuese të shëndetit” 2009-2018 dhe Plani i veprimtimit, 2009-2013.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka qenë pjesë e grupit punues në hartimin e Strategjisë kombëtare kundër drogave, 2009-2012 dhe 2012-2017, ku merr pjesë përmes programeve të rregullta, duke i realizuar objektivat e shëndetit publik nëpërmjet aktiviteteve shkollore dhe jashtëshkollore, në të cilat aktivitete mund të kyçen prindërit dhe komuniteti në përgjithësi.

Ministria e Arsimit ka hartuar Planin strategjik të arsimit në Kosovë 2011-2016, plan në të cilin thuhet se shkollat kanë krijuar mjedise jo të dhunshme, përkundrazi, por kanë krijuar mjedise miqësore për fëmijët në shkolla që janë përkrahëse të kujdesshme dhe i kultivojnë vlerat demokratike të fëmijët dhe ofrojnë modele pozitive për të gjithë fëmijët.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në kuadër të programeve shumë sektoriale siç është programi Shkollat promovuese të shëndetit, shënon ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të fëmijëve nëpër shkolla.

Objektivi i shkollave promovuese të shëndetit është që të përkrahen shkollat edhe të zhvillojnë politika e programe efektive, që do të përforcojnë dhe t'i bëjnë të shëndetshme dhe të qëndrueshme mjediset në të cilat zbatohen këto politika.

Në kuadër të këtij programi në maj të vitit 2010, është realizuar trajnimi i mësimitdhënësve në qasjen e shkollave promovuese të shëndetit në bashkëpunim me ekspertët e Rrjetit evropian duke u bazuar në përvojat e vendeve më të avancuara të Evropës.

Në këtë trajnim janë trajnuar 60 mësimitdhënës të të gjitha niveleve për temat e edukimit shëndetësor, përfshirë këtu edhe temat mbi drogën. Mësimitdhënësve iu është shpërndarë materiali në gjuhën shqipe dhe në gjuhë tjera të komuniteteve e që këta mësimitdhënës do t'i jetësojnë përvojat e tyre të marra në këtë trajnim nëpërmjet zbatimit të këtyre temave në kuadër të biologjisë, edukatës qytetare dhe lëndës zgjedhore në kuadër të mësimit klasor që ata e bëjnë.

Mësimitdhënësve iu është shpërndarë materiali apo doracaku trajnues për mësuesit dhe punëtorët që punojnë me të rinj, promovimi i shëndetit të rinjve në Evropë ku kaptina e 12 ka të bëjë me edukimin, ekskluzivisht për drogën.

MASHT -i i përkrahur nga UNICEF-i ka zbatuar lëndën zgjedhore "Aftësitë për jetën" në shkollat fillore, në klasën 8-të. Brenda këtij materiali, një modul i veçantë trajton temat për shëndetin me theks të veçantë dukuritë negative siç është droga.

Korniza e kurrikulës, e nënshkruar në shtator të vitit 2011, është dokument bazë i arsimit, rezultat i punës së agjencive të ndryshme në fushën e arsimit dhe përcakton fushat e reja mësimore ku një prej tyre është edhe shëndeti edhe mirëqenia.

Fusha mësimore, shëndeti edhe mirëqenia, ofron një qasje të integruar në edukatën fizike dhe sport si dhe në edukatën shëndetësore, përfshirë promovimin e mënyrave të shëndosha të jetesës.

Po ashtu, pjesa zgjedhore mbulon fondin e orëve, 10 gjer 20% sipas niveleve arsimore, duke filluar nga arsimi parashkollor, ai i mesëm, i ulët dhe i mesëm i lartë.

Me pjesën zgjedhore nënkuptohen pjesa e kurrrikulës me të cilën përcaktohet ose zgjidhet shkolla e zgjedh vetë shkollën në fakt. Kjo i ofron mundësi shkollave që të angazhohen në mënyrë aktive për arritjen e rezultateve mësimore të përcaktuar në kornizë, varësisht nga kushtet specifike të kuadrit shkollor, infrastrukturës dhe mjedisit ku vepron shkolla.

Rekomandimet e shkollës për pjesë zgjedhore të propozuara nga këshilli ose bordi i shkollës do të miratohen në konsultim ose miratohen në konsultim me autoritetet komunale të arsimit dhe në bashkëpunim me autoritetet përkatëse të MASHT-it.

Temat për dukuritë negative janë pjesë e plan-programeve në kuadër të lëndëve si kimia për klasën e 9-të dhe klasën e 12-të.

Tema “Aktuluidët dhe morfina, droga, nikotina, morfina dhe kafeina” e të tjera, po ashtu në lëndën Edukata Qytetare, trajtohen tema për dogat duke filluar nga klasa e 6-të te kapitulli “Ndryshimet dhe problemet sociale”. Në klasën e 10-të trajtohet në kuadër të legjislacionit alkooli dhe drogat, kurse në klasën e 11-të, kapitulli “Problemet globale dhe mjedisi” ku flitet për narkomaninë.

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë, po ashtu në bashkëpunim me Policinë e komunitetit në bashkësi e ka miratuar kërkesën për projektin në parandalimin e përdorimit të substancave narkotike në institucionet shkollore.

Mbajtja e ligjëratave për pasojat e drogës është realizuar nga zyrtarë kompetentë, kur ekspertë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale kanë realizuar këto informacione dhe informata me nxënës në kuadër të orës së biologjisë. Në këtë projekt janë përfshirë nxënësit e klasave të dhjeta.

Drejtorja e Policisë në bashkësi dhe preventivë, në bashkëpunim me Drejtorinë për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë, me pëlqimin dhe mbështetjen MASHT-it vazhdon të implementojë projektin “Thuaju jo substancave narkotike”.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është:

- Avancimi dhe ruajtja e shëndetit në shoqëri;
- Formimi i një rinie të shëndoshë përmes porosive edukuese;
- Sensibilizimi i opinionit për pasojat, efektet nga përdorimi i drogave; dhe
- Parandalimi i dukurisë së substancave narkotike.

Në kuadër të implementimit dhe realizimit të këtij projekti janë përfshirë nxënësit e shkollave të mesme, klasave dhjetë, njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë, si dhe shkollat fillore të të gjitha rajoneve. Projekti realizohet në organizimin dhe mbajtjen e ligjëratave në aspektin edukues.

Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare - MASHT-i po ashtu bashkëpunon me organizata joqeveritare në realizimin e projekteve të ndryshme, që kanë për qëllim promovimin e sjelljeve të shëndosha të të rinjve. Për shembull, ka miratuar projektin e organizatës PEN, rrjeti i edukatorëve bashkëmoshatarë, përmes të cilit të rinjtë do të marrin informata tek bashkëmoshatarët e tyre për temat si duhani, droga dhe njëkohësisht krijimin e sjelljeve të shëndosha, për shoqërinë në përgjithësi.

Në kuadër të kësaj janë trajnuar 200 edukatorë nga të gjitha komunat e Kosovës. Po ashtu, në Organizatën Fondacioni i Kosovës për Shëndet, ka filluar implementimi i pilot-projektit për parandalimin e drogave tek të rinjtë. Ky program për pjesën e trajnimeve është akredituar nga MASHT-i dhe ka filluar me aktivitete trajnuese. Temat e trajnimit janë njohuri bazike për drogat, efektet dhe pasojat e drogave, problemet sociale të ndërlidhura me drogat, edukimi dhe preventiva, aplikimi praktik i testeve, siç është çështja e duhanit, marihuanës dhe alkoolit, si të flasim me fëmijët - nxënës për drogat e të tjera e të tjera. Ky program realizohet përmes leksioneve, punëtorive dhe debateve të pjesëmarrësve.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka punuar mjaft në parandalimin përmes bashkëpunimit me institucionet dhe OJQ-të, mirëpo sfidë për të gjitha institucionet mbetet vetëdijesimi i gjithë shoqërisë për këtë dukuri shumë negative.

Diçka që mund t'ju them se para pak ditësh kemi nënshkruar edhe një marrëveshje me një institucion kroat që është një projekt që quhet SMS Flex, që do të realizojë mundësinë e bashkëpunimit nxënës-prindër, për të gjitha ato që ndodhin në shkollë, ka mundësi prindi të jetë i njoftuar dhe kjo besoj do të ndikojë edhe më pozitivisht për këtë çështje, për ta penguar një dukuri të tillë që vërtet është shqetësuese për të gjithë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka zoti Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar ministër,

Ministra, në fakt,

Të nderuar deputetë,

Tema e ngritur është shqetësuese për neve si shoqëri, prandaj unë fillimisht në emër të Grupit, por edhe si kryetar i Komisionit për Arsim, do të flas në vija të përgjithshme pak për gjendjen në arsim në përgjithësi dhe për veprimet të cilat po ndërmerren dhe pastaj edhe për temën e ngritur.

Duke pasur parasysh faktin se fati i një popullit është i lidhur ngushtë me nivelin e arsimit, ky konstatim na obligon të gjithëve si shoqëri pa dallim, që arsimi të ketë trajtim të veçantë në të gjitha aspektet. Arsimi do të duhej të jetë prioritet permanent i të gjitha qeverisjeve në Kosovë, pa dallim ngjyrimesh politike e partiake.

Në këtë rast duhet përmendur hapat e mëdhenj të Qeverisë, sidomos nga viti 2008, që për herë kanë pasur synim trajtimin e dinjitetshëm të arsimit në të gjitha aspektet. Këtu duhet

përmendur godinat shkollore, ambientet e rregulluara, librat gratis, licencimin e mësimdhënësve, akreditimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, infrastrukturën ligjore në frymën e BE-së, kurrikulën e re, përmirësimin e arsimit profesional e tjera.

Pastaj digjitalizimi i shkollave është projektuar të bëhet dhe po bëhet çdo ditë, trajnimi i mësimdhënësve për fushën e teknologjisë informative, deri më tani janë trajnuar dhe certifikuar rreth 16 mijë mësimdhënës për 7 modulet e programit ECDL. Është në proces dizajnimi i programit për sistemin menaxhues të informatave, nëpërmjet të cilit do ta kemi mundësinë të dimë detajisht për secilin nxënës a mësimdhënës në secilën shkollë. Ka plot hapa që dëshmojnë synimin e rritjes në vazhdimësi të cilësisë.

Përveç kësaj, për të pasur një arsim sa më cilësor janë hartuar dokumente të rëndësishme, si:

- Strategjia për zhvillim të arsimit parauniversitar, 2007-2017;
- Strategjia për arsim të lartë 2005 - 2015; si dhe
- Plan i strategjik për zhvillim të arsimit të Kosovës, 2011-2016.

Të gjitha këto janë bërë në konsultim me ekspertë ndërkombëtar, siç ka ndodhur edhe me procesin e finalizimit dhe të pilotimit të kurrikulës së re të Kosovës, e cila gjithashtu po mbështetet financiarisht dhe me ekspertizë nga ndërkombëtarët. Janë akredituar dhjetëra institucione arsimore private e publike të gjitha niveleve, është hartuar plani kombëtar për zhvillimin e shkencës në Kosovë, implementimi i të cilit do të nxisë zhvillimin ekonomik të vendit.

Objektiv tjetër i realizuar i Ministrisë së Arsimit është edhe përmirësimi i shkathtësive pedagogjike të mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave profesionale në Kosovës dhe sidomos zhvillimi i kapaciteteve në udhëheqjen arsimore, sepse tashmë dihet se menaxhimi i mirë i arsimit, padyshim që ndikon në rritjen e cilësisë arsimore. Ngjashëm, po i kushtohet vëmendje edhe arsimimit të të rriturve dhe mësimi gjatë gjithë jetës, si dhe avancimin e barazisë gjinore.

Sa i përket arsimit parauniversitar, sipas Planit strategjik të arsimit 2011-2016 nëpërmjet Divizionit të Arsimit të Përgjithshëm janë realizuar një serë objektivash të arsimit parauniversitar në ngritjen e përfshirjes dhe cilësisë në edukimi parashkollor, në ngritjen e kapacitetit udhëheqës në shkollë, bartja e kompetencave për menaxhim financiar në nivelin komunal dhe të shkollës, si dhe në arsimimin gjithëpërfshirës, e të tjerë.

Edukimi parashkollor , aktivitetet për edukimin dhe arsimin parashkollor po ashtu, janë të dukshme, është siguruar qasje gjithëpërfshirëse dhe e barabartë për të gjithë fëmijët në edukim cilësor dhe jodiskriminues deri në moshën 6-vjeçare. Janë hartuar shtatë module të bazuara në fushat zhvillimore të dokumentit të standardardeve të zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme.

Punë e mirë është duke u zhvilluar edhe në parandalimin e dukurive negative nëpër shkolla, sidomos kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe dukuri të tjera. Fillimisht, MASHT-i e ka sanksionuar dhunën dhe dukuritë tjera negative me infrastrukturën e vet

ligjore, duke e përputhur atë me Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe me instrumentet tjera ndërkombëtare që lidhen me të drejtat e njeriut.

Në këtë rast do të përmendi Ligjin për edukimin parashkollor numër 2006/02 L-52, Ligji i arsimit parauniversitar numër 2011/04 L-032, Ligji i Inspektoratit të Arsimit numër 2004/37, Kodi i Mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme dhe të larta, si dhe Udhëzimin administrativ, ndalimi, ndërprerja dhe inicimi i procedurës disiplinore për personelin edukativo-arsimor dhe dokumente të tjera.

Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm ka realizuar projekte për parandalimin e dukurive të ndryshme negative dhe vetëdijesimin e nxënësve, si: siguria në shkollë - sfidë për komunitetin; të rinjtë janë e ardhmja jonë; të gjitha në bashkëpunim me Policinë e Kosovës. Pastaj, projekti për krijimin e mjedisëve të sigurt, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla, këtë në bashkëpunim me UNICEF-in dhe KEC-in.

Në vitin 2009 u arrit marrëveshje ndërministrare për parandalimin e sjelljeve asociale dhe delikumente në institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese të Republikës së Kosovës, qëllimi i së cilës ishte parandalimi i shfaqjes së sjelljeve dhe veprimeve delikumente në institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese të Republikës së Kosovës. Por, kjo marrëveshje fatkeqësisht nuk u tregua aq e suksesshme pasi që nuk i kishte në domenin e saj institucionet e nivelit lokal, të cilat kishin obligime direkte në parandalimin dhe reagimin ndaj rasteve konkrete në nivel shkollash dhe komunash.

Pastaj Njësia për të Drejtat e Njeriut në Ministrinë e Arsimit, e cila merr pjesë në Këshillin për mbrojtje dhe drejtësi për fëmijë, themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim të mbrojtjes dhe nxitjes së të drejtave të fëmijëve në Kosovë e ka dhënë agjendën e këtij këshilli, finalizimin dhe zyrtarizimin e protokollit kundër dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar. Dokumenti thuhet se është në procedurë të aprovimit dhe zyrtarizimit në Qeveri.

Brenda këtij protokollit shihen përgjegjësitë ligjore dhe institucionale të secilit brenda shkollës dhe të institucioneve të tjera në relacion me dhunën në shkolla, pastaj ky protokoll rrit premisat për përmirësimin e situatës në arsim, duke mobilizuar të gjithë përgjegjësit relevantë në veprime konkrete në të mirë të trajtimit të problemit të dhunës në shkolla, me të cilin shkollat do të frymojnë lirshëm, do të rrisin cilësinë në punën, në përgatitjen e nxënësit për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri demokratike.

Aspektet e sigurisë në shkollë adresohen edhe me strategjinë nacionale për siguri në bashkësi, strategji kjo që udhëhiqet nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Po ashtu, Policia e Kosovës do të fillojë me aktivitete informuese të të rinjve me dukuritë negative, me theks të veçantë - drogat. Për këtë qëllim janë botuar materiale promovuese për shëndetin, të cilat do të shpërndahen në shkolla. Po ashtu, për këtë qëllim janë organizuar aktivitete edhe në shkolla përmes vizitave mjekësore, si dhe ligjëratave për mirëmbajtjen e shëndetit të nxënësve.

Së fundi, më lejoni të them që arsimit nuk është çështje vetëm e Ministrisë së Arsimit, por është e tërë shoqërisë kosovare, andaj edhe e secilit prej nesh. Për këtë arsye bashkëpunimi i të gjitha institucioneve, që nga familja e më lartë dhe anasjelltas, do të duhej të jetë permanent, në mënyrë që të arrijmë rezultatet e dëshiruara.

Ne si grup parlamentar do të përkrahim të gjitha veprimet, të cilat çojnë në parandalimin, eliminimin dhe çrrënjosjen e të gjitha dukurive negative në shkolla dhe kudo në shoqëri dhe sidomos të kësaj dukurie, që me një fjalë mund të themi është e shëmtuar, e shkatërron një shoqëri të tërë dhe jemi këtu si grup parlamentar, për të diskutuar edhe më tej. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Morina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e mbështet dhe e konsideron mjaft të rëndësishëm debatin për gjendjen e sigurisë dhe për dukuritë negative në shkollat e Republikës së Kosovës.

LDK-ja vlerëson se dukuritë negative, si përdorimi i drogave në shkollat tona viteve të fundit kanë shënuar rritje shqetësuese, gjë që dëshmohet me raportimet e rasteve të shumta në pjesë të ndryshme të vendit dhe në radhë të parë në vendet urbane.

Ne konsiderojmë se Qeveria nuk ka bërë asgjë të rëndësishme për parandalimin e dukurive të tilla, përpos një akti simbolik të nënshkrimit të memorandumit për bashkëpunim ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe asaj të Punëve të Brendshme, të bërë disa vjet më parë. Nuk kemi parë asnjë formë të adresimit të këtij problemi.

Përdorimi i drogave në sistemin shkollor parauniversitar në Kosovë, rritja e shkallës së përdorimit çdo ditë e më shumë, është një dështim i sistemit, i Qeverisë dhe i shoqërisë sonë në përgjithësi, meqë përdoruesit janë nxënës dhe fëmijët tanë. Po ashtu, konsiderojmë se Ministria e Shëndetësisë është dashur të japë ndihmesën e saj për të luftuar këtë dukuri negative, e cila është shfaqur sidomos tek të rinjtë tanë.

LDK-ja konsideron se rritja e përdorimit të drogave në shkollat tona, si dhe rastet e dukurive të tjera të këqija, është rezultat i shkallës së ulët të sigurisë në shkollë, rezultat i sistemit arsimor ende jo të mirë e jo sa duhet cilësor, rezultat i drejtpërdrejtë i mospunës së Qeverisë në këtë drejtim dhe i mungesës së programeve qeveritare, për të trajtuar këtë problem.

Raporti i fundit i vlerësimit të përdorimit të drogave në Kosovë kishte për qëllim kryesor anketat nëpër shkolla, konsumimin e alkoolit dhe drogave në mesin e nxënësve ndërmjet moshës 15 dhe 16-vjeçare. Sondazhi tregon rezultate kryesisht shqetësuese për Kosovën,

në krahasim me disa vende tjera, sipas përdorimit të cigareve, alkoolit dhe drogave nga adoleshentët kosovarë.

Ne konsiderojmë se Ministria e Arsimit dhe shkollat duhet të hartojnë një strategji për bashkëpunimin me prindërit, fëmijët dhe me nxënësit, të cilët dyshohet dhe ata të cilët e konsumojnë drogën.

Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë dhe Inspektorati Policor duhet në mënyrë sistematike të bëjnë kontrollimin e lokaleve, kafeneve rreth shkollave në kërkim të substancave narkotike, andaj janë disa lokale, kafene, jo vetëm në zonat urbane, por edhe në ato rurale, ku frekuentohen vetëm nxënës të rinj delikuentë, ku kanë braktisur shkollat.

Të zhvillohen fushata sistematike, për parandalimin e përdorimit të drogave nga nxënësit. Këto fushata nuk duhet të kenë karakter vetëm vetëdijesues, por edhe ndërgjegjësues. Nga organet e sigurisë, të punëve të brendshme, Policisë së Kosovës, gjykatat, kërkojmë të ndërmarrin veprime konkrete penalizuese për të gjithë personat apo grupet kriminale të cilat merren me shpërndarjen dhe shitjen e drogës.

Të nderuar kolegë deputetë,
LDK-ja kërkon angazhimin e Qeverisë dhe nismën konkrete për luftimin dhe largimin e dukurive të tilla nga shkollat tona.

LDK-ja po ashtu konsideron se një sistem cilësor i arsimit ndihmon për t'i parandaluar dukuritë jo të mira dhe për t'i luftuar ato që tashmë kanë kapluar shkollat tona.

LDK-ja bën thirrje për përkushtim ndaj arsimit më cilësor të fëmijëve tanë, sepse vetëm me anë të arsimit cilësor ata nesër do të jenë gati për punë dhe për jetë më të dinjitetshme. Faleminderit !

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, e ka fjalën zoti Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit kryesues, dhe të nderuar deputetë,
Se sfera e arsimit në Kosovë, përfshirë të gjitha nivelet e organizmit të tij ndodhet në krizë të gjithanshme, kjo tashmë nuk ka dyshim. Bjerrja e kushteve të përgjithshme morale ideale dhe qëllimore që e strukturojnë përmbajtjen e kësaj sfere përbën njërin nga shkaktarët kryesor të kësaj krize.

Pra, në mungesë të këtyre konditave është bërë në substancë vetë ideja themelore e konceptit të arsimit. Në mungesë të kësaj ideje themelore objektet shkollore sot janë shndërruar në vendndodhje të çdo veprimtarie tjetër me përjashtim të idesë themelore që duhet ta kenë arsimimin dhe edukimin e brezave të rinj.

Prandaj, me të drejtë sot këto objekte më shumë u përngjasojnë kazermave institucionale e që shërbejnë vetëm si vend e për strehim të përkohshëm të të rinjve se sa institucione ku

banon ideja universale e zhvillimit dhe edukimit të përgjithshëm shoqëror, ekonomik, politik dhe kulturor.

Është e ditur se Kosova aktualisht ka një rrjet prej 614 shkollave fillore dhe të mesme të ulëta, ku mësojnë 295 mijë e 218 nxënës, ndërkaq në 94 shkolla të mesme të larta mësimin e vijnë 106 mijë e 829 nxënës dhe nuk ka dyshim se ky segment i arsimit përballlet me një seri të deficiteve të ndryshme që e dëmtojnë rëndë organizimin dhe funksionimin e kësaj sfere.

Dhe, kjo seri e dështimeve përfshin elemente që nga mungesa e infrastrukturës shkollore e cila akoma është në gjendje jo të mirë dhe një numër i konsiderueshëm i objekteve shkollore nuk ofrojnë mjedis të shëndetshëm për nxënësit. Në mesin e tyre bëjnë pjesë edhe objektet e ndërtuara ose rinovuara në periudhën e pasluftës, të cilat janë dëmtuar si rezultat i mungesës së mirëmbajtjes. Rrjeti i shkollave fillore dhe të mesme të ulëta nuk i përmbush nevojat e qytetarëve, për shkak të planifikimit jo të mirë shumë objekte shkollore të këtij niveli në zonat rurale janë gjysmë të zbrazëta, ndërkaq në zonat urbane klasat janë më të ngarkuara me nxënës deri sa shkollat punojnë në dy ose ka vende edhe në tri ndërrime.

Po ashtu, mungesa e mjeteve didaktike dhe teknologjisë arsimore ndikon në cilësinë e njohurive dhe shkathtësive që fitohen në shkollë. Në përgjithësi shkollat në Kosovë nuk janë të pajisura në mënyrë adekuate me mjete didaktike, ndërsa teknologjia informative është në dispozicion vetëm të një numri të kufizuar shkollash dhe atë vetëm në formë të kabineteve të dedikuara për lëndë të veçanta.

Një organizim të tillë nuk bën të mundur që teknologjia informative të përdoret në klasë si mbështetje për konkretizimin më të mirë të përmbajtjeve mësimore. E krahas mjeteve didaktike në shkollat e mesme profesionale përveç mjeteve didaktike mungojnë edhe tekstet mësimore për shkak të numrit të madh të profileve dhe numrit të vogël të nxënësve në periudhën e pasluftës nuk janë shtypur fare tekste për shumicën e lëndëve e as që janë përgatitur burime mësimore alternative. Shumë shkolla profesionale kanë punëtori të amortizuara, nuk i shërbejnë realizimit të programit mësimor, ndërkohë që mungon materiali shpenzues i nevojshëm për shkathtësimin e nxënësve në to.

Po ashtu, puna praktike në kompani jashtë shkollës është jo e rregullt. Përfundimisht si pasojë e të gjitha këtyre dështimeve këto shkolla janë shndërruar në vende të arratisjes për nxënësit.

Mirëpo krahas këtyre dështimeve të gjithanshme, pa dyshim se një problem fundamental për arsimin në Kosovë paraqet edhe mungesa e sigurisë dhe veçanërisht në disa shkolla të mesme të larta, ndërsa prania e huliganizmit, mjeteve narkotike dhe sjelljeve të tjera të rrezikshme i bën disa shkolla e mjedise të pasigurta për nxënësit.

Përkundër faktit se është hartuar strategjia qeveritare për siguri në shkolla nuk është bërë asgjë për implementimin e saj dhe nuk ka dyshim se si pasojë e këtyre mungesave të sipër

cekura nxënësit në shkolla të Kosovës tashmë përdorin edhe substanca narkotike, fakt ky që pohohet edhe nga drejtues të qendrave rehabilituese nga droga.

Ndërkaq, ajo që mund të konsiderohet edhe si shqetësim më serioz në këtë rast ka të bëjë me faktin se sipas këtyre të dhënave trendi i përdorimit të këtyre substancave nëpër shkolla të Kosovës gjatë viteve të fundit ka shënuar rritje, fakt ky që paralajmëron se përhapja e narkomanisë dhe atë veçanërisht te të miturit përbën një kërcënim serioz për shoqërinë tonë gjatë viteve në vijim. E fatkeqësisht, ajo që tregon neglizhencën e institucioneve tona përball kësaj dukurie ka të bëjë me faktin se edhe pse tashmë pranohet për ekzistencën e konsumimit të substancave narkotike te të rinjtë, thuaja se asnjë institucion nuk ka të dhëna të sakta për përdoruesit e drogës, e as për sasinë e konsumimit të saj në vendin tonë.

Kështu, tejkalimi i këtij kërcënimi dhe në përgjithësi i kësaj krize që e ka përfshirë sferën e arsimit në vendin tonë duhet të jetë një nevojë e domosdoshme për shoqërinë tonë, kurse këto masa duhet të jenë të gjithanshme. Prandaj, Lëvizja “Vetëvendosje” konsideron se në këtë drejtim duhet të marrë disa hapa njëkohësisht për funksionalizimin e këtij interesi madhor kombëtar.

Hapat që janë të elaboruar në programin e alternativës qeverisëse të Lëvizjes Vetëvendosje përfshin që nga ato për sigurimin e një infrastrukture cilësore dhe të shëndetshme, pajisjen e shkollave me mjete didaktike dhe teknologji mësimore e deri te riorganizimi i rrjetit të shkollave në Kosovë.

Mirëpo, për problemin në fjalë, disiplina dhe siguria në shkolla janë qenësore. Hapat në këtë drejtim, qoftë në nivelin qendror e sekondar i përfshin masat që nga hartimi i legjislacionit sekondar deri tek rregulloret që sigurojnë respektimin e kodit të mirësjelljes në shkolla. Këto rregullore do të sigurojnë një lidhje më të mirë në mes të shkollës, qendrave për punë sociale dhe organeve të rendit në mënyrë që nga sjelljet individuale në kundërshtim me Kodin e mirësjelljes të mos bëhen shkaktar i cenimit të sigurisë së nxënësve në shkolla.

Në ato shkolla ku për çfarëdo arsye ekziston rreziku real për sigurinë e nxënësve do të duhej të sigurohet prania e organeve të rendit dhe të merren masa shtesë për parandalimin e situatave të padëshiruara. Si masat tjera, duhet të jetë edhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve, kurse rol të veçantë në këtë drejtim do të kenë grupet këshilluese pedagogjike në nivel të komunës që duhet të punojnë me secilën shkollë veç e veç në hartimin e planit të zhvillimit profesional si dhe mbikëqyrjen dhe realizimin e tij.

Ndërkaq, si pjesë të rëndësishme të kësaj alternative ne konsiderojmë që edhe kontrole mjekësore për të gjithë nxënësit të shkollave fillore një herë në muaj apo të shkollave të mesme një herë në dy muaj, duhet të jenë masa të domosdoshme në mbrojtjen e shëndetit të kësaj kategorie të shoqërisë nga ky kërcënim shumë serioz. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Tema që po e diskutojmë sot natyrisht që është e një rëndësie të veçantë, por po shihet që mazhoranca nuk është shumë e interesuar.

Padyshim se bashkëpunimi ndërmjet tri ministrive, Ministrisë së Arsimit, të Shëndetësisë dhe të Punëve të Brendshme, nuk po funksionon. Kjo është adresa që duhet të merren me parandalimin dhe luftimin e drogave nëpër shkolla dhe ky është trekëndëshi që duhet të jetë jashtëzakonisht bashkëpunues për ta adresuar qartë dhe saktë këtë çështje. Duhet hequr logjikën se Policia është i vetmi institucion që duhet t'i ndalë drogat nëpër shkolla. Kjo është një logjikë e vjetër dhe është logjikë e gabuar.

Policia e ka rolin e vet të padiskutueshëm, por nuk mund dhe nuk duhet të jetë e vetme. Sipas kësaj logjike të vjetër, policët do të traumatizojnë fëmijët nëpër shkolla duke hyrë në objekte dhe kontrolluar për të gjetur substanca të caktuara të drogave, prandaj është logjikë e gabueshme.

Për këtë arsye funksionimi i trekëndëshit, Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme, është i domosdoshëm.

Ministria e Arsimit duhet të ketë rol të rëndësishëm, konkretisht trajnimin e mësimeve për çështjen e drogave. E vërteta është se shumë prej mësimeve në Kosovë kanë vështirësi në leximin e literaturës së re për çështjen e drogave, sidomos atë në gjuhën angleze, pastaj, organizimi i debatit dhe dialogu me nxënësit, mësimeve dhe prindërit është detyrë e Ministrisë së Arsimit. Bashkëpunimi me këshillat e nxënësve dhe këshillat e prindërve po ashtu është detyrë e Ministrisë së Arsimit dhe kjo nuk po ndodh.

Ministria e Shëndetësisë e ka pjesën e vet të punës. Fushata informuese e vetëdijesuese mund të bëhet dhe duhet të bëhet nga ekspertë, të cilët i takojnë kësaj fushe. Nuk mund askush më mirë dhe më saktë t'i shtjellojnë këto tema se sa mjekët e specializuar të kësaj lloji varshmërie. Ligjëratat nëpër shkolla duhet të udhëhiqen nga Ministria e Shëndetësisë. Mjekët duhet të jenë të pranishëm nëpër shkolla gjatë tërë vitit shkollor për t'i vetëdijësuar nxënësit për dukuritë negative, sidomos për përdorimin e substancave narkotike dhe kjo nuk po ndodh.

Ministria e Punëve të Brendshme, po ashtu e ka pjesën e vet të obligimeve. Policia si agjenci për zbatimin e ligjit e ka për detyrë ndalimin e transportit dhe shitjen e substancave narkotike, ndalimin e shitjes së drogave dhe konfiskimin e tyre, inicimin e rasteve në organet e drejtësisë. Rritja e sigurisë publike është obligim i qartë i Policisë së Kosovës, prandaj luftimi i transportit, shitjes, mbajtjes dhe përdorimit të drogave është në funksion të kësaj çështjeje.

Kjo në masë të kufizuar po ndodh, duket që prej këtij trekëndëshi të institucioneve e vetmja është policia që mundohet t'i përmbushë obligimet e veta. Sidoqoftë, nuk është

mjaft e suksesshme, nuk është arritur shkalla e nevojshme e veprimeve policore për të ndaluar transportin, shitjen, mbajtjen dhe përdorimin e drogave sikurse edhe konfiskimin.

Kjo mbase është e vërteta e gjendjes së tashme sa i përket përdorimit të drogave në shkolla. Prandaj, ky debat sot i thirrur nga deputeti Burim Ramadani, shpresoj se do ta marrë mbështetjen e deputetëve dhe ky mocion do të ndihmojë sadopak në luftimin e dukurive negative. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, zoti Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Debatet e tilla konsideroj se janë të mira dhe nga këto debate duhet të dalin përfundime të cilat i shërbejnë shoqërisë. Gjithashtu, ky debat mendoj se duhet të ngërthejnë në vete edhe dukuritë në përgjithësi të tjera negative të cilat janë në shoqërinë tonë e posaçërisht të cilat kanë filluar të kenë një shtrirje tek nxënësit, pra për drogën, alkoolin dhe duhanin.

Ne jemi të vetëdijshëm dhe përkrahim Ministrinë e Arsimit, konkretisht ministrin për veprimet të cilat i ka ndërmarrë në këtë drejtim, të cilat i ceku edhe në fjalën e tij, por ne konsiderojmë se për këto fenomene duhet një trajtim më gjithëpërfshirës. Konkretisht duhen veprime urgjente dhe në këtë mes të instrumentalizohen sa më shumë prindërit. Pra, prindërit duhet të jenë faktori kryesor në këtë mes.

Jo rastësisht, gjatë shqyrtimit të Ligjit për arsimin parauniversitar ne patëm kërkuar që komponenti edukativ të shtohet në sistemin e arsimit si një faktor shumë i rëndësishëm për luftimin e këtyre dukurive, mirëpo ligji aktualisht trajton vetëm komponentin arsimor.

Ja një shembull se çka po ndodh në disa prej shkollave të Kosovës. Në javën e kaluar patëm një postim në mediat elektronike se në një shkollë të mesme në Gjilan, pra “Thimi Mitko”, shkollë e mesme e ulët, është postuar një video në internet ku shihet qartë se çfarë edukate kanë nxënësit dhe si i lejon profesori që ata të sillen në atë mënyrë. Disa nxënës lehnin sikur qenë, disa sikur majmunë, kurse disa të tjerë imitonin lopët.

Unë e di që ministri nuk i ka fajet për këtë, por njerëzit tjerë të cilët janë kompetentë, drejtoritë e shkollave, arsimtarët, prindërit dhe shoqëria në përgjithësi. Mirëpo për këtë rast kisha pasur dëshirë të di se a ka marrë ndonjë veprim MASHT-i apo Departamenti i arsimit komunal dhe prindërit a janë lajmëruar dhe çfarë veprimesh kanë ndërmarrë së bashku?

Ne jemi shumë të vetëdijshëm se në këtë mes duhet që Inspektorati të jetë më aktiv, gjithsesi policia dhe gjyqësori dhe të marrin masa në mënyrë që të tjerët të edukohen. Gjithashtu i bëjmë thirrje nxënësve që t'i lajmërojnë rastet.

Kjo pra nuk duhet të kuptohet sikur një spiunllëk për shokët apo shoqet, por ruajtje për shëndetin e tyre, shëndetin e tyre mendor dhe fizik dhe në këtë mënyrë ta ruajnë edhe vetveten, sepse edhe ata i ekspozohen kësaj dukurie.

Ne i japim mbështetjen tonë të plotë ministrit të Arsimit për të gjitha veprimet të cilat i ka bërë dhe shpresojmë se edhe në të ardhmen do të ketë suksese në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”.

MYFERA SINIK: Sn Başkan, bakanlar ve milletvekilleri
İlkokul ve liselerde esrara kullanımıyla ilgili gensoru başlattıklarından dolayı AAK ve milletvekili Burim Ramadani’yi tebrike diyorum.

Çünkü esrar olayı öğrencileri, vekilleri, akabinde toplumu tehdit eden bir konudur.

Esrar kullanımı artık sadece olgun (erişkinlerde) kişilerde değil, maalesef ilkokul öğrencilerine kadar ulaştı.

Esrar kullanımı başlama yaşı artık 12 - 13, doğrusu ilkokul 8. sınıflara hatta okul avlularına kadar geldi.

Bu durumu ne öğretmenlerin, ne okul müdürlerinin ne de çevrenin görmezlikten gelmemesi gerek.

Aynı zamanda AAK grubunun özellikle milletvekili Burim Ramadani’nin Kosova Hükümeti’ne sunmuş olduğu önergeleri bütün milletvekillerinin kabul etmesi gerektiğine inanarak, 6+ Parlamenter Grubu da destekleyeceğini bildirmek isterim.

Konuyla ilgili ivedilikle tedbir alalım, sağlıklı gençlik yaratalım, sağlıklı toplum oluşturalım.

Teşekkür ederim

KRYESUESI: Faleminderit! Pas fjalës së shefave të grupeve parlamentare dhe deklaratave të tyre, bëjmë pauzë deri në orën 15:00, kur edhe do ta vazhdojmë debatin. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i seancës pasdite

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

E vazhdojmë debatin dhe seancën. Paraprakisht ju njoftoj për kohën që ka mbetur.

- Partia Demokratike e Kosovës, 33 minuta;
- Lidhja Demokratike e Kosovës, 36,5 minuta;
- Lëvizja “Vetëvendosja”, 11,5 minuta;
- Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, 14,5 minuta;
- Koalicioni për Kosovë të Re, 7,5 minuta;
- Grupi “6+”, 5,5 minuta;
- SLS, 13 minuta dhe
- Pa grup, 18 minuta.

E vazhdojmë debatin. Fjalën e ka kërkuar deputeti Fadil Demaku.

FADIL DEMAKU: I nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Gjatë periudhës qeverisëse nga Partia Demokratike, çështja e arsimit ka qenë prioritet i madh, duke pasur parasysh nivelin në të cilin kishte qenë paraprakisht arsimi në vend. Së pari mungonin kushtet elementare për shkollim, duke përfshirë ambientin shkollor, pastaj demotivimi që i kishte përfshirë të gjithë mësimdhënësit, pasi nuk kishte kurrfarë stimulimi për punë. Ishte Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike që i kishte evidentuar këto çështje si esenciale për të ndërmarrë masa urgjente që në radhë të parë të krijojnë stabilitet dhe parakushte për hapat e tjerë në avancimin e gjithë sistemit arsimor me të gjitha segmentet e tij.

Askush nuk mund t’i mohojë të arriturat e deritanishme dhe investimet e mëdha që janë bërë në arsim dhe askush nuk e ndien më mirë se mësimdhënësit dhe nxënësit këtë, e kjo është bërë pa përjashtim në gjithë territorin e vendit. Të gjithë jemi të vetëdijshëm se për të ecur në hap me kohën, duhet angazhim mjaft i madh në fushën e arsimit, pasi në kohën e tanishme, vendet e zhvilluara e demokratike investojnë shumë në arsim, prandaj edhe për vendin tonë arritja e objektivave për një arsim cilësor dhe modern është dhe do të jetë sfidë e vazhdueshme. Të punohet vazhdimisht në përmirësimin e cilësisë së arsimit, që nxënësit që e mbarojnë shkollimin në Kosovë të zotërojnë njohuri, shkathtësi dhe shprehje që janë të krahasueshme dhe konkurrense njëkohësisht me bashkëmoshatarët e vendeve të tjera.

Por, drejt avancimit dhe modernizimit të sistemit arsimor dalin edhe shumë çështje të cilat kërkojnë ndërmarrje dhe veprime konkrete dhe të menjëhershme. Problemi në fjalë, si mundësia e përdorimit të drogave në shkollën fillore dhe të mesme, është shqetësim me vend dhe i arsyeshëm. Ky është problem shqetësues, jo vetëm në vendin tonë, por me të ballafaqohen edhe vendet e tjera, varësisht se në cilin nivel janë të përfshira ato.

Kur të shikohen gjërat nga planet dhe projektet, nuk qëndrojmë keq, sepse është plani strategjik i arsimit në Kosovë 2011-2016, strategjia kombëtare për programin, shkollat promovuese të shëndetit, 2009-2018. Ministria e Arsimit është pjesë e grupeve punuese në hartimin e strategjisë kombëtare kundër drogave, në periudhën 2009-2012 dhe 2012-2017, kur nëpërmjet programeve të rregullta duhet realizuar objektivat e shëndetit publik nëpërmjet aktiviteteve shkollore. Janë realizuar trajnimet e mësimdhënësve dhe janë përfshirë temat në lëndët shkollore, të cilat i trajtojnë këto çështje.

Ministria, në bashkëpunim me Policinë, e ka miratuar edhe kërkesën për projektin për parandalimin e përdorimit të substancave narkotike në institucionet shkollore; pastaj bashkëpunimi me organizatat joqeveritare, gjithherë në interes të vetëdijesimit, por më e rëndësishmja në gjithë këtë proces mendoj, se jo për ta larguar çështjen apo vëmendjen nga Ministria e Arsimit, por në këto çështje duhet të ketë një përfshirje të gjerë të shumë institucioneve, të cilat, çdonjëra, duke e kryer punën e vet, mund ta fuqizojë çështjen për t'i parandaluar këto çështje, sepse shkalla e ndërgjegjësimit të nxënësve mendoj se si veprim mund të jetë ajo e fundit.

Duhet të ndërmerren masa tjera, paraprakisht të punohet shumë nga institucionet tjera të vendit, të cilat do ta bëjnë të pamundur që substancat narkotike të lëvizin në vendin tonë, që kontrabanduesit të ndalohen, që të mos u ofrohen nxënësve dhe pastaj është hallka e fundit që nxënësit të jenë të vetëdijshëm për rrezikun që e sjellin ato.

Ne duhet t'i shfrytëzojmë të gjitha mediumet tona në shërbim të kësaj fushate, të shfrytëzohen televizionet tona nacionale maksimalisht në shërbim të fushatave kundër këtyre dukurive negative, sepse përqindja më e madhe e popullsisë sonë është e moshës rinore dhe shtrirja e një dukurie të tillë në rininë tonë do të thotë goditje e rëndë për gjithë shoqërinë. Duhet veprime konkrete dhe të ashpra, në bashkëpunim me Policinë, që të merren masa parandaluese. Ne e kemi një rini të shëndoshë dhe të merren hapat me kohë se mund të bëhet vonë më pas, kur degjenerimi mund të bëhet të bëhet fakt dhe shoqëria të mësohet me të. Këso problemesh kanë pasur dhe vendet tjera para nesh. Faleminderit!

KRYETARI: I lus deputetët të koncentrohen pak edhe në temë, edhe pse tema nuk është aq shumë e arsimit, por megjithatë kërkuar e ka kërkuar në mënyrë të tillë. Më mirë ka qenë debat për këtë çështje, sesa për ta adresuar në arsim. Megjithatë, ne po vazhdojmë, por përmbajuni temës. Deputetja Vjollca Krasniqi e ka fjalën.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Trafikimi i drogave është një ndër aktivitetet ilegale më fitimprurëse të krimit të organizuar, së bashku me trafikimin e qenieve njerëzore, kontrabandën, krimin ekonomik, pastrimin e parave e tjerë. Sipas Raportit të Progresit dhe raporteve tjera ndërkombëtare, Kosova nuk përbën vetëm një rrugë transiti të drogave, por është vend ku paktohet, tregtohet, abuzohet dhe përdoret ajo.

Gjithnjë sipas këtyre raporteve të organizatave joqeveritare vendore, sot flasim për një numër në rritje të rasteve të personave, të cilët marrin lëndë narkotike. Nga viti në vit, numri i përdoruesve të drogës e ka një trend në rritje, por ajo që mbetet më problematike dhe shumë shqetësuese është se këta përdorues janë të rinj dhe adoleshentë. Nxënësit e shkollave janë të ekspozuar ndaj drogave në mjediset shkollore, ose rreth tyre, pra po u ofrohet përdorimi i narkotikëve pranë mjedisit shkollor, çka do të thotë që trafikantët e drogës funksionojnë tashmë kudo, edhe pranë shkollave.

Ky fenomen vrastar ka atakuar edhe bankat shkollore. Numri i përdoruesve është më i madh në pjesën urbane të vendit. Të konsideruara si vende të shkollimit dhe edukimit, institucionet arsimore po shfrytëzohen si vendet më të favorizuara të shpërndarësve të drogës, të cilët e gjejnë në oborrin e kësaj të fundit klientelën e tyre të preferuar dhe perfekte. Fenomeni është i përhapur gjerësisht në shkollat e mesme, por ky përdorim ka arritur deri te fëmijët në shkollat nëntëvjeçare. Të rinjtë deklarojnë hapur se nuk është problematike të furnizohesh me drogë, e aq më pak e çuditshme përdorimi i saj. Edhe pse Policia e Kosovës del me shifra për rate të caktuara të zbulimit të grupeve trafikuesish droge, kjo është e pamjaftueshme, duke marrë parasysh trendin në rritje të këtij fenomeni.

Nëse janë ndërmarrë të gjithë ata hapa për parandalimin e kësaj dukurie, ashtu siç u pretendua nga një folës nga pozita, nuk do të kishim nevojë as ta mbanim këtë debat, sepse fatkeqësisht realiteti është ndryshe. Për këtë problematikë janë organizuar seminare, tryeza, fletushka të botuara nga organizatat që merren me këtë çështje, por institucionet përgjegjëse nuk janë marrë asnjëherë seriozisht me këtë çështje. Shërbimet e trajtimit për varshmëri nga droga janë shumë të kufizuara, si në aspektin e mbulimit, ashtu edhe të shtrirjes së shërbimeve.

Trajtimi në sektorin e shërbimeve publike shëndetësore lidhur me problemet me drogë ofrohet vetëm në spitalet psikiatrike. Andaj, të nderuar kolegë, i nderuar ministër, ju si udhëheqës i kësaj ministrie, ministritë tjera, e gjithë Qeveria, ne si Parlament, së bashku me shkollën, mësimdhënësit, komunitetin dhe tërë shoqërinë, duhet të përballemi me këto të këqija, sepse jeni përgjegjës ju dhe ne. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Albana Gashi.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryetar!

Një nga format e krimit të organizuar në Kosovë është edhe trafikimi i drogave. Këtu u tha që Kosova nuk përbën vetëm një rrugë transiti të drogave ilegale, por ajo është edhe një vend destinacioni, është edhe vend kultivimi i drogave të lehta. Prania e këtyre substancave narkotike nëpër ambientet e ndryshme publike shpeshherë është lehtë e identifikueshme. Shqetësuese është se këto lloje substancash me pasoja fatale gjenden edhe nëpër hapësirat edukativo-arsimore.

Të konsideruara si vende të edukimit e shkollimit, institucionet arsimore po shfrytëzohen si vendet më të favorizuara të shpërndarësve të drogave, ku numri i përdoruesve ka shënuar dukshëm rritje.

Niveli i përdorimit të drogave nga të rinjtë është në rritje, me problematikën më të madhe se këta përdorues janë adoleshentë, duke filluar nga mosha 12-vjeçare, e që nënkupton që përdorues të drogës janë edhe nxënësit e shkollave fillore, duke filluar nga klasa e VI, klasa VII e më tutje.

Arsyet dhe shkaqet e konsumit janë të shumta dhe si shkak mund të jetë edhe jovetëdijesimi i të rinjve, mungesa e programeve parandaluese dhe vetëdijesuese në nivelin shtetëror nëpër shkolla.

Qasja e lehtë të drogës vjen si pasojë e tranzicionit të vlerave shoqërore, mungesa e angazhimeve alternative të rinjtë, dëshira e të rinjve për të eksperimentuar me gjëra të ndryshme, gjendja e vështirë ekonomike dhe sociale, nevoja për t'i ikur një realiteti të tillë dhe mungesa e kontrollit në nivel të duhur, si dhe një kujdes më i madh nga prindërit për fëmijët e tyre.

Përveç kësaj, kemi edhe një dështim të institucioneve të Kosovës që të bëjnë më shumë në parandalimin e kësaj dukurie, gjersa nga shkollat nuk ka ndonjë gatishmëri të veçantë që ta parandalojë këtë dukuri. Nuk ka aktivitete parandaluese, aktivitete psiko-sociale, debate me nxënës, koordinim të të gjithë aktorëve në vetëdijesimin e nxënësve rreth pasojave dhe dukurive negative, që sjellin konsumimin e duhanit, alkoolit, substancat narkotike e tjera.

Gjithashtu, mungojnë programet parandaluese të dedikuara për ta paralajmëruar rrezikun e përdorimit të drogës, të përshkruara pa përkujdesjen dhe mbikëqyrjen e mjekut. Një çështje që është me të vërtetë shqetësuese dhe që nuk është trajtuar asnjëherë janë edhe lokalet të cilat gjenden kudo përreth shkollave, ku shpesh ushtrohen veprimtari të dyshimta, duke përfshirë edhe përdorimin e drogës.

Si mjaft shqetësues në Kosovë mbetet edhe konsumi i duhanit të rinjtë në shkolla. Sipas hulumtimeve të bëra nga organizatat joqeveritare që merren me vetëdijesimin e të rinjve për pasojat e konsumit të duhanit, thuhet se rreth 40% e të rinjve nëpër shkolla konsumojnë duhan. Konsumi i duhanit dhe alkoolit i paraprin konsumimit të substancave narkotike. Nuk mund ta trajtojmë problemin e përdorimit të drogës nëpër shkolla si një problem të veçantë, pa i trajtuar dhe parandaluar edhe problemet e konsumimit të duhanit, alkoolit dhe pranisë së dhunës nëpër shkolla.

Në vetëdijesimin e nxënësve dhe të rinjve duhet të involvohen shkollat, policia, nxënësit, prindërit, psikologët e shkollave, shoqëria civile, e mbi të gjitha edhe Ministra e Arsimit nëpërmjet futjes së aktiviteteve, debateve dhe iniciativave të ndryshme në programet arsimore për një edukim sa më të shëndetshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Përdorimi i substancave psiko-aktive paraqet një kërcënim serioz për shëndetin dhe zhvillimin shoqëror e ekonomik të kombeve, komuniteteve, familjeve dhe të rinjve. Numri i përdoruesve të substancave psiko-aktive në nivel botëror arrin në 2 miliardë konsumues. Kosova ndodhet në Evropën Juglindore dhe e ka një sipërfaqe prej 10 887 kilometra katror. E ka një popullsi shumë të re. Shumica e popullsisë jeton në vendet rurale, jashtë kryeqytetit, jashtë Prishtinës. Çështje kyçe në Kosovë dhe për rininë e saj është papunësia. Përqindja e papunësisë në barë vendin supozohet të jetë 40% , gjersa ekonomia po shënon përparim mesatar, mesatarja e vjetore e të ardhurave për kokë banori për familje është më e ulëta në tërë Evropën.

Të dhënat dhe vlerësimet e përgjithshme të kohëve të fundit tregojnë për një nivel të lartë të përdorimit të drogave edhe nga nxënësit e shkollave, edhe ato të mesme dhe fillore, dhe çdo ditë po rritet numri i përdoruesve të rinj. Programet parandaluese të abuzimit me substanca mbeten të pakoordinuara dhe me përqindje të ndryshme. Sa i përket përfshirjes së grupeve të popullsisë në rrezik, OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare kanë implementuar programe parandaluese, afatshkurtra, e po ashtu edhe programet qeveritare dhe ato të Kombeve të Bashkuara vazhdojnë t'i përkrahin programet afatshkurtra. Me zvogëlimin e asistencës financiare ndërkombëtare, përveç nëse identifikohen burimet financiare qeveritare apo të tjera, numri i programeve të financuara parandaluese dhe puna në terren do të vazhdojë të zvogëlohet.

Aktualisht, mungojnë programet shkollore të planprogrameve sistematike mbi parandalimin e abuzimit me substanca në sistemin shkollor. Gjithashtu, mungojnë programet parandaluese të dedikuara për ta paralajmëruar rrezikun e përdorimit të drogave të përshkruara pa përkujdesje dhe mbikëqyrjen e mjekut.

Edhe pse janë shumë subjekte që kanë informacione mbi drogat, nuk ekziston një studim i mirëfilltë gjithëpërfshirës që do ta tregonte dimensionin e vërtetë të problemit të drogave. Në nivelin kombëtar, mungojnë studimet dhe hulumtimet mbi përdorimin e drogave te popullsia e përgjithshme.

Strategjia kombëtare kundër drogës e Kosovës dhe plani i aksionit, i miratuar në vitin 2009, i ka si prioritet masat preventive kundër drogës si pjesë e aktiviteteve të reduktimit të kërkesës për drogë. Strategjia promovon kujdesin dhe rehabilitimin e përdoruesve të drogës, parandalimin e përdorimit të drogave dhe eksperimentimin me drogat, intervenimet e hershme për t'i reduktuar pasojat shëndetësore dhe sociale që lidhen me përdorimin e drogave dhe qasje në shërim, rehabilitim shoqëror dhe integrim. Strategjia parashih intervenimet preventive që synojnë grupet specifike, institucionet shkollore dhe ato parashkollore, familjet dhe shoqërinë, në përgjithësi. Mirëpo, sa po realizohen këto?

Nuk ekziston një sistem i mbledhjes së të dhënave që e mbulon trajtimin për drogë në gjithë vendin. Trajtimi i drogës në Kosovë momentalisht ofrohet nga dy subjekte kryesore, Qendra Psikiatrike Klinike Universitare dhe disa OJQ. Aq më shumë ofrojnë shërbimet e pastrimit, trajtim psiko-social dhe trajtim, duke përdorur medikamente të ndryshme. Klinika Psikiatrike e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës është një shërbim publik për gjithë vendin dhe ofron programet e ditoksifikimit. Megjithatë, nuk ofron trajtime në rast të mbidozimit, të cilat menaxhohen nga qendrat emergjente të institucioneve të tjera shëndetësore. Kjo klinikë ofron trajtim ambulator dhe spitalor dhe paraqet burimin kryesor të informatave mbi kërkesat për trajtim.

Nuk ekziston një e dhënë e saktë mbi numrin e të vdekurve nga droga në Kosovë. Të dhënat zyrtare mbi vdekjet e shkaktuara nga droga janë relativisht të dobëta, faktikisht inekzistente dhe atë për shkak të disa arsyeve. Ekziston një mungesë e vetëdijes së përgjithshme në mesin e profesionistëve të shëndetit në lidhje me vdekjet e shkaktuara nga droga dhe si rezultat, numri i vdekjeve të shkaktuara nga mbidozimi me drogë, në mënyrë sistematike kualifikohen si sulme kardiake. Nuk ka bashkëpunim dhe koordinim ndërmjet agjencive përkatëse dhe nuk bëhet shkëmbimi i informacioneve në lidhje me

vdekjet e shkaktuara nga droga. Edhe pse laboratori toksikologjik i Institutit për Mjekësi Ligjore është në gjendje që të konfirmojë vdekjet e shkaktuara nga droga, ekziston një mungesë e informatave dhe mungesë e vetëdijes mbi ekzistencën e kësaj lloji agjencie të kualifikuar.

Andaj, ne themi gjithmonë se rinia është ardhmëria e Kosovës dhe mburremi se jemi vendi ku rinia e përbën numrin më të madh të popullsisë, prandaj ne duhet seriozisht të angazhohemi në këtë drejtim që ta mbrojmë rininë dhe ta mbrojmë popullsinë nga kjo sëmundje e pashërueshme. Andaj, i përkrahim të gjitha rekomandimet e dhëna nga deputeti që dalin nga kjo interpelancë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti Krasniqi!

Duke marrë parasysh interpelancën, e cila është ngrehur nga grupi parlamentar i AAK-së për çështjen e përdorimit të drogës për shkollat fillore dhe të mesme, mund të themi të gjithë se nuk është problemi vetëm i Grupit Parlamentar i AAK-së për përdorimin e drogës në shkollat fillore dhe të mesme, mirëpo është problem i të gjithë deputetëve dhe i Qeverisë për arsye se këta fëmijë janë e ardhmja e Kosovës dhe për këta fëmijë është kah mundohet edhe Parlamenti edhe Qeveria dhe të gjitha institucionet e vendit.

Në rast se i shohim kompetencat adekuate për çështjen e ndalimit të përdorimit të drogës në shkollat fillore dhe të mesme, dihet mjaft mirë se nëpër rrugët e Kosovës trafikohet, paketohet dhe shitet, mirëpo çështja se si duhet të ndalohej dhe nga duhet të fillojë, mund të them se në veçanti duhet të nisët nga Komuna, nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nga Ministria e Shëndetësisë, nga Ministria e Punëve të Brendshme, e po shihet se dy ministrat e fushave nuk janë këtu që të fillojmë të punojmë për parandalimin e drogës, për arsye që t'i ruajmë fëmijët apo ardhmërinë e Kosovës, në të mirë të këtij vendi.

Në rast se i shohim rekomandimet, të cilat i ka propozuar Grupi Parlamentar i AAK-së, atëherë do të mbetet që këto çështje të diskutohen ndoshta në fund nga të gjithë shefat e grupeve parlamentare, që ta kemi një harmonizim, për arsye se edukata e fëmijëve, pikë së pari, vjen nga familjet e tyre, nga shkolla, dhe atëherë të shohim cilat duhet të jenë mundësitë që ta parandalojmë një të keqe këtyre fëmijëve të Kosovës për të ardhmen e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Aurora Bakalli.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kriza e përgjithshme ekonomike, morale, kulturore, mungesa e sundimit të ligjit po reflektohet fatkeqësisht edhe me dukurinë në rritje të narkomanisë. Është shumë shqetësuese se edhe në shkollat tona kanë filluar të përdoren substancat narkotike. Kjo dukuri para një kohe, jo shumë të largët, ka qenë një fenomen i panjohur për shkollat tona dhe për pjesën dërmuese të rinisë tonë. Ndërkohë, sipas raportit të ESPAD (European Schools Survei Project) të vitit 2011, për Kosovën, një nga dhjetë nxënësit e anketuar

raportojnë se mund të vijnë lehtë apo shumë lehtë deri te kanabisi, apo hashashi. Kjo shifër, megjithatë, është më e ulët sesa mesatarja e shteteve evropiane, ku çdo i treti nxënës raporton se lehtë apo shumë lehtë mund të vijë deri te kanabisi.

Ndërkohë, gjithnjë duke iu referuar të njëjtit hulumtim, rreth 7% e nxënësve kosovarë e kanë përdorur ndonjëherë ndonjë substancë narkotike, që sërish është shifër më e vogël sesa mesatarja evropiane, prej 20%. Megjithatë, duke pasur parasysh se çfarë ka qenë gjendja te ne më parë në këtë aspekt, atëherë kësaj dukurie duhet kushtuar shumë vëmendje, në mënyrë që të mos marrë përmasa, si në shumicën e vendeve të tjera evropiane.

Ne si shoqëri, si virtyt kryesor e kemi pasur rininë e shëndoshë dhe këtë virtyt duhet ta ruajmë me çdo çmim. Ndër hapat konkretë që rekomandojmë ne si Lëvizje për Bashkim në këtë drejtim dhe që nuk janë përmendur në rekomandimet e kësaj interpelance, janë:

1. Krijimi i një departamenti të veçantë në kuadër të Ministrisë të Punëve të Brendshme, i specializuar për luftimin dhe parandalimin e delikuencës së të miturve;
2. Në shkolla të jenë të pranishëm psikologët që t'i kryejnë detyrat dhe obligimet e tyre;
3. Të ketë bashkëpunim të fuqishëm dhe të ngushtë ndërmjet shkollave, qendrave për punë sociale dhe Ministrisë të Punëve të Brendshme;
4. Të punohet seriozisht në aktivitetet ekstra kurrikulare shkollore, siç janë sporti dhe kultura, të cilat do të jenë mundësi e mirë për angazhimin e të rinjve dhe në këtë mënyrë largimin e tyre nga rrugët e këqija, siç e kemi kërkuar edhe në debatin për sportin, që e kemi pasur kohë më parë.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Emir Ahmeti e ka fjalën.

EMIR AHMETI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Pajtohem plotësisht me kolegët deputetë për këtë debat, ashtu siç e quajti edhe kryetari, por meqenëse në rendi e ditës shkruan se është debat lidhur me arsimin në Kosovë, do të mundohem që këta tre minutat e mi t'i përmbledh sa të mund për këtë çështje.

Mendoj se angazhimi ynë i të gjithëve për luftimin e narkotikëve në shkolla, është multidisiplinar, u pajtuam të gjithë këtu, por atë çka mund të bëjë Ministria e Arsimit është e edhe një çështje tjetër shqetësuese për shkollat tona, që në bashkëpunim me komunat mund të veprojnë që të mos u lejohet veprimtaria, si bastoreve dhe lojërave të fatit, të cilat janë të fokusuara pranë shkollave dhe si cak i kanë nxënësit tanë nëpër

shkolla. Për këtë arsye, mendoj se për këtë nuk ka nevojë një angazhim multidisiplinar, por Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me komunat, mund ta realizojë këtë çështje.

Çështja tjetër të cilën dua ta përmend ndërlidhet me Ministrinë e Arsimit, e ka të bëjë edhe për edukimin. Nga kjo ne po vërejmë se fëmijët tanë nuk kanë nevojë vetëm për arsimim, por gjatë arsimimit edhe edukim, që nënkupton një angazhim më të madh të Ministrisë së Arsimit, për rishikimin e teksteve për mësimet të cilat i përmbajnë, ato kanë shumë gabime, por edhe nuk kanë shumë porosi edukative.

Është bërë një hulumtim nga gazetarët hulumtues të të BIRN-it, se janë me qindra gabime dhe devijime në librat e historisë, të gjeografisë dhe në librat tjerë shkollorë, që nxënësit tanë mësojnë nëpër shkolla dhe, për fat të mirë, prej publikimit të këtyre hulumtimeve, që i kanë bërë këta gazetarë hulumtues, disa i ka përmirësuar Ministria e Arsimit, disa kanë mbetur pa u përmirësuar. Ndërkaq e përgëzoj Ministrinë e Arsimit për ndërmarrjen e hapave për rishikimin e historisë, e jo ndryshimin e saj, sepse historia jonë është ndryshuar gjatë periudhës së kaluar të komunizmit dhe tash duhet ta shkruajmë historinë e vërtetë qysh e kemi. E njëjta gjë vlen edhe për rishikimin e librave shkollorë, të cilat duhet të përmbajnë më shumë edukim për fëmijët, e të ketë më pak devijime dhe informata jokonkrete dhe, e fundit, do të kisha kërkuar nga ministri i Arsimit që të vazhdojë në praktikë zbatimin konkret të unifikimit të teksteve shkollorë ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, sepse ato kanë mbetur vetëm në letër si bashkëpunim ndërmjet dy vendeve, por nuk është bërë ende rishikimi i teksteve në brendësi. Për këtë mendoj se Ministria e Arsimit duhet të angazhohet edhe më shumë. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe një herë po ju them, ju lutem në temë! Mendoj se është tema që do trajtim, trajtimi tamam i temës. Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Nuk mund të filloj pa e falënderuar propozuesin e kësaj teme, e cila është mjaft e qëlluar dhe e komplimentoj për këtë. Është e vërtetë që droga dhe përdorimi i saj është problem global. Në të gjitha sferat, në të gjithë meridianët e globit, ndoshta është problem më i madh gjithkund sesa në Kosovë, por në Kosovë ka një syth, ka zënë fill përdorimi i substancave narkotike dhe ky problem duhet ta shqetësojë shoqërinë tonë dhe është fat i mirë që iniciuesi i kësaj çështjeje e ka filluar në Parlament dhe do të trajtohet natyrisht në të gjitha poret e shoqërisë.

Kosova e ka një strategji kundër përdorimit të substancave narkotike, e ka edhe një program, na tha ministri i Arsimit, për përkujdesje në shkolla, që ajo të mos futet. Është e vërtetë që ende nuk është problem në trajtim dhe për trajtim imediat, por edhe parafolësit, edhe të tjerët që do të flasin pas meje, do ta vlerësojnë se është mjaft temë për shqetësim. Unë për veten time nuk shquhem si ekspert i kësaj fushe, i kësaj problematike dhe i kësaj çështjeje, por e kam një eksperiencë, e kam një përvojë jetësore. Kam jetuar në mesin e narkomanëve dhe unë e kam parë jashtëzakonisht mirë se si fillon me ëmbëlsi përdorimi i saj dhe pastaj ka fund të tmerrshëm dhe një ferr të vërtetë.

Më ka rastisur në Burgun e Goli-Otokut të shohë pa përdorues të drogës, të cilët, për një moment kënaqësie, pastaj bëheshin të varur, bëheshin të pandashëm me të dhe as vetë nuk e di se si depërtonte dhe aty e kam mësuar një të vërtetë. Dhe, jo vetëm në Goli-Otok dhe në Stara Gradishkë, edhe në Lepogllavë, edhe në Sremska Pozhegë, edhe në Petritska të Zagrebit, edhe në Viaromë të Rjekës, edhe në Burgun e Qarkut të Gospiqit. Është shumë e çuditshme çfarë kanalesh gjen dhe krijon qarkullimi i drogës, i substancave narkotike.

Imagjinojeni kur depërton pas 7 dyerve të hekurit, qarkullon pas 7 palë hekurave, merreni me mend si mund të depërtojë nëpër klasat e shkollave tona edhe nëpër rrugët e vendit tonë. Ky duhet të jetë shqetësim për të gjitha institucionet, të cilat duhet të merren me këtë fenomen. Nga kjo përvojë, dua të tërheq vëmendjen që shoqëria jonë duhet ta trajtojë jashtëzakonisht sa është në fillim. Është fakt që niveli i zhvillimit ekonomik të shoqërisë sonë nuk e preferon dhe nuk mund ta durojë blerjen dhe konsumimin e saj. Është fat i mirë që vendi ynë, Republika e Kosovës nuk është vend prodhues, nuk është vend konsumues me theks të veçantë. Është vend transit, por në këtë fenomen transitor, kjo edhe mund të skajohet, mund të ndalet dhe mund të konsumohet.

Konsumimi i saj mund të rritet me zhvillimin e shoqërisë, me ngritjen e ekonomisë së vendit tonë. Prandaj, institucionet e Kosovës, të gjithë ata që janë kompetentë, me shumë lehtësi mund t'i qasen kësaj teme, mund t'i qasen këtij fenomeni dhe mund ta parandalojnë sa nuk është bërë ende problem i shoqërisë së Kosovës.

Unë edhe një herë u bashkohem të gjitha shqetësimeve që mund t'i marr me mend dhe nuk mund t'i imagjinoj shumë lehtë dhe nuk mund t'i përjetoj krejt indiferent ato imazhe që i kam parë te ata përdorues droge, me të cilët kam pasur një bashkëjetesë, kam jetuar, prandaj quhet bashkëjetesë, në atë kuptimin që kemi jetuar, por kemi pasur koncepte krejt tjera, kemi pasur moral krejt tjetër. Mua edhe të ma jepnin, edhe shokëve të mi bashkëvuajtjes që kanë qenë për vepra politike, edhe po të na e konvertonin me heqje burgu, edhe po të na bënin ofertë për t'i hapur dyert e burgut, nuk do ta futnim gishtin aty, nuk do ta përdornim fare, por nga kjo përvojë e di që është një tërheqje e bardhë, është një ofertë e ëmbël, por e ka një fund të zi, e ka një fund të tmerrshëm dhe e dini se si përfundonin ata?

Secili nga ata që i vonohej koha për ta përdorur drogën, nuk gjente zgjidhje tjetër, përveçse ta presë vetveten. Ia fillonin t'i presin enët e gjakut nga duart dhe pastaj kudo që i lejonte fuqia, gjakderdhja shpërthente në trupin e tyre.

Kjo tregon që në rastet kur përdoruesi i rregullt nuk ka mundësi të konsumojë, atëherë bëhet katil i vetvetes dhe pastaj ky është shqetësim për të gjithë ata që jetojnë përreth përdoruesit të substancave narkotike. Unë për veten time e shkëmbeva një përvojë, një eksperiencë dhe e barta këtu në këtë Parlament për ta ilustruar gjithë shqetësimin me të cilin duhet të familjarizohet shoqëria jonë dhe veçanërisht institucionet kompetente. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Nazane Breca e ka fjalën.

NAZANE BRECA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është evidente se përdorimi i drogave nëpër shkollat tona është gjithnjë në rritje e sipër, e këtë e vërtetojnë anketimet dhe intervistat që janë bërë me nxënësit e shkollave. Këtë e vërtetojnë edhe raportet evropiane, në bazë të të cilave kemi rritje të përdorimit të duhanit, alkoolit, marihuanës dhe drogave tjera nëpër shkolla. Është shqetësuese se mosha e atyre që përdorin drogë është gjithnjë në ulje e sipër, që do të thotë se këto përdoren edhe në shkollat fillore.

Normalisht që ne nuk mund të flasim me numra të saktë në lidhje me numrin e keqpërdoruesve të drogave, sepse sistemi i informimit shëndetësor nuk është zhvilluar sa duhet dhe nuk funksionon si duhet. Gjithashtu, është një mungesë shumë e madhe është se ne nuk e kemi asnjë institucion shëndetësor, i cili merret me trajtimin e keqpërdoruesve të drogës, që do të mund të na jepte të dhëna të mjaftueshme në lidhje me këtë problematikë dhe që do të mund të merrej me këto raste.

Problemi i keqpërdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogave është një problem kompleks dhe kërkon një qasje holistike të zgjedhjes së tij. Pasi është në rritje e sipër, kjo tregon se kemi një dështim të shumë ministrive në parandalimin dhe zgjidhjen e këtij problemi. Në radhë të parë, Ministria e Arsimit, e cila e ka normalisht edhe barrën më të madhe, nuk ka një strategji të mirë dhe efikase në lidhje me këtë problematikë. Shkollat dhe punëtorët e arsimit që punojnë aty, sidomos ata që janë në pozita udhëheqëse, nuk kanë një koordinim dhe bashkëpunim ndërmjet tyre dhe me prindërit e fëmijëve, gjë që do të mund të ndikonte shumë që ky problem mos të bëhet më i madh.

Gjithashtu, këtu vjen në shprehje edhe mosaktiviteti dhe joefikasiteti i Ministrisë së Punëve të Brendshme në identifikimin e personave dhe grupeve kriminale që merren me shitjen dhe shpërndarjen e drogave. Bile ndonjëherë me veprimet që bëhen nga kjo ministri fitohet përshtypja se disa individë që punojnë aty kanë edhe bashkëpunim me këto grupe kriminale.

Gjithashtu vërehet edhe një mangësi dhe mosefikasitet i inspektorëve në kontrollimin e lokaleve dhe kafeneve përreth shkollave, ku më së shpeshti bëhet shitblerja e substancave narkotike. Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, kohë pas kohe zhvillojnë fushata në vetëdijesimin dhe ndërgjegjësimin e popullatës me këtë problematikë, por kjo nuk është e mjaftueshme. Kjo duhet të ndodhë më shpesh, e jo të priten ditët e caktuara kur do të bëhet kjo fushatë.

Duhet të punohet më tepër edhe nëpër shkolla në lidhje me edukimin shëndetësor të nxënësve, nëpërmjet të cilit ata do të marrin informata të mjaftueshme në lidhje me efektet e substancave narkotike dhe kur ata do të vetëdijesohen në lidhje me këtë problematikë. Gjithashtu, Ministria e Shëndetësisë ka dështuar sa i përket implementimit të shitjes së barnave vetëm me recetën e mjekut nëpër barnatore, me ç'rast popullata mund t'i marrë barnat sikur në minimarket, pa recetë të mjekut, e kështu ndodh edhe me shitjen e preparateve, që në vete përmbajnë substanca narkotike, që shërbejnë për

trajtimin e disa sëmundjeve dhe çrregullimeve, e këto preparate blihen pa recetë dhe keqpërdoren edhe nga abuzuesit e drogave.

Këtu duhet përmendur edhe atë se edhe pse ka ekzistuar për shembull Ligji për duhanin, i cili ndalon shitjen e duhanit fëmijëve nënë moshën 18-vjeçare, nuk është implementuar dhe inspektorët kanë dështuar në monitorimin e implementimit të këtij ligji.

Pra, pasi ky është një problem shumë kompleks dhe kërkon qasje holistike, atëherë duhet që Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, shkollat dhe prindërit të merren me këtë problematikë në mënyrë më serioze së bashku sa nuk është bërë shumë vonë, sepse përdorimi i përdorimit të drogave me vete sjell edhe problema tjera, si: kriminalitetin, prostitucionin dhe problemet sociale, të cilat ne i kemi me bollëk. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderua deputetë.

Kur flasim për shkollat dhe arsimin në Kosovë, mund të themi pa hezitim se bëhet për një dështim të shumëfishtë. Përshtypja dhe opinioni im është që ky dështim i shumëfishtë shtrihet në shumë fusha, në mësimdhënie, në tekstet shkollore me të cilat mësojnë nxënësit, të cilat janë një rrëmujë e vërtetë dhe janë tekste kryesisht joprofesionale. Kam parë shpesh, janë të përkthyer nga Google, nga njerëz amatorë. Por, sot po diskutojmë për një tjetër dështim që ka të bëjë me sistemin e sigurisë. Në rast se shifrat e tilla, të cilat janë paraqitur nga propozuesi i kësaj interpelance, janë të sakta, që fëmijët në shkolla të mesme dhe shkollat fillore janë të ekspozuar në mënyrë të tillë ndaj drogave, gjendja është me të vërtetë alarmante.

Këto janë shifra alarmante për një shoqëri në tranzicion, siç është Kosova, por edhe për çfarëdo lloj shoqërie, e cila do të kishte një sistem sigurie shumë më të fuqishëm. Që Kosova është vendi i trafikimit të drogave, i kontrabandës së drogave të cilat vijnë nga vendet e tjera, që është pjesë e këtyre rrjeteve, e ka konfirmuar edhe raporti i studimit të fizibilitetit, i cili thotë fare qartë, para pak muajsh, që shqiptarët ose ata që flasin shqip janë të përfshirë në mënyrë të rëndë në trafikimin e drogave, përfshirë heroinën dhe kokainën, si në rajon, ashtu edhe në Bashkimin Evropian.

Madje, sipas këtij raporti, në tre vjetët e fundit, niveli i kontrabandës së drogave dhe i qarkullimit të drogës nëpër Kosovë është rritur. Pra, kjo bie në kundërshtim të plotë me atë që mundohet ta paraqesë Qeveria që po e lufton krimin e organizuar, kontrabandën e tjera. Në fakt, kjo është nga kritikët më të rënda që i ka ardhur Kosovës në këtë raport. Mirëpo, tashmë është më se e qyrtë se gjendja ka ndryshuar. Kosova nuk është vetëm vend i trafikimit, por e dhe i destinacionit dhe i konsumimit dhe konsumatorët janë pjesa më e ndjeshme e shoqërisë, e që janë fëmijët.

Është për të të ardhur keq, kjo ndodh fare hapur, në sytë e Policisë dhe të institucione të sigurisë. Për shembull, të thuash se droga shpërndahet më së shumti te lokalet, të cilat

janë afër shkollave, kjo është më shumë se sa skandaloze. Nuk ka mundësi Policia të bëjë kontrolle, t'i mbajë nën kontroll këto lokale, kur janë kaq të evidentuar në raporte të ndryshme? Pse nuk ndodhë kjo? Apo ndodh për ndonjë arsye tjetër, për shembull për faktin që vetë Policia mund të jetë e përfshirë në këto krime.

Nuk është për t'u çuditur, sepse mjafton të kujtojmë atë çfarë ka ndodhur në Dhomën e Dëshmive në Polici, ku 500 kilogramë kokainë janë vjedhur. Natyrisht kjo mund të imagjinohet. Pikërisht në institucionet të cilat duhet ta luftojnë krimin, brenda tyre ndodh krimi, ndodh vjedhja e drogave dhe ndoshta është pikërisht kjo drogë, e cila po shpërndahet edhe nëpër shkollat dhe institucionet arsimore të Kosovës. Ndoshta ju e dini më mirë sa ka qenë, ka shumë mundësi.

Çështja tjetër është që nuk është vetëm droga ajo e cila po shpërndahet dhe nuk është i vetmi rrezik që u kanoset nxënësve nëpër shkolla. Çfarë do të thonë institucionet e sigurisë për shembull për bastoret e shumta, të cilat janë afër pothuajse çdo shkolle. Fëmijët janë të ekspozuar edhe ndaj këtyre bastoreve, të cilat gjithsesi, kudo që ato janë, janë burim i krimit, janë burim i konflikteve. Shpesh dëgjojmë edhe lajmeve të therjeve me thikë. Janë burim i manipulimit.

Jo më kot, njerëzit që merren me këtë lloj biznesi, i cili është mjaft i dëmshëm, i ndërtojnë këto pikërisht rreth shkollave, sepse mundësia e manipulimit të fëmijëve është shumë më e madhe. Mendoj se ky është një debat, i cili, përveç nivelit të sigurisë, përveç shkollave, ministrit të Arsimit, do të duhej minimum të ishte i pranishëm edhe ministri i Brendshëm, sepse ky është një debat që kërkon praninë e të dyve, në mënyrë që rezultatet e kësaj interpelance të merren shumë seriozisht dhe shumë parasysh nga këto dy institucione, të cilat janë përgjegjëse për fëmijët, për shkollat, për nivelin e arsimit, por mbi të gjitha edhe për nivelin e sigurisë, i cili, siç po shihet nga këto raporte, është shumë i cenuar. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Teutë Haxhiu. Zenun, është njëfarë rendi, kur të kryhet, të vjen radha ty.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përdorimi i drogave nga nxënësit tanë është një shqetësim shumë i madh, në radhë të parë për familjet e nxënësve, por gjithsesi për tërë shoqërinë. Këtë temë në emër të Grupit e Aleancës e elaboroi shumë mirë zoti Haradinaj, prandaj nuk do t'i përsëris fjalët.

Unë do të ndalem në çështjen se arsimi do të duhej të ishte një ndër prioritetet kryesore të qeverive, të të gjitha qeverive, besoj se pajtohemi gjithë ne, por a është prioritet për këtë Qeveri dhe Qeverinë e kaluar, unë them jo. Do të ndalem t'i rikujtoj vetëm dy nga premtimet e ish-ministrit të Arsimit: digjitalizimi i shkollave dhe shkollimi i mesëm i obligueshëm.

Te digjitalizimi i shkollave, për ç'gjë ishin ndarë edhe miliona euro, ato u shpenzuan dhe destinacioni i tyre nuk e di se nga është. U trajnuan një numër i madh i mësimeve në programin e ICDL, për çka të gjithë mësimeve, edhe pse jo të gjithë të trajnuar, ato njohuri që i morën me shumë mund, nuk kanë ku t'i aplikojnë. Pra, me një fjalë dështuan edhe milionat. Shkollimi i mesëm, pra, ashtu sikur ishte premtuar, normalisht se nuk u bë, dhe këtu kush përfitoi? Përfitoi ish-ministri me josingëritetin e tij. Tani, mungesa e laboratorëve nëpër shkolla sot, unë po i përmend vetëm dy shkolla, sepse ndodh shumë shpesh në letra, shkollat prezantohen se kanë laboratorë. Po i përmend vetëm gjimnazin "Xhevdet Doda" dhe "Sami Frashëri", në të cilët laboratorët në fakt ekzistojnë vetëm si objekt, e nuk e kanë asnjë mjet konkretizimi. Shpeshherë ndodh që edhe kur ndërtohen shkollat të reja, laboratorët të përdoren edhe për klasa.

Një shqetësim imi është edhe mospërgjegjësia e Ministrisë së Arsimit lidhur me vendimin e Agjencisë për Akreditim të programeve për Kolegjin "Universum" në Gjakovë dhe në Prizren, si dhe për Kolegjin e Biznesit në Prizren dhe Vushtri. Është një shqetësim, ngase këtë vendim që Agjencia e ka përcjellë në Ministri, ashtu sikur kemi dëgjuar, është një numër shumë i madh i studentëve dhe mua më intereson ta di se, e kam thënë edhe në fjalën time javën e kaluar, se është një vendim i vonuar, çfarë do të bëhet me studentët të cilët kanë shpenzuar mijëra euro. Ministria pra duhet të na informojë për këtë çështje. Nga informatat që kam, që nga viti 2008, asnjë nga bartësit e arsimit të lartë privat nuk ka licencë pune, pra kjo i bie që asnjëri nga bartësit e arsimit të lartë privat sot nuk do të duhej të punojë.

Po ju njoftoj se në Ligjin për arsimin e lartë, neni 11, pika 7, thotë: "Nëse Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nuk i jep licencë një bartësi të arsimit privat, bartësi nuk mund të punojë". Pra, në fakt, edhe një herë po e theksoj se që nga viti 2008, nuk ka asnjë prej tyre leje pune.

Sot në Kosovë shkelet edhe Ligji për arsimin e lartë. Neni 16 i këtij ligji, pika 5, thotë: "Vetëm bartësit publikë të arsimit të lartë mund të ofrojnë programe të studimit që çojnë në kualifikimin e një mësimeve për të punuar në një shkollë". Unë pyes, se a ka informata Ministria se sa mësimeve që janë të kualifikuar nëpër kolegjet private, punojnë aktualisht. Në një informatë, në një gazetë ditore, e kam lexuar se janë 35 vetëm në komunën e Pejës dhe Inspektorati në këtë komunë i ka dërguar shkresë Ministrisë dhe ka treguar se ligji po shkelet, pra edhe një herë - ligji po shkelet.

Unë do të pyes edhe për një projekt-propozim për themelimin e Gjimnazit Matematikor në Prishtinë, meqë këshilli për themelimin e këtij gjimnazi që nga viti 2010 kishte marrë shumë premtime nga ish-ministri Hoxhaj, por po bëhen gati 2 vjet që ky këshill është takuar edhe me ministrin aktual dhe ende nuk është marrë asnjë përgjigje.

Pra, ne si Aleancë, nisur nga fakti se suksesi i nxënësve dhe studentëve në fushën e matematikës në të gjitha nivelet nuk është i kënaqshëm, mungesa e kuadrit cilësor të matematikës, sugjerojmë që të mendohet seriozisht në themelimin e një shkolle elite të mesme të lartë për përgatitjen e nxënësve të talentuar në fushën e matematikës nga e gjithë Kosova.

Pastaj, një shqetësim shumë i madh imi është edhe numri shumë i vogël i inspektorëve. Në nivel Kosove janë gjithsej 54. Ky numër pra është shumë i vogël për ta kontrolluar kualitetin dhe cilësinë e arsimit të të gjithë bartësve të arsimit të lartë. Çfarë po mendon Ministria për ta rritur numrin e inspektorëve, ngase mbrëmë, në një debat televiziv, edhe ministri i Shëndetësisë tha se do t'i angazhonte këta inspektorë për ta implementuar Ligjin për duhanin. Pra, me një numër kaq të vogël të inspektorëve, edhe Ministria e Shëndetësisë do t'i huazojë disa inspektorë.

Këto ishin vetëm disa nga shqetësimet që unë i mendoj, gjithnjë duke dëshiruar që të investohet dhe të punohet në arsim në Kosovë, sepse investimi në arsim do të thotë investim në zhvillimin ekonomik të vendit.

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Unë kërkoj edhe një herë, meqë tema është shumë konkrete, se bastoret dhe këto çështjet tjera janë tema që mund t'i bisedoni ju deputetët edhe ndërmjet veti, qoftë ato edhe për lojërat e fatit, por sot e kemi temën shumë konkrete, prandaj të ndalemi në të. Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti ministër,

Kolegë deputetë,

Pajtohem që është dashur të fokusohemi më shumë në këtë temë, ashtu të paktën ashtu siç është kërkuar nga parashtuesi i interpelancës, por fatkeqësisht ju e pat që edhe deputetët, edhe nga partia e zotërisë që e ka parashtuar kanë dalë edhe në tema tjera. Ndoshta do të ishte më mirë që çështjen ta shtronim te lufta kundër përdorimit të drogës në përgjithësi dhe ta merrnim këtë fenomen ta trajtonim si deputetë nga të gjitha aspektet.

Unë po pajtohem që është më mirë nga ana e arsimit dhe mendoj që duhet të fokusohemi në këtë.

Prita që dikush nga diskutuesit do të përdorte informata më të sakta sa i përket këtij fenomeni, informata të cilat do të gjenden ose mund të gjenden nga hulumtimet të caktuara, nga institute të caktuara, dhe vetëm njëri prej tyre është marrë deri më tash konkretisht me këtë fenomen në Kosovë. Është fjala për një qendrën evropiane të hulumtimit të përdorimit të drogës, alkoolit e duhanit nëpër shkolla, e ndihmuar ose e mbështetur edhe me një fondacion kosovar, Fondacioni "Together Kosova", në mbështetje po ashtu edhe të disa institucioneve. Për herë të parë e kanë përfshirë Kosovën në këtë hulumtim dhe mendoj që shifrat që i kanë nxjerrë ata janë pasqyra më e mirë deri më tash për ta sqaruar këtë fenomen.

Më lejoni t'i përmend vetëm disa prej tyre për ta ilustrua gjendjen reale te ne. Këtu u përmendën edhe duhani, edhe alkooli, edhe drogat, edhe përdorimi i tyre nëpër shkolla.

Mesatarisht, 24% e nxënësve tanë kanë raportuar se kanë përdorur cigare gjatë 30 ditëve të kaluara, ndërsa në vendet e BE-së, ose në vendet e ndryshme që janë përfshirë në këtë hulumtim, mesatarja është 29%. Pra, nuk mund të themi që jemi të kënaqur, meqenëse

veç përdoret nga nxënësit, por jemi shumë më poshtë se sa vendet në të cilat është bërë hulumtimi, ose pas mesatares së këtyre vendeve.

Më lejoni të ju them po ashtu edhe për përdorimet tjera. Ta zëmë një në tre nxënës të moshës 15-16 vjet, në shumicën e këtyre vendeve që është bërë hulumtimi, është fjala për vendet e regjionit, shumica prej tyre edhe vende të BE-së, konsumojnë ose kanë konsumuar birrë, ndërsa në Kosovë një në dhjetë. Pra, është një gjendje krejtësisht tjetër.

Të dehur në 12 muaj të kaluar, sipas statistikave, në Kosovë, nga nxënësit e këtyre grup-moshave kanë qenë 7%, derisa 39% është mesatarja në vendet ku është kryer hulumtimi, dhe 20% është mesatarja më e ulët, te vendet si Armenia dhe Qiproja. Pra, Kosova është në një gjendje më të mirë se sa këto vende ku është bërë ky hulumtim nga një institucion prestigjioz zyrtar i BE-së. Ose të tjera shifra që tregojnë po ashtu gjendjen reale, 74% nuk kanë konsumuar asnjëherë alkool, derisa në vendet ku është kryer ky hulumtim mesatarja është 14%. Pra, është një diferencë jashtëzakonisht e madhe. 1 në 10 nxënës mund të ketë në dispozicion kanabis, ndërsa 1 në 3 është mesatarja në vendet e BE-së.

Në përgjithësi, mund të themi se e kemi një situatë, e cila është e kontrolluar ose nën kontroll, të cilën nuk e kemi ende në gjendjen alarmante. A mund të jemi të kënaqur? Jashtëzakonisht them se duhet të mos jemi të kënaqur dhe të jemi edhe më luftues ndaj kësaj dukurie.

Por, edhe një diçka tjetër që mendoj që është pritur në këtë debat më shumë.

Ne, edhe për këtë çështje e kemi një strategji, e cila është e miratuar në Qeveri, prandaj edhe nuk mund të themi se Qeveria asnjëherë në mbledhjet e saj nuk i ka debatuar këto. Dhe, e kemi një plan të veprimit, i cili i ka të specifikuara detyrat, koston financiare, periudhën kur duhen të realizohen, institucionet që duhet t'i kryejnë këto veprime.

I kemi më shumë se 20, diku rreth 22 ligje, të cilat janë të përfshira, zbatimi i të cilave ndikon drejtpërdrejt në luftimin e kësaj dukurie. Ka më shumë se 4 konventa ndërkombëtare, të cilat duhet të zbatohen dhe ka një numër të madh institucioneve, duke përfshirë shumicën e ministrive që duhen të kyçen në realizimin e këtyre detyrimeve, që dalin nga kjo strategji, e miratuar nga Qeveria.

Unë pajtohem plotësisht që duhet t'i trajtojmë këto çështje, mendoj që më shumë sesa si përfaqësues politikë, si prindër duhet të kemi shqetësime për fëmijë tanë, si përfaqësues të qytetarëve, që kemi shqetësime për të ardhmen e fëmijëve të shoqërisë sonë. Mirëpo, duhet ta trajtojmë realisht, në mënyrë që edhe masat t'i marrim realisht siç janë.

Sa u përket rekomandimeve, më lejoni të them që shumica e tyre janë në planin e veprimit të Qeverisë, janë në strategjinë e Qeverisë. Mendoj që vetëm e pasurojnë, bile ka shumëçka që nuk është thënë e ka mundur të thuhet.

Ndërsa pika e fundit që ka të bëjë me themelimin e një instituti, meqenëse jemi në interpelancë të ministrit të Arsimit, është çështje e Ministrisë së Shëndetësisë. Duhet t'i

kemi informacionet nga kjo ministri, nëse atë institut e kanë në themelim e sipër, nëse e kanë një institut të ngjashëm, ose kanë plane të tjera, ndoshta edhe më të mira, ose t'i konsultojmë edhe institucionet tjera për shkak të kostos financiare e të tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Abuzimi me substancat narkotike është njëri prej problemeve më shqetësuese për tërë shoqërinë tonë, ndërsa veçanërisht për institucionet shtetërore, të cilat duhet të kenë projekte për veprim, si në parandalimin e tyre, ashtu edhe në trajtimin e personave që kanë hyrë në këtë llojë të rrezikshme dhe e kanë vështirë të dalin.

Alarmi i përgjithshëm vjen prej faktit se me to kryesisht abuzon gjenerata e re, pra gjenerata e ardhmërisë së këtij vendi. Për më keq, vendet ku konsumohet droga dhe substancat e tjera narkotike janë edhe shkollat, e të mos flasim për kafeteritë, apo lokalet e tjera publike në vend.

Për fat të keq, këtu është fjala kryesisht për institucionet publike të arsimit fillor dhe të mesëm, si dhe për lokalet e tjera publike, ku si duket fare nuk janë të pranishëm mekanizmat përgjegjës për parandalimin e kësaj dukurie, siç është Policia.

Se gjendja është shqetësuese dhe po shkon drejt përkeqësimit tregojnë të dhënat e Policisë. Sipas tyre, sasia e drogës së konfiskuar vjet ka qenë shumë më e madhe se në vitin 2011. Konkretisht, vjet janë konfiskuar 94 kilogramë heroinë, ndërsa parvjet rreth 60 kilogramë.

Pastaj, vazhdimisht, sipas Policisë, përderisa parvjet kanë qenë 577 të dyshuar për trafikim e kontrabandë, kjo shifër vjet shkoi në 818 raste. Për këto vepra vjet janë ngrehur 227 kallëzime penale, ose 120 raste më shumë se një vit më parë. Sado që vërehet një rritje e efikasitetit, Policia e Kosovës nuk ka si të mburret, meqenëse është rritur edhe sasia e substancave narkotike që janë në qarkullim.

Për këtë flasin edhe dëshmitë apo raportet e organizatave joqeveritare që merren me trajnimin e personat në varshmëri nga droga. Vetëm te njëra prej tyre, numri i personave që kërkojnë ndihmë brenda një viti është rritur për 300 veta, apo nga 500 ka shkuar në 800, çka është edhe më shqetësuese. Në mesin e atyre që trajtohen ka edhe persona të moshës më mitur, madje edhe 13-vjeçar.

Po ashtu, raportet e shumta të mekanizmave ndërkombëtarë flasin për luftimin e këtij krimi, i cili mund të ketë pasoja katastrofale për një shoqëri. Kosova tash është bërë rrugë e rrezikshme e transitit të substancave narkotike.

Ndërkaq gjatë këtij rrugëtimi vërehet se një sasi mbetet edhe për konsum të brendshëm.

Kur kemi të bëjmë me abuzimin me substancat narkotike, apo thënë më shkurt me përdorimin e drogave në institucionet arsimore dhe në institucione tjera publike, atëherë duhet pranuar se po flasim për një të ligë të përgjithshme.

Nuk kemi të bëjmë me meritat e një partie. Është një problem, në të cilin fajin kryesor e ka Qeveria e Kosovës, duke përfshirë këtu Ministrinë e Arsimit, atë të Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Ato nuk e në një program, apo së paku të dinë se si t'i qasen këtij problemi, e veçanërisht në institucionet arsimore, ku është e përfshirë gjenerata e re, përkatësisht ajo në të cilën duhet mbështetur ardhmëria e këtij vendi.

Po ashtu, cilido program i institucioneve shtetërore duhet të përcillet me veprime konkrete.

Fillimisht, në luftimin e këtij krimi, përkatësisht të kontrabandës me substanca narkotike, të cilat lirshëm shpërndahen nëpër shkolla apo në kafiteritë tona.

Ndërkaq, problem tjetër është trajtimi i personave në varshmëri prej këtyre substancave. Ministria e Shëndetësisë duhet të ketë program special, i cili nuk duhet të bazohen vetëm në edukimin dhe informimin e gjeneratës së re, por edhe në risocializimin e atyre që kanë kaluar nëpër programe për shërim nga varshmëria.

E vërteta është se në këtë drejtim nuk po ndërmerret nuk po ndërmerret asgjë dhe gjeneratën më të re e kemi lënë në mëshirën e rrugës dhe të kontrabandistëve e të mafisë.

Ndërkaq Qeveria e ka tërë mekanizmin veprues për parandalimin e kësaj të keqeje, mirëpo krijohet përshtypja se ajo nuk ka vizion se si t'i qaset problemit apo frikësohet të hyjë në këtë betejë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Përkufizimi i drogës si dukuri negative, mendoj se nuk është përkufizim adekuat për faktin se nëse merren parasysh pasojat që vijnë nga përdorimi i drogës, atëherë nuk mund të gjejmë ndonjë term adekuat që ta definojmë konkretisht drogën, megjithatë pasojat janë shumë të rënda dhe shumë katastrofale dhe shpeshherë edhe fatale për jetën e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Është mjaft shqetësues fakti që për një kohë shumë të shkurtër përdorimi i substancave narkotike, konkretisht edhe drogës, në fjalori popullor ka gjetur vend në vendin tonë, dhe fatkeqësisht e ka atakuar edhe pjesën më të ndjeshme të popullatës sonë, kryesisht gjeneratat e reja, adoleshentët, konkretisht shkollat e mesme.

Prandaj, përgjegjësia bie mbi gjithë këtë, qoftë si deputetë, qoftë si Qeveri, qoftë si prindër, qoftë si mësimdhënës. Të gjithë e kanë barrën e përgjegjësisë për lejimin apo konkretisht indiferencën ndaj hapjes së kësaj dukurie në vendin tonë. Nuk është vetëm droga, ajo e cila ka kapluar rininë tonë. Janë shumë dukuri tjera të rënda, të cilat fatkeqësisht kanë gjetur te rinia jonë. Është edhe alkooli, i cili konsumohet. Në masë shumë të madhe në shkollat e mesme është duhani. Është e pranishme mungesa e faktorit siguri, konkretisht dhuna në shkolla, e cila ka gjetur gjithnjë vend në shkollat tona.

Pastaj, e kemi një krizë morale në institucionet shkollore. Të mos harrojmë se vetëm në tre vjetët e fundit e kemi një rritje flagrante të kurbës së aborteve të moshataret e reja, konkretisht të nxënësve të shkollave të mesme. Dhe e gjithë kjo tregon një pasqyre të saktë, konkretisht një krizë morale të vendit tonë, konkretisht të rinisë sonë.

Të mos harrojmë në këtë rast, kur po i përmendi prindërit, edhe të gjithë ne, nuk do të jemi indiferentë ndaj këtyre dukurive për faktin se janë shumë vende, apo shumë pika, apo shumë termine të caktuara që po u japin rrugë drogës dhe këtyre dukurive negative. Janë pikërisht të mbrëmjet e gjysmë-maturave dhe të maturave, kur lejohet të përdoret edhe alkooli, edhe duhani, por edhe droga në mënyrë indirekte. Ndërsa edhe prindërit, edhe mësimdhënësit qëndrojnë indiferentë në emër të asaj se është i ri dhe duhet ta shijojë jetën.

Askush nuk është që rinia të mos e shijojë jetën, por jetën në suaza të normales, për faktin se nëse kthehemi vetëm 10 vjet më herët, apo para lufte, për ne thuhetse këto dukuri kanë qenë të panjohura.

Ne si shoqëri, qoftë si Legjislativ, qoftë si Ekzekutiv, duhet të merremi më shumë me parandalimin e përdorimit të drogës, sesa të merremi me trajtimin e saj. Për faktin se parandalimi apo preventiva në kuptimin e plotë të fjalës, e ka edhe koston financiare më të ulët, por edhe kërkon angazhim më të vogël, në krahasim me trajtimin e drogës dhe të gjitha këtyre sëmundjeve tjera që e kanë përfshirë vendin tonë.

Ne të gjithë e dimë dhe u përmend këtu se fatkeqësisht në institucionet tona shkollore, qoftë fillore, qoftë të mesme, rëndësi primare e jepet komponenti arsimor, ndërsa komponentit edukativ fare nuk i jepet hapësirë. Të mos harrojmë kur jemi te komponenti edukativ, konkretisht te edukimi i mirëfilltë i nxënësve, me keqardhje e them, Kosova vazhdon të mbetet vendi i vetëm në rajon dhe vendi i vetëm në Bashkimin Evropian që nuk e ka pjesë të procesin mësimor mësimin fetar, edukimin fetar, i cili deshëm apo jo e ka rolin e vet në edukimin e mirëfilltë të brezave të rinj dhe në parandalimin e të gjitha këtyre sëmundjeve.

Prandaj, unë edhe një herë bëj thirrje që nëse synojmë që të integrohemi në strukturat e Bashkimit Evropian, duhet edhe t'i marrim shembujt më të mirë, të cilët i kanë zbatuar ata për rininë e tyre. Të mos i mbyllim sytë para atë vërtetës, të mos qëndrojmë indiferentë, e më pas të merremi me pasojat, por të merremi me preventivat. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Ganimete Musliu e ka fjalën. Nuk është. Atëherë Shaip Muja.

SHAIP MUJA: I nderuar kryetar,

I nderuar ministër,

Sot jemi duke debatuar një temë, e cila ose prek drejtpërdrejt, ose mund të jemi potencialisht të rrezikuar nga kjo dukuri e keqe, edhe si shoqëri, por edhe si prindër, dhe mendoj që shumë parafolës tërhoqën disa vërejtje, të cilat janë për t'u evidentuar dhe të cilat ia vlen që në një seancë tjetër të analizohen mbi atë se çka është ndërmarrë dhe si është situata reale në këtë çështje, edhe pse faktikisht, edhe realisht, kjo situatë nuk mund të paraqitet asnjëherë.

Unë mendoj që edukimi është njëra nga pjesët, sepse këtu po bëhet shumë marketing, duke i përmendur edhe këto substanca të dëmshme. Mirëpo, mendoj që edukimi, jo vetëm te nxënësit, por më shumë duhet të jepet te prindërit, sepse nxënësit janë produkt të prindërve. Prandaj, a mund ta ndalojnë këta të LDK-së pak tensionin, zoti kryetar, se po na pengojnë!

Dhe, unë mendoj që edukimi duhet të fillojë të mishërohet nga prindërit për shkak që të transmetojnë edhe te fëmijët.

Në popullatën e Zvicrës dhe të Japonisë, ndoshta nuk është e vërtetë, por e kam dëgjuar se edukimi fillon nga mosha kur fëmijët fillojnë t'i mësojnë dhe t'i edukojnë se jemi shtetet më të varfra, për t'i kuptuar se ne duhet të punojmë shumë për të arritur rezultate shumë. Dhe mendoj se në këtë formë i kanë edukuar që të punohet dhe të përkushtohen ndaj shtetit, ndaj rrethit dhe ndaj shoqërisë. Në këtë mënyrë mund të pengojnë edhe ndërhyrjet e dëmshme.

Po ashtu, jam dakord që mësuesit, mësimdhënësit të kenë në mënyrë periodike edukim, dhe ta kenë një mekanizëm monitorues, që të matet sesa ata e kanë identifikuar një nxënës me sjellje, të cilat mund të mos jenë të atakuara, por që të raportohet te psikologu i shkollës, ose te mjeku i shkollës dhe më pastaj në institucionet tjera, nëse ka qenë veç i atakuar në mënyrë tjetër.

Ministria mendoj që duhet t'i ngrejë kapacitetet e veta inspektuese, ose deleguese, te raportimet periodike nga menaxhmenti i shkollës për këto dukuri, të cilat duhet raportohen realisht dhe me një lidhshmëri, edhe prindër, edhe mësues, edhe shkollë, identifikimi do të jetë më i shpejtë.

Ne po e harrojmë një fakt, nuk po e dëgjojmë këtu askënd. Me çka t'i angazhojmë këta nxënës që të mos merren me drogë. Unë kam folur edhe para disa kohësh lidhur me organizimin nëpër komuna, përfshirë kryeqendrën ku jetojmë ne këtu, e të gjitha qytetet tjera të Republikës së Kosovës, segmenti shumë i rëndësishëm dhe i cili është bartës edhe në ndërtimet e shkollave që ka Ministria e Arsimit, por edhe në ndërtimin e fushave dhe shesheve të sporteve dhe të pishinave, ku duhet të angazhohen në mënyrë permanente, edhe periodikisht këto kategori të fëmijëve, kam thënë që pothuajse nëse bëhet një statistikë mbi 70% e nxënësve sot nuk dinë t'i japin biçikletës në Prishtinë, sepse nuk

kanë ku ta bëjnë këtë. Edhe në qytete tjera po ashtu. Ose janë të rrezikuar nëse dalin me biçikletë, shtypen nga komunikacioni, nuk kanë shtigje.

Dhe, nëse këta angazhohen me sporte, me një dinamikë, për të cilën ne kemi obligime edhe kur e kërkojmë votën në menaxhimin e Komunës, edhe kur e kërkojmë votën në menaxhimin e shtetit, nëse ne nuk i krijojmë këto kapacitete që ata t'i shfrytëzojnë, atëherë këta që do të jenë shitës të drogës do të jenë shfrytëzuesit më të mëdhenj të këtyre hapësirave, sepse fëmijët tanë qëndrojnë vetëm nëpër kompjuterë dhe në shkollë dhe nuk do të kenë asgjë tjetër. Në kompjuter sot bëhen në mënyrë të papërgjegjshme shkrime, bën kushdo çka do, ndërsa nuk kemi mekanizma që mund t'i ndalojë.

Prandaj, mendoj që në një bashkëpunim të ngushtë, duke marrë parasysh edhe statistikën, Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Infrastrukturës e të tjera, në bashkëpunim me kryetarët e komunave, të hapin hapësira sportive, të angazhohen në tërë sezonin. Jo vetëm në verë të punojë një pishinë dhe diku për 9 ose 10 muaj nuk është funksionale. Sot as Prishtina, e asnjë qytet nuk e ka asnjë pishinë. Është turp për Republikën e Kosovës që ne flasim për notin dhe aty kishin mundur nga sëmundjet e ndryshme të korrigjohen me këto angazhime, duke filluar nga shtylla kurriore e të tjera, deri në veprime tjera.

Prandaj, kjo forma tjetër, ne duhet të ngremë kapacitete, t'ua ngushtojmë hapësirën atyre keqbërësve që mendojnë t'i peshkojnë dhe t'i keqpërdorin në kanalet, të cilat i kemi në përgjegjësi dhe nuk jemi në nivel të detyrës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Lirije Kajtazi. Janë edhe tre deputetë nga Partia Demokratike, që e kanë kërkuar fjalën për diskutim.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

E përshëndes këtë nismë, e cila ka për fokus një kategori të ndjeshme të nxënësve dhe sigurisht ata që e kanë kërkuar interpelancën kanë pasur parasysh atë takimin e nxënësve nga kjo problematikë dhe sigurisht se të gjithë së bashku do t'i marrim obligimet për ta tejkaluar këtë problem.

Unë do të fokusohem në zinxhirin e luftimit të kësaj problematike dhe ky zinxhir nuk funksionon fare shihet se ministri Buja sot është vetë dhe strategjia gjithsesi, por mirë që erdh tash ministri i Mjedisit. Strategjia ka të bëjë me përfshirjen e shumë ministrive, pa të cilat ministri i Arsimit, me gjithë angazhimet e mëdha, e tha edhe në paraqitjen e vetë që kjo çështje e shqetëson edhe atë, pa angazhimin e të gjitha segmenteve, ai është i pafuqishëm në luftimin e kësaj dukurie, me gjithë marrjen e masave të shumta.

Dhe, marrja e masave ka të bëjë me të gjitha ministrinë të cilat ne i kemi zbuluar mirë në strategjinë tonë, tu fillua nga ajo e shëndetësisë, në investime në shëndetin publik, në Ministrinë e Mjedisit në obligimin për ndërtimin e mekanizmave në shkatërrimin e materialit të gjetur, apo është edhe ministri këtu nëse e provokon fjala ime apo refutje në funksion të drogës së gjetur i dinë cilat janë rezultatet më shumë a shkatërrimi apo futja në funksion.

Ministria e Drejtësisë, trajtimi i rasteve, si gjatë procesit hetimor, procedurës gjyqësore, ekzekutimit të sanksioneve.

Ministria e Ekonomisë me rolin jashtëzakonisht të madh në kontrollin doganor, meqë e dimë se aty qarkullon shumëçka. Konfiskimi i pasurisë së paligjshme.

Ministria e Punëve të Brendshme, në rend të parë në ofrimin e bashkëpunimit, që ata edhe duhet t'ia ofrojnë shkollës, Doganës, gjykatave dhe përgjithësisht asaj që quhet funksionim i shtetit ligjor.

Fatkeqësisht, kemi raste ekstreme të raportuara zyrtarisht, kur Policia edhe merr mitë për t'i liruar trafikantët apo të mos e përmendi edhe atë që u tha më parë, rasti i vjedhjes së drogës në Polici.

Ministria e Arsimit i mbetet që ta kërkojë këtë bashkëpunim apo funksionimin e këtij zinxhiri të të gjithë mekanizmave për ta luftuar këtë çështje mjaft të ndjeshme, duke i shtuar kontrollet e lokaleve rreth shkollave, mbikëqyrjen e hapësirave të zbrazëta rreth shkollave dhe brenda shkollës, kontrollimi i orëve apo menaxhimi i orëve të humbura, siç e kemi rastin të atyre të edukatës fizike, që e kemi përmendur më herët, në mungesë të sallave të fizikulturës, ku fëmijëve pa dashje u krijohen orë të lira dhe ata do t'i kalojnë në një farë mënyre apo do të bien pre trafikantëve, apo çështjeve tjera devijuese.

Disiplina në shkollë, përfshirë edhe përdorimin, në shumë komuna drejtoritë e arsimit duhet t'i bëjnë rregulloret për disiplinën brenda shkollës, përfshirë këtu edhe telefonat mobilë, të e mos flas për çështje tjera më ekstreme edhe çështje tjera të palejueshme armë të ftohta, apo gjëra tjera, që besoj se ndikojnë në këtë situatë.

Mungesa e transportit të organizuar për fëmijët dhe qëndrimi i gjatë rreth shkollës, meqë e dimë se shumë komuna as që kanë trafik urban dhe fëmijët obligohen të qëndrojnë aty dhe u janë të ekspozuar rreziqeve.

Dhe, shumë çështje tjera, të cilat veç u përmendën nuk do t'i përsëris, me pjesën edukative që besoj u elaborua edhe nga ju ministër.

Unë pres që të ketë rezultate në këtë drejtim, por vërtet jeni i pafuqishëm nëse kolegët tuaj nuk ju ndihmojnë dhe e lënë këtë kaos të vazhdojë kështu siç është.

KRYETARI: Deputetja Salihe Mustafa e ka fjalën. Nuk është. Deputeti Behar Selimi e ka fjalën.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti ministër,

Të nderuar deputetë,

Së pari dëshiroj ta vlerësoj nismën e zotit Ramadani për ta diskutuar çështjen e përdorimit të drogave nëpër shkolla. Dhe, posaçërisht e vlerësoj faktin se është njëra nga temat, e cila mendoj se ka qëllim shumë të mirë dhe del përtej interesave të ngushta të një subjekti

politik apo pretendimeve për të fituar elektorat. Pra, e konsideroj një temë të rëndësishme për të ardhmen e vendit, sidomos.

Kam dëgjuar se ka pasur mendime ndryshe se nuk është me prioritet, e të tjera. Sigurisht që nuk është prioritet i prioriteteve, por prioritet gjithsesi dhe prioritet madje i përhershëm, sepse është fjala për një dukuri që po e vret të ardhmen tonë.

Tani, çështja e përdorimit të drogave natyrisht nuk është çështje me të cilën merret vetëm Ministria e Arsimit dhe arsimit. Bile mendoj se Ministria e Arsimit, edhe në bazë të strategjisë, por edhe në bazë të një fakti tjetër, e ka një hise të përgjegjësisë dhe ajo hise, nëse e shndërrojmë në numra, nxënësit kryesisht në shkollë janë nja 5-6 orë. Çka t'u bëhet atyre pastaj, 18 orë tjera janë në komunitet, janë nëpër lokale, prandaj përtej kësaj kanë obligime edhe shumë institucione tjera.

Sidoqoftë, mendoj se nëse e marrim strategjinë për luftimin e drogave dhe e krahasojmë përmbushjen e detyrave, del se Ministria e Arsimit, në strategjinë e vitit 2009-2012, i ka realizuar detyrimet që i ka pasur në bazë të asaj strategjie dhe del se bashkë me Policinë janë institucionet, të cilat e kanë bërë punën e tyre më së miri karshi institucioneve të drejtësisë, institucioneve tjera të karakterit social, të institucioneve shëndetësore, e kështu me radhë. Unë po flas gjithnjë në bazë të objektivave që i ka pasur strategjia.

Natyrisht, kjo nuk na bën që të kënaqemi. Ka gjithmonë mundësi edhe më shumë e më mirë, dhe mendoj se ka vend që në strategjinë aktuale të vitit 2013-2017 të futen së paku tri programe që i njeh bota, e cila merret me luftimin e kësaj dukurie, sepse, siç u tha këtu edhe më herët, nuk është dukuri alarmante, shqetësuese po se po, por nuk është alarmante. E tha edhe zoti Pajaziti me gjuhën e statistikave, që i bie gjuhë faktografike, por është gjithsesi çështje shqetësuese me të cilën duhet të merremi.

Fakti se po diskutohet me ministrin e Arsimit, unë mendoj është vetë qasja e nismëtarit të interpelancës që kjo çështje të trajtohet më tepër në aspektin social si dukuri sociale, e jo dukuri e sigurisë dhe se me masa parandaluese mund të arrijmë më shumë sesa me masa të luftimit, apo me gjuhën profesionale të kësaj dukurie që luftohet në botë, ne sot po e trajtojmë si ta zvogëlojmë nevojën dhe kërkesën për përdorim të drogës, jo si ta zvogëlojmë ofertën. Zvogëlimin e ofertës e ka aparati represiv, përkatësisht e kanë organet e drejtësisë dhe Polica dhe këtu ata të Policisë sidomos kanë qenë të shkëlqyeshëm. Ka rezultate të jashtëzakonshme, sidomos Departamenti i Luftimit të Drogave, por kjo duhet të jetë çështje në njërin nga debatet e ardhshme që mund ta bëjmë me ministrat e radhës, të cilët po ashtu i drejtojnë sektorët që kanë përgjegjësi, kanë hise në zbatimin e strategjisë.

Të jem konkret, unë propozoj që në rekomandime të futen propozimet e Kuvendit që në kuadër të planeve të karakterit edukativ të futen tri lloj programesh, programi i edukimit universal, që i bie të gjithë të trajnohemi, duke na përfshirë edhe ne, programi i edukimit special, që u adresohet grupacioneve, të cilat më së shumti atakohen nga mundësi për ta përdorur drogën, duke përfshirë edhe prindërit e tyre, dhe programet tjera indikative, që

flet për grupacionin e atyre që e kanë përdorur drogën bashkë me prindërit e tyre dhe këto janë të karakterit edukativ.

Ne e dimë, sidomos njerëzit e sistemit të arsimit, që në sistemin tonë të arsimit aktualisht dominon elementi më shumë i arsimimit sesa i edukimit. Ndoshta këtu në aspektin strategjik në të ardhmen duhet të shtojmë më shumë elemente të karakterit edukativ të sistemit arsimor, në mënyrë që të na ndihmojë në këtë aspekt.

Sa u përket rekomandimeve, mendoj se kryesisht janë të pranueshme .U tha edhe më herët se janë pjesë e strategjisë, por, megjithatë, i kanë specifikat e veta.

Rekomandimi i fundit më shqetëson pak, sepse kërkon krijimin e një instituti të ri, që domethënë është kërkesë buxhetore, por mbase nuk është përgjegjësi imja për t'u marrë me çështje të buxhetit, por sidoqoftë, me përjashtim të rekomandimit të fundit, rekomandimet tjera personalisht do t'i votoj. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ramiz Ldrovci, pastaj Ganimete Musliu. Ju njoftoj se gjithsej janë 6 minuta për Partinë Demokratike.

RAMIZ LADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Iniciativa e deputetit Burim Ramadani është e qëlluar, dhe unë fjalën time për t'ia kursyer minutat ministrit të Arsimit, po e dorëzoj me shkrim në Sekretari. Faleminderit!

Diskutim i dorëzuar me shkrim

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

E përkrah iniciativën e kolegut Ramadani që sot ne si Kuvend të diskutojmë mbi çështjet në arsim, veçanërisht për problemin e përdorimit të drogave në institucione, me shpresën që nga këto diskutime të nxjerrim rekomandime që mund të implementohen dhe orientojnë te një zgjidhje e problemeve.

Secili nga ne gjithë këto vite të pasluftës e ka pasur mundësinë ta përcjellë zhvillimin dhe sfidat në sektorin e arsimit, pasi, fatbardhësisht, para se të jemi deputetë e zyrtarë, jemi edhe prindër dhe qytetarë të këtij vendi, që mendojmë ta çojmë përpara secili me punën e vet, në pozitë ku mbajmë përgjegjësi.

Kosova - shtet i dijes, është një thënie e dëgjuar dhe e shkruar nga kjo ministri në shumë programe e procese, e cila na duket patetike në dëgjim, por nëse i shohim realisht këto përpjekje, kuptojmë që arsimi i standardeve evropiane nuk arrihet pa kaluar nëpër këto sfida, sikur kalojmë në të gjithë sektorët tjerë të zhvillimit.

Arsimi i standardeve evropiane do t'i paraprijë Kosovës evropiane. Sot, vendi ynë nuk e ka prioritet me infrastrukturën shkollore, dhe të gjithë i gëzohemi këtij fakti, pasi na krijohet hapësira të diskutojmë, pse jo edhe të sfidojmë për të arriturat në drejtimet tjera.

Vizioni për ta pasur një arsim të fuqishëm në vendin tonë, ambiciet për kualitetin e mirëfilltë që akoma nuk e kemi ndërtuar, nuk na japin edhe mundësinë për ta anashkaluar pastaj edhe punën e mirë dhe sukseset që janë evidente.

Unë si deputete e këtij Parlamenti, si anëtare e Komisionit Parlamentar për Arsim, i kam ndjekur dhe i ndjek nga afër deri në hollësi të gjitha zhvillimet në fushën e arsimit. Prandaj, do të mundohem që tërë atë që e diskutoj ta mbështes në të dhënat të besueshme dhe të bazuara në fakte.

Nuk dua ta elaboroj gjendjen e arsimit para vitit 2007, para ardhjes në pushtet të PDK-së, pasi është e njohur për të gjithë ne, shtatorët e grevave të mësimdhënësve, të cilat bëheshin çdo fillim viti shkollor, pa fajin e mësimdhënësve.

Nuk dua as t'i kujtoj skenat e trishtuara të nxënësve në objektet e mërdhira, as problemet financiare të qytetarëve tanë në blerjen e librave për fëmijët e tyre, dhe këto janë vetëm disa nga aspektet që krahas sfidimit për punë më të madhe, nuk ishin realizuar më herët.

Të nderuar deputetë,

Për ta pasur një arsim të mirë, që do të jetë konkurrent në tregun evropian, jemi të vetëdijshëm që do të na duhet kohë si shtet, por ne edhe me arsim e mësuam që s'mund ta lexojmë as abetaren nëse nuk i mësojmë gërmat nga a në zh.

Dhe për ta lexuar abetaren kushtimisht, u desh ta mësojmë alfabetin e suksesit, por nëse nuk do të ndërtonte ky vend një pako të fortë legislative, tani më s'do të kishte vend të diskutojmë për projekte e sfida tjera në arsim.

Dua të ndalem te pakoja e legjislacionit, e cila viteve të fundit, sponsoruar nga Ministria e Arsimit, filluar nga ish-ministri Hoxhaj, e vazhduar dhe kompletuar nga ministri Buja, u bë pothuajse complete - infrastrukturë ligjore e harmonizuar me ligjet e evropiane.

Plani strategjik i arsimit në Kosovë, i cili është dokumenti kryesor strategjik për zhvillimin e arsimit në të gjitha nivelet, është në hapa solidë për t'i përcjellë arritjet, pasi në këtë mandat qeverisë, kjo ministri sponsorizoi:

- Zhvillimin e legjislacionit për Arsimin Parauniversitar dhe Arsimin e Lartë;
- Hartimi i KKK (Kornizës së Kurrikulës së Kosovës), si një dokument bazë, nga i cili kanë dalë kurrikulat bërthamë, si dhe ka filluar pilotimi i këtyre kurrikulave në shkollat e përzgjedhura pilote;
- Gjithëpërfshirja e grupeve të marginalizuara në sistemin arsimor, siç janë rritje e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në të gjitha nivelet e arsimit;
- Ka vazhduar trendi i investimeve në infrastrukturën shkollore, e cila ka ndikuar në uljen e numrit të ndërrimeve në shkolla, që është një nga parakushtet për ngritjen e cilësisë në mësim;
- Ngritja e kapaciteteve njerëzore në menaxhimin e shkollave, i cili përfshin trajnimet për udhëheqje arsimore, e që është shumë e rëndësishme për procesin e decentralizimit të shkollave;

- Në kuadër të zhvillimit profesional të mësimeve, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e ka financuar programin për shkathtësitë në kompjuterë - Licenca evropiane e përdorimit të kompjuterit (ECDL) - për 12 743 mësimeve. Ky është një program shumë i avancuar dhe i certifikuar ndërkombëtarisht;
- Me ndihmën e partnerëve zhvillimorë (SIDA; GIZ, USAID, Swiss Contact etj. janë trajnuar mbi 11 000 mësimeve dhe drejtorë të shkollave;
- Universiteti i Prishtinës, në bashkëpunim me MASHT-in, e ka organizuar programin e AKM-së për ngritjen e kualifikimeve të mësimeve prej shkollave të larta pedagogjike dyvjeçare në nivelin bachelor 4-vjeçar.
- Ky është një objektiv tjetër i ministrisë, i cili ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të mësimeve. Po ashtu, ky program është edhe një formë e shpërblimit të punës së shkëlqyeshme për këtë kategori të mësimeve, që mbajtën mësim në kushtet më të vështira të viteve të '90-ta.

Te çështja e krijimit të mekanizmave për përdoruesit e drogave, nuk mund të them që është e anashkaluar, por a mjafton ky aktivitet? Absolutisht nuk mjafton.

Por, nismat e Qeverisë dhe bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të vendore ka vend për t'i fuqizuar përpjekjet, që edhe kjo luftë e vështirë të hyjë në agjendë të shpejtë dhe serioze të ministrisë.

Të nderuar deputetë,

Të gjitha këto fakte tregojnë se sektori i arsimit në vend nuk është në rrugën e dështimit, ai është në rrugën e mirë të rritjes dhe zhvillimit.

Reformat që kanë nisur duhet të jenë në dinamikë më të shpejtë dhe monitorim të vazhdueshëm. Prandaj, është normale të ballafaqohemi me sfida dhe vështirësi, por rezultatet janë të dukshme dhe shumë shpresëdhënëse për tërë arsimin në Republikën e Kosovës.

Xhevahire Izmaqi, d.v.

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: I nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Tema, e cila është objekt i diskutimit të kësaj interpelance, është e rëndësishme nacionale dhe do kushtuar kujdes i veçantë nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe qytetarët, në përgjithësi.

Në një raport të publikuar të Departamentit Amerikan të Shtetit, me titull "Raporti për strategjinë ndërkombëtare për kontrollin e narkotikëve" jep vlerësime për angazhimin e institucioneve të Kosovës në luftën kundër drogave.

Në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit thuhet se Kosova i koordinon përpjekjet për ta luftuar kontrabandimin e narkotikëve bazuar në strategjinë kombëtare kundër

drogave dhe me planin e veprimin, ku ndërmjet tjerash Kosova vlerësohet si vend transit i narkotikëve të destinuar për Evropë, por jo edhe si prodhues thelbësor i substancave narkotike.

Sa i përket angazhimit të Policisë së Kosovës në luftën kundër narkomanisë, unë i kam konsultuar disa të dhëna statistikore për vitin 2012, kur gjatë vitit të shkuar është ngritur konfiskimi i këtyre lëndëve, si dhe numri i rasteve të arrestimit të personave të dyshuar për trafikim të narkotikëve.

Ndërmjet tjerash janë konfiskuar rreth 94 kilogramë heroinë, mbi 7 kilogramë kokainë, mbi 1 235 kilogramë marihuanë, mbi 10 000 bimë të kanabisit, mbi 12 050 fara të bimës kanabis, 153 ekstazi dhe mbi 880 gramë substanca tjera narkotike.

Po ashtu, gjatë vitit 2012 janë hapur gjithsej 527 raste që kanë të bëjnë me substanca narkotike dhe të cilat kanë rezultuar me sukses në konfiskimin e tyre.

Të dyshuar janë 818 persona, 576 prej të cilëve janë arrestuar, ndërkaq 394 persona janë në ndalim. Këta indikatorë e tregojnë qartë angazhimin e theksuar të Policisë së Kosovës në luftimin e narkomanisë. Por, ky progres është arritur edhe në bashkëpunim konkret ndërsektorial ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës.

Sa i përket përhapjes së narkotikëve nëpër shkollat fillore dhe të mesme të vendit tonë është një fenomen sensitiv, që është duke i përshkuar nxënësit e trajtuar në shumë forume dhe aktivitete tjera institucionale, përfshirë koordinimin e institucioneve me organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe lokale, të profilizuara në luftimin e narkomanisë të rinjtë, me ç'rast në mënyrë sistematike janë organizua aktivitete të shumta që dalin nga projektet e ndryshme, duke u bërë sensibilizimi profesional rreth efekteve negative që sjellin drogat për rininë shkollore, madje në fushata sensibilizuese janë angazhuar edhe profesionistë shëndetësorë, si dhe zyrtarë policorë.

Unë si deputete e Kuvendit të Kosovës, bëj apel që të gjithë mekanizmat, qoftë ata institucionalë, shoqërorë, civilë dhe aktorë tjerë të angazhohen edhe më shumë në parandalimin e përdorimit të narkotikëve nga nxënësit e Kosovës dhe që bashkëpunimi ndërsektorial të fuqizohet edhe më shumë, duke filluar nga këshillat shkollore, drejtoritë përkatëse komunale të arsimit e të shëndetësisë, bashkë me institucionet e organizatat tjera të nivelit qendror, me qëllim që çdo herë e më shumë të zbutet përhapja e kësaj dukurie të rinia jonë, edhe pse jemi në dijeni se shumë organizata studentore, këshilla të nxënësve dhe këshilla të veprimtari janë duke bërë fushata të shumta në sensibilizimin e opinionit me këtë problematikë, që dita-ditës po shënon rritje në vendin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Ju njoftoj, deputetët që thirren dhe nuk janë të pranishëm për pikën e caktuar të rendit të ditës, nuk mund më ta marrin fjalën. Fjalën e ka deputeti Burim Ramadani, si propozues.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë gjatë këtij debati, ose kësaj interpelance, në të cilën edhe një herë po e them dhe qysh në fillim e kam thënë tepër të qartë se objektivi i saj është që në mënyrë efektive dhe dinamike ta ngremë vëmendjen dhe të punojmë në katër fusha bazë.

1. Përballimi i problemit,
2. Zbatimi i ligjit,
3. Parandalimi dhe trajtimi i zvogëlimi i dëmit dhe
4. Edukimi.

Pra, që katër fushat janë fusha bazë parandaluese, e jo represive, sepse kjo ka qenë edhe ideja pse e kemi ftuar ministrin e Arsimit në interpelancë për ta parë fushën, ose mundësitë e parandalimit të kësaj dukurie të dëmshme, ose dukurie negative.

Duke i marrë parasysh shumicën e rekomandimeve, ose të vërejtjeve që janë dhënë për rekomandime, më lejoni që në fund të ju lus që të votoni për këto pika të mocionit, ndërsa pikat e parapara më herët, ose të paraqitura më herët, e kanë vetëm një dallim në pikën pesë.

1. Të organizohet trajnimi i mësimdhënësve në tërë Kosovën për fushën e drogave për secilin vit shkollor;
2. Të investohet në hulumtime mbi të cilat do të ndërtoheshin veprime, strategji dhe politika efektive.
3. Të bashkëpunohet ngushtë me shoqërinë civile dhe organizatat e profesionalizuara në këtë fushë.
4. Të ndërmerret një fushatë sensibilizuese me nxënësit për rreziqet e drogës dhe pasojat që lë ajo në mentalitetin dhe edukimin e brezave, dhe
5. Të ndërtohet Instituti Kombëtar për Trajtimin e Sëmundjeve të Varshmërisë gjatë vitit 2014. Pra, jo në këtë vit, por të parashihet që të ndërtohet në vitin e ardhshëm, respektivisht të përfshihet në buxhetin e vitit të ardhshëm.

Edhe një herë ju lus që të votoni dhe t'u bëjmë mesazh të përbashkët gjithë nxënësve të Kosovës që të mos udhëhiqen prej një momenti gëzimi, ose një momenti qejfi në dozat e para të substancave narkotike, sepse ato janë vërtet fatale për pjesën tjetër të jetës. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë, ngase ndërruam renditjen. Urdhëro, ministri Ramë Buja e ka fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar kryetar!

I nderuar koleg ministër,

Të nderuar deputetë,

Unë shkurt shumë shkurt do të flas, sepse veç dua të ju falënderoj shumë, duke u nisur nga i nderuari deputet Ramadani, që e ka ngrehur këtë çështje për ta diskutuar dhe u

diskutua bukur shterueshëm, edhe pse shumë herë përsëritshëm, megjithatë është për t'u respektuar. Besoj është shqetësim i përbashkët që nuk i përket, siç u tha këtu, edhe u konstatua, veç Ministrisë së Arsimit, por shumë ministrive të Qeverisë, dhe debati ndoshta kishte pasur logjikë më përmbajtjesore atëherë kur të ishte zhvilluar Qeveri-Parlament, si dukuri dhe fenomen që na shqetëson. U tha mirë këtu për këtë çështje dhe po ju them që ato që u thanë në shumicën e rasteve janë për pyetje parlamentare dhe unë i pres ato pyetje parlamentare për të dhënë përgjigje.

Të them, krejt në fund, shumë faleminderit për këtë që u diskutua sot.

KRYETARI: Faleminderit edhe për ty, zoti ministër! A i keni harmonizuar qëndrimet? Po, mirë shumë. Të pranishëm janë 63 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 57 vota për, asnjë kundër dhe një abstenim, Kuvendi e miratoi mocionin e propozuar nga deputeti Burim Ramadani dhe grupi i deputetëve nënshkrues.

Të pranishëm ishim 63 deputetë, në votim morën pjesë 58 deputetë. Prandaj, deputetët është mirë të kenë mirëkuptim për shkak të një rekomandimi, nëse nuk i themi vendim të Gjykatës Kushtetuese, që janë tri mundësi: “për”, “kundër” dhe abstenim.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë edhe një herë. Votojmë tash!

Prania fizike 64, prania elektronike 91 deputetë. 62 deputetë për, do të thotë 2 kanë përtuar përsëri të votojnë. Kuvendi i miratoi rekomandimet me 62 vota.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2012

Raportin vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2012 e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2012 dhe ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Asnjëri nga kryetarët e komisionit që e kanë shqyrtuar nuk është i pranishëm. Shkojmë në emër të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën. Si zakonisht, kur mungon dikush, Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Kur mungon dikush, nuk e ka fjalën Shaip Muja, por unë jam anëtar i komisionit, zoti kryetar. Keni harruar që e kemi ndryshuar.

Edhe raportin e kemi analizuar në Komision, ka qenë i aprovuar dhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike në parim e pranon dhe e voton këtë raport, meqë kemi debatuar gjerë e gjatë me të gjithë anëtarët dhe unanimisht është votuar si një raport i detajuar. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të LDK-së, deputetja Teuta Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka lexuar dhe e ka analizuar këtë raport të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe deputetët që janë në komision e kanë analizuar dhe do të flas në emër të tyre.

Ky raport i Autoritetit të Aviacionit Civil si zakonisht është raport, i cili çdo vit vjen teknikisht i rregulluar, i përgatitur mirë dhe në këtë aspekt mendoj që duhet të pranohet që ky raport teknikisht vjen shumë më mirë i përgatitur se shumë raporte tjera të agjencive dhe rregullatorëve, të cilët vijnë në Kuvendin e Kosovës.

Përveç raportit, ne kemi pasur edhe një raportim të përfaqësuesve të këtij autoriteti në komision dhe kemi pasur mjaft përgjigje në pyetjet e shumë deputetëve.

Dëshiroj të koncentrohem në ndryshimet e raportit të vitit 2012, në lidhje me raportin e vitit 2011. Aty shihet që ka përparime në krahasim me raportin e vitit 2011, se njëra është përgatitja për certifikimin me ISO-standardin ndërkombëtar 9001/2008 në 'Burea Veritas', dhe mendoj që ky është një përparim, është një progres.

Gjithashtu, ajo e cila mund të shihet si progres, ndonëse jo i plotë, është zëvendësimi i kodit RS, me një kod të përkohshëm X-XK, apo XK dhe shpresojmë që ky zëvendësim i përkohshëm do të jetë afatshkurtër dhe që Kosova do ta ketë kodin e vet të përhershëm. Është ndryshim gjithashtu pozitiv, pasi çdo vit, në çdo raportim bëjmë pyetje për hapësirën e lartë ajrore, e cila nuk kontrollohet nga Kosova, por e cila në fakt deri më tani ka qenë hapësirë e papërdorur, pasi prej vitit '99 NATO-ja e kontrollon hapësirën e lartë ajrore dhe kjo hapësirë ka qenë e papërdorur deri më tani dhe do të vazhdojë të jetë e papërdorur deri në kuartalin e tretë të këtij viti.

Por, ajo që është pozitive është që NATO-ja e ka përzgjedhur 'Hungaro'-kontrollin, i cili do ta mbikëqyrë hapësirën e lartë ajrore dhe për herë të parë pas luftës kjo hapësirë ajrore do të lëshohet në qarkullim, gjë që Kosovës do t'i sjellë edhe përfitime financiare.

Gjithashtu, ajo e cila përsëritet në çdo raport, sa herë ta kemi në komision, apo sa herë ta marrim, është mospërdorimi i Aeroportit të Gjakovës nga institucionet tona.

Fatkeqësisht, në çdo vit janë pyetjet e njëjta dhe janë përgjigjet e njëjta, si nga ministri i Infrastrukturës, i cili vjen në raportim, po ashtu edhe nga Autoriteti i Aviacionit Civil, të

cilët për çdo vit thonë që sivjet ky aeroport do të bartet nga kontrolli dhe administrimi i Qeverisë italiane në administrimin e institucioneve lokale, por përsëri deri më tash shohim që këto janë vetëm përsëritje e fjalëve të njëjta.

Është e kotë të themi që shpresojmë që së paku sivjet këto fjalë të dalin të vërteta dhe të mos i kemi edhe në raportin e vitit 2013 të Aviacionit Civil të njëjtat premtime dhe të njëjtat fjalë.

Tash do të koncentrohem pak në vërejtjet, përveç progresit, apo përveç një raportimi në këtë dokument, do të përsëris që sipas Ligjit për aviacionin civil, mandati i kryesuesit të bordit dhe i një anëtarit është dyvjeçar dhe ky bord në fakt është i paplotësuar prej korrikut të vitit 2011. Prandaj, edhe kjo, sikur Aeroporti i Gjakovës, vazhdon të përsëritet vit pas viti si diçka e pakryer dhe e paplotësuar.

Pika tjetër në të cilën kemi pasur pyetje dhe përgjigje gjithashtu prej përfaqësuesve, ishte çështja e tarifës së sigurisë së pasagjerëve. Kjo tarifë e cila arrin në dy euro ka arritur të mbledhë 1 489 450 euro në buxhetin e këtij autoriteti.

Por, ajo e cila është e çuditshme është që për sigurinë e udhëtarëve përdoren vetëm 740 000 euro, ndërsa pjesa tjetër e kësaj tarife, e cila është e dedikuar për ta rritur sigurinë e pasagjerëve, shkon në Buxhetin e Kosovës dhe shtrohet pyetje: A duhet të zvogëlohet kjo tarifë e sigurisë në një euro, pasi vetëm 50% po përdoren apo qysh do të vazhdohet, po në këtë mënyrë çfarë është, mendoj që nuk është në rregull, nën një që të cenohet siguria e pasagjerëve me marrjen e parave për siguri dhe mospërdorimin për siguri, dhe në anën tjetër mendoj që ky autoritet nuk e ka për detyrë, që të mbushë Buxhetin e Kosovës prej parave, të cilat merren prej sigurimit të udhëtarëve.

Një lajm tjetër, lajm i keq për Kosovën me pasoja me imazh për Kosovën është largimi i British Airway-s dhe sipas përgjigjes së udhëheqësit të këtij autoriteti ishte mungesa e arsyeshmërisë ekonomike, ndonëse shihet se as ai vet nuk e beson fort këtë fjalë të vetën. Duke pasur parasysh që British Airways operon në aeroportet e shteteve përreth, në aeroporte të cilët kanë edhe një numër më të vogël të udhëtarëve, jep një sinjal që kjo duhet të hetohet. Duhet të hetohen arsyet e vërteta, se pse firmat me renome largohen nga Kosova.

Është rasti edhe me shitjen e Postë-Telekomit, në të cilën janë larguar firma, të cilat vërtet merren me këto dhe kanë ardhur do fonde, do njerëz, të cilët as ministri nuk po i di se kush janë.

Në anën tjetër, dëshiroj të përfundoj këtë, që disa avio-kompani të cilat operojnë në Aeroportin e Kosovës nuk përdorin gjuhët zyrtare të Kosovës gjatë leximit të udhëtarëve dhe kjo duhet të jetë gjithashtu një prej detyrave të Autoritetit të Aviacionit Civil, që të plotësojë këtë mungesë të funksionimit të operimit të avio-kompanive.

Sidoqoftë, mendojmë ne në Grupin Parlamentar të LDK-së, që ky është një raport, i cili mirë e pasqyron gjendjen në aviacionin civil dhe ne do ta përkrahim. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Grupit të “Vetëvendosjes”, deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne do ta përkrahim këtë raport dhe, natyrisht që siç u tha edhe më herët, po që se krahasohet ky raport me raportet e disa agjencive tjera është shumë më i avancuar, natyrisht edhe më mirë i përgatitur, por megjithatë i ka disa mangësi si raport, në atë që nuk jep informata të detajuara dhe të mjaftueshme për disa çështje, që ne të paktën i konsiderojmë të rëndësishme.

Që në fillim të raportit, që në përmbledhjen ekzekutive pra thuhet në faqen shtatë, që gjatë vitit 2012 është rritur numri i udhëtarëve nga prej dhe në Aeroportin e Prishtinës, në 1 527 134 udhëtarë krahasuar me 1 422 302, sa i shihet në vitin 2011, pra një rritje prej 7,37%, që e dhënia në koncesion e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës ka qenë gabim edhe logjik edhe ekonomik, meqenëse, tregu është duke u rritur ndërkohë që natyrisht këto të hyra jo domosdoshmërisht po reflektohen në Buxhetin e Kosovës, me sa kemi vërejtur ne.

Një çështje tjetër, që është ngritur edhe nga Instituti INDEP është, që kur flitet për pagat e personelit të AAC-së, nuk jepen informatat e kërkuara me ligj për këto paga të personelit, pra vetëm thuhet baza ligjore dhe se si Ministria e miraton listën e pagave të personelit të AAC-së dhe nuk jepen detajet, për atë se cili do të jetë niveli dhe koeficienti i këtyre pagave të këtij aviacioni. Dhe po ashtu, nuk është shpjeguar si duhet në raport edhe çështja e dhënies apo delegimit të përgjegjësisë së shërbimeve për kontrollin e aviacionit të ofruesit i shërbimeve të aviacionit. Kjo kur kihet parasysh që është shërbimet për kontrollimin e aviacionit civil janë e drejtë ose përgjegjësi ekskluzive kushtetuese e Agjencisë së Aviacionit Civil dhe nuk shpjegohet qartë baza juridike e delegimit të një pjese të kësaj përgjegjësie te kjo kompani tjetër, po ashtu publike.

Dhe për fund, dua ta ngre edhe këtë çështjen e informatave të munguara, kisha me thënë unë, pra te faqja 36 ku flitet për rregullimin ekonomik të tre operatorëve, pra mbikëqyrja ekonomike e aeroportit, mbikëqyrja ekonomike e OSHNA-së dhe mbikëqyrja ekonomike e shërbyesve në tokë. Këtu vetëm na tregojnë agjencia se e ka bërë mbikëqyrjen, i ka bërë auditimet, por nuk jep informata më të hollësishme për qëndrueshmërinë financiare dhe ekonomike të këtyre ndërmarrjeve, disa të koncesionuara dhe disa publike, gjë që mendoj se do të kishte qenë pjesë e raportit, për ta pasur parasysh deputetët dhe publiku në përgjithësi afarimin dhe qëndrueshmërinë ekonomike të këtyre ndërmarrjeve të rëndësishme për zhvillimet në Kosovë.

Megjithatë, ne do ta miratojmë këtë raport, për shkak se mendojmë që në pjesët tjera është mjaft i kompletuar dhe mirë informues. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, kryetari i Grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës do ta mbështesë raportin vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin e kaluar. Mendoj se disa aspekte, të cilat edhe neve

na bëjnë përshtypje ose na brengosin, u përmendën nga parafolësit. Mendoj se mbetet temë Aeroporti i Gjakovës, mbetet temë edhe British Airways dhe ne shpresojmë se nuk do të bëhen temë edhe aviokompanitë tjera me renome botërore, të cilat tash e shumë kohë fluturojnë prej dhe në Prishtinë.

Mendojmë se ka indikacione, të cilat tregojnë se edhe kompanitë tjera ajrore me renome, po them, po e rishikojnë të gjithë punën e tyre dhe operimin në Aeroportin e Prishtinës dhe mendoj se dikush duhet të fillojë të mendojë për këtë punë - pse ndodh kështu?

Një çështje tjetër që nuk u përmend këtu dhe që duhet ta përmend, është tepër me rëndësi për ne dhe për qytetarët e Kosovës.

Në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës ka mbishkrime, të cilat nuk janë shqip, zoti kryetar, ose ka mbishkrime në të cilat në shqip shkruhet si gjuhë e dytë, ose e tretë. Unë e di që askush prej deputetëve dhe prej ministrave ose kryeministri i Qeverisë së Kosovës, ka kohë që nuk kanë kaluar nëpër terminal të rregullt, përpos nëpër terminalin VIP, ose nëpër daljen VIP dhe mund të mos e dinë që në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës ka mbishkrime jo në shqip, ose ku shqipja është gjuhë e dytë, mirëpo mendoj se dikujt kjo ka qenë dashur t'i bie në sy.

Mendoj se duhet t'ia përkujtojmë edhe Autoritetit dhe kompanisë që menaxhon, se gjuha shqipe është gjuhë zyrtare në Kosovë, përpos serbo-kroatishtes dhe se Aeroporti i Prishtinës, pavarësisht dhënies me koncesion është territor sovran i Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Koalicioni për Kosovë të re ka shqyrtuar raportin e Aviacionit Civil, i cili është shqyrtuar edhe në Komision Parlamentar, mirëpo në rast se e shohim raportin nga raporti i vitit 2010, ky është raporti i vitit 2012, atëherë mund të themi se definitivisht ky raport ka mangësi. Mund të themi se është i mirë, por prapë ne efekt, në rast se bëjmë analizimin nga raporti i vitit të kaluar, atëherë nuk është raport i cili mund të shquhet si raportet e mëparshme, kur i sillte Aviacioni Civil në Kuvendin e Kosovës.

Në rast se analizojmë të hyrat financiare të kësaj agjencie, e cila të hyrat i merr nga taksat e udhëtarëve, u përmend nga parafolësit, se tarifat e sigurisë janë nga 2 euro, ndërsa në rast se udhëtarët tanë në Aeroportin e Prishtinës vonohen për shkak të aviokompanive, të cilat nuk i marrin me kohë, atëherë cili është dënimi që e bën kjo agjenci e aviacionit civil për këto kompani? Kush i mbulon shpenzimet e udhëtarëve, të cilët ndoshta presin me orë të tëra në Aeroportin e Prishtinës.

Nën 2, u tha se hapësira ajrore, prapëseprapë kontrollohet nga NATO-ja. Është e vërtetë, ajo u përshkrua edhe në deklarinë të kryesuesit të këtij bordi, mirëpo prapëseprapë mund të themi se ai tha kemi një përparësi, për arsye se në biletat elektronike tash definon një

kod tjetër dhe jo kodi i Serbisë. Mund të themi, se nuk kemi edhe shumë përparësi, edhe pse Raporti i Progresit e nxjerrë mirë këtë agjenci të aviacionit civil, mirëpo në efekt nuk është mirë, se është duke funksionuar vetëm me tre anëtarë të bordit, dhe e tërë çështja e tyre, e cila duhet të zbatohet në bazë të Ligjit të aviacionit civil po shihet se kemi akoma mangësi, ku shërbimet e trafikut ajror dhe aerodromeve për aeroplanë në afërsi të Aeroportit të Prishtinës, prapëseprapë janë nën kontrollin e NATO-s dhe domethënë, se akoma nuk e kemi hapësirën të liruar. Kjo është më shumë çështje politike.

Thuhet në raport, se kemi bërë marrëveshje ajrore midis Kosovës dhe EBA-së, domethënë Autoritetit të Shteteve të Bashkuara Arabe, mirëpo ata duhet të na tregojnë çka mund të përmirësojnë nga raporti i vitit të kaluar në këtë raport dhe jo të na i tregojnë cilat kanë qenë marrëveshjet apo takimet e tyre me Komision Parlamentar, çështjet e marrëveshjeve tjera me komisionet tjera. Në efekt unë mund të them, se ky raport në krahasim me raportin e vitit të kaluar është më i mangët dhe u pa në deklarinimin e vetë kryesuesit të këtij bordi në Komisionin Parlamentar, ku u shtruan pyetjet, si tha zoti Gjini, për çështjen e Aeroportit të Prishtinës apo Aeroportit “Adem Jashari” dhe ai të gjitha këto kompetenca i atakoi te njësia për partneritet publiko-privat brenda Ministrisë së Financave.

Pse ai është i ngarkuar atëherë, në bazë të Ligjit të aviacionit civil, për licencën e Aeroportit “Adem Jashari”, kur ai nuk është në gjendje të na tregojë për çështjen e koncensionimit të këtij aeroporti.

Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah, se kjo punë ka përfunduar, ky është raport i vitit 2012, mirëpo në të ardhmen kërkojmë po nga kjo Agjenci për Aviacion Civil të kryejë punën e vet në bazë të ligjit dhe të ju raportojë deputetëve atë që duhet të raportojë dhe jo të shkruajë për takimet apo vizitat kah i ka pasur, sepse esenca është të na tregojë çka dhe si po funksionon Ligji për aviacionin civil. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse, parafolësit e mi si zonja Sahatqija, zoti Ymeri i thanë shumë vërejtje që i kam për t’i paraqitur edhe unë, por duke e respektuar kohën e deputetëve, unë do ta dorëzoj me shkrim. Faleminderit!

Diskutimi i dorëzuar me shkrim

I nderuari kryetari i Parlamentit,

I nderuari kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh rëndësinë që ka Autoriteti i Aviacionit Civil për mbarrëvajtjen e punëve dhe zhvillimin e trafikut ajror në vend, atëherë është normale që edhe raportet e tij të jenë të rëndësishme së veçantë. Së paku unë kam pasur këto pritje.

Mirëpo, raporti i punës së AAC për vitin 2012 është larg nga këto pritje. Ajo kryesisht është i përshkruar me informata sipërfaqësore, në shumë vende ai ikë prej problemeve, apo ato trajtohen si të parëndësishme dhe mbesin pa përgjigje adekuate.

Kapituj, si ai i marrëveshjes së shërbimeve ajrore në mes Kosovës dhe Emirateve të Bashkuara Arabe; pastaj marrëveshja për hapësirën e përbashkët evropiane të aviacionit; auditimi nga strukturat e Këshillit të Evropës; çështjet e aviacionit që ndërlidhen me integritet evropiane dhe për bashkëpunimin me institucionet e brendshme përmbajnë informata të thjeshta. Me asnjë fjalë nuk tregohet rëndësia e tyre, apo cilat janë efektet konkrete, që i sjellin këtij autoriteti, apo vendit në tërësi.

Vërejtja tjetër e natyrës së përgjithshme ka të bëjë me treguesit për zhvillimet brenda këtij autoriteti. Hiq ata që kanë të bëjnë me numrin e udhëtarëve dhe të fluturimeve, të cilat më shumë janë përgjegjësi e Aeroportit “Adem Jashari”, asnjë tregues tjetër nuk vihet në krahasim me periudhat e mëhershme, apo së paku me vitin 2011. Në mungesë të këtij krahasimi ne nuk kemi një pasqyrë të qartë se kah po shkojnë trendet e këtij autoriteti, a janë ato në ngritje, apo në rënie, a janë keq, apo janë mirë?

Po ashtu më duhet të veçoj dy raste që përbëjnë lajmin e mirë që del nga ky raport. Së pari është ai për hapjen e hapësirës së lartë ajrore të Republikës së Kosovës për mbikalime, Mirëpo, edhe këtu mungon një përshkrim i efekteve konkrete që do të sjellë kjo hapje. Nuk mendoj këtu vetëm në krijimin e të hyrave financiare, por edhe kur është fjala për besueshmërinë e këtij autoriteti, apo edhe të vendit në përgjithësi, sado që edhe më tutje këto shërbime përkohësisht i delegohen Hungarisë.

Dhe, lajmi i dytë, është rritja e numrit të udhëtarëve dhe të fluturimeve në aeroportin ndërkombëtar “Adem Jashari”. Sado që këto efekte më shumë ndërlidhen me shërbime që ofron aeroporti, megjithatë tregojnë mjaftë për zhvillimin e trafikut ajror, posaçërisht kur kemi parasysh se për nga numri i udhëtarëve Prishtina ka tejkaluar Lubjanën, Shkupin dhe Podgoricën

Këtu është një paqartësi. Thuhet se numri i udhëtarëve është rritur 7,4%, ndërkaj AAC raporton se të hyrat nga tarifa e pasagjerëve janë rritur 15,7%. Prej nga del ky ndryshim i rritjeve? Apo, mos bëhet fjalë për ngritjen e taksës, e cila ka reflektuar edhe në rritjen e të hyrave.

Më tej, po përmendi disa vërejtje konkrete, ashtu si janë të renditura në këtë raport.

Sipas raportit nuk vërehet se dikush është i shqetësuar pse AAC-ja që nga korriku i vitit 2011 punon me Bord Mbikëqyrës të përgjysmuar. Madje, krijohet përshtypja se janë të kënaqur pse ai bord ende paska tri veta dhe këta mjaftojnë që puna dhe vendimet e tij të jenë të ligjshme. Sado që me këtë është plotësuar një minimum ligjor, megjithatë duhet pranuar se ky bord është i pakompletuar dhe kjo ka ndodhur për fajin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe të Qeverisë së Kosovës, të cilat ky autoritet me kohë i ka lajmëruar;

Më 14 dhjetor 2012, drejtori i përgjithshëm i AAC-së i ka dërguar ministrit të Infrastrukturës dhe ministrit të Punëve të Jashtme një përmbledhje për “mundësitë e Republikës së Kosovës për anëtarësim në ICAO”. Nëse kjo përmbledhje është e karakterit intern, apo ka edhe informata të natyrës konfidenciale, së paku në raport është dashur të ofrohet një informatë më e plotë, se deri ku kanë arritur punët për anëtarësim në këtë agjenci të OKB-së. Apo të sqarohet se, “kanë filluar hulumtimet dhe kontaktet në nivel teknik për të përgatitur terrenin për dorëzim të aplikimit zyrtar”;

Ligji kërkon që personeli i aviacionit duhet t’iu nënshtrohet kontrolleve të rregullta mjekësore për të siguruar se janë në gjendje të mirë shëndetësore që t’i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të sigurt. Në raport thuhet se janë dhënë certifikata mjekësore për tre kontrollorë të trafikut ajror dhe për dy pilotë, por nuk sqarohet nëse këto janë të mjaftueshme për t’ë përmbushur këtë detyrim ligjor;

Mungojnë sqarimet e duhura se pse deri më tani nuk është lidhur marrëveshja marrëveshje teknike me Agjencinë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit;

Te inspektimet thuhet se janë konstatuar gjithsej tri gjetje:

Dy gjetje kanë të bëjnë me shenjat e sigurisë dhe një me papastërtinë e jashtme të aeroplanit. A janë të natyrshme këto gjetje dhe a rrezikojnë sigurinë, posaçërisht kur është fjala për sinjalistikën, apo ato janë të zakonshëm? As për këtë nuk ka sqarime;

Në raport thuhet se gjatë vitit 2012 është raportuar një numër i konsiderueshëm i rasteve të drejtimit të rrezeve laserike drejt mjeteve ajrore. Është mirë që AAC-ja ka publikuar një qarkore këshilluese të sigurisë, mirëpo në raport nuk sqarohet se çfarë kuptimi, apo mesazhi kanë këto rreze, prej nga vijnë dhe a mund të jenë të rrezikshme për sigurinë e fluturimit;

Vërejtja ime e fundit ka të bëjë me buxhetin e këtij Autoriteti.

Së pari, është një paqartësi rreth shumës së mjeteve që ka pasur gjatë vitit ky autoritet. Fillimisht, dihet se ky autoritet vetëfinancohet përmes taksave, tarifave të ndryshme dhe donacioneve. Ndërkaq, në raport thuhet se vjet të hyrat nga tarifa e pasagjerëve kanë qenë afër 1,5 milionë euro, ndërkaq buxheti i përgjithshëm ka qenë 789 mijë euro. Ku kanë mbetur pjesa tjetër e parave të arkëtuara? A janë derdhur ato në buxhetin e shtetit? Nuk ka përgjigje. Njëkohësisht thuhet se për sivjet AAC-ja ka kërkuar një buxhet prej mbi 1,2 milionë eurove, ndërsa i është lejuar më pak se që ka pasur vjet. Kjo mos përmbushje e kërkesave për financim, a do të ndikojë edhe në vëllimin e cilësinë e punëve që janë paraparë të kryhen në vitin 2013? Faleminderit!

Hashim Deshishku, d.v.

KRYETARI: Faleminderit! Prania fizike 49 deputetë dhe nuk mund të votojmë, por vërtet komisionet në arsyeshmëri janë shumë stereotipe. Mendoj se duhet të jenë më mirë të arsyetuara. Jo, dy komisione është Komisioni Funksional dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe të dy e kanë pothuajse të njëjtin konstatim. Mendoj që arsyetimet duhet të jenë pak më të plota. Vazhdojmë!

Vazhdojmë me pikën e 9-të:

9. Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2012

Raportin e punës së Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2012 e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Legjislacion dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2012 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Legjislacion, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Komisioni e ka shqyrtuar raportin. Raporti është një raport i formës standard, duke marrë parasysh edhe faktin se kjo Agjenci është në përfundim të mandatit të vet ligjor dhe pritet shumë shpejt shuarja e saj ose transformimi në një agjenci tjetër, sepse kjo ka pasur një mandat verifikimin realisht të pronës, të pronës bujqësore dhe pronave tjera dhe pritet që kjo agjenci, ndoshta me ligjin që është në procedurë kuvendare që një kohë të gjatë, Ligjin për verifikimin dhe kontrollin e pronës të shndërrohet në Agjenci për Verifikim dhe Kontroll të Pronës, por akoma nuk është vendosur.

Gjithsesi, raporti i plotëson kushtet formalo-juridike dhe çështje që janë prezantuar aty janë të pranueshme dhe i rekomandohet seancës, që ta aprovojë. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e ka kërkuar fjalën? E ka fjalën deputeti Behar Selimi.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Me gjithë rrezikun që të konsiderohem me fjalor stereotip, e kemi shqyrtuar raportin dhe i rekomandojmë Kuvendit që ta miratojë.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ndan mendimin pozitiv, sa i përket raportit të punës së kësaj Agjencie dhe më lejoni të theksoj, edhe përkundër vështirësive edhe të natyrës së punës e cila ka të bëjë me zgjidhjen e kërkesave, përpunimin e tyre por edhe vendimmarrjen e tyre, është një ndër agjencitë më kredibile në Republikën e Kosovës. Kjo për faktin, e thashë për shkak të specifikave me të cilat i kryen këto detyra, është pothuajse institucioni më pak i përfolur, apo thuajse i papërfolur për korrupsion dhe kjo tregon, që aty punojnë njerëz të ndershëm, punojnë njerëz kredibil dhe këto detyra i kanë kryer me nderë dhe përkushtim.

Dhe, për këtë arsye dhe në bazë të vlerësimit të raportit të punës së brendshme, ne i japim përkrahje këtij raportit të punës për vitin 2012. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, deputetja Albulenë Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Kur flasim për pavarësinë e Kosovës, shtet-ndërtimin, ndërtimin e institucioneve, lirinë e qytetarëve e kemi të domosdoshme të themi që njëri ndër elementet kryesore të pavarësismit të një vendi është edhe procesi i dekolonizimit, pra e drejta që një populli t’i rikthehet prona si kusht elementar për zhvillimin ekonomik të tij.

Pra, po nuk iu kthye prona e marrë nga pushtuesit, po nuk iu krijuan kushtet, që ai ta ketë mundësinë e zhvillimit ekonomik, ai përfundon prapë i varur. Pra, pa pronën varësia i bëhet e pashmangshme.

Agjencia Kosovare e Pronës e bën të kundërtën e në bashkëveprim me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, këto të dyja bashkë e bëjnë saktësisht të kundërtën, pra shpronësimin e plotë të Kosovës duke injoruar plotësisht faktin, që Kosova ka qenë nën pushtim.

Pronat në Agjencinë Kosovare të Pronës nuk shikohen pra përmes prizmit të një trajtimi të thellë e të drejtë, ndërsa kur bëhet fjalë për çështjen e pronave për shqiptarët në veriun e Kosovës, ato trajtohen vetëm sipërfaqësisht me arsyetimin e gjendjes së rëndë atje. Është një numër tejet i vogël i trajtimit të pronave atje në raport me problemet, në raport me uzurpimet, edhe përkundër kërkesave të shqiptarëve.

Duhet sërish ta përmendim faktin, që janë 11 564 shqiptarë të dëbuar nga veriu i Mitrovicës në shkurt të vitit 2000, pronat dhe banesat e të cilëve i shfrytëzojnë sot serbët atje. Veriu i Mitrovicës para vitit 2000 dhe edhe në vitet e mëhershme ishte e banuar me shumicë shqiptare, pa pjesën jugore. Pra, edhe pjesa e ndarë pa jugun në vetvete ishte e banuar me shumicë shqiptare. Këtu do të duhej të punohej e jo të zvarritej ky proces, pasi që paralelisht me këtë zvarritje shqiptarët e varfër të dëbuar nga shtëpitë e tyre, janë të detyruar t’i shesin pronat e tyre, të cilat i blen Qeveria e Serbisë përmes fondeve të saj.

Çështja e pronave të shqiptarëve të dëbuar nga veriu zvarritet dhe çështja e pronave të serbëve është prioritet, pra, pa u shikuar asnjëherë origjina e atyre pronave, se a janë prona kolonësh apo jo.

Me Agjencinë Kosovare të Pronës dhe me këtë politikë të padrejtë nuk ka ndërtim të shtetit të Kosovës, nuk ka zhvillim dhe do të ketë përherë varësi. Çështja e pronave duhet rishikuar, duke pasur parasysh parimet e dekolonizimit, origjinën e pronave, pasi që ajo do të duhej të ishte e shenjtë për të gjithë.

Pra, për këto arsye ne si grup parlamentar nuk do ta votojmë këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AAK-së, kryetari i Grupit, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj se duhet thënë, se raportimi në komision i përfaqësuesit të Agjencisë Kosovare të Pronës ka qenë korrekt, po ashtu edhe raporti i cili është sjell. Mendojmë se puna e kësaj agjencie nuk është e lidhur me pjesën e zgjidhjes politike të problemeve, të cilat e i kemi me Serbinë dhe ne do ta votojmë për miratim këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Siç u tha, padyshim që komisioni ka qenë gjatë tërë këtyre vjetëve në mandatin e vet mjaft kredibil dhe profesional dhe përkundër vështirësive të shumta në terren, është munduar të zgjidhë çështjet e të gjithë atyre që kanë qenë të dëbuar pa dëshirën e tyre prej vendeve të banimit të tyre.

Edhe pse nga shumë pyetje që janë bërë nga ne anëtarët e Komisionit, në drejtim të përfaqësuesit të Agjencisë Kosovare të Verifikimit të Pronës, sa i përket dilemës se pse nuk janë kthyer njëtrajtshëm banorët në vendbanimet e tyre, që ka të bëjë me veriun e Mitrovicës, arsyetimi ka qenë mjaft korrekt, parimor dhe i drejtë nga përfaqësuesi i Agjencisë për faktin se përkundër vullnetit të tyre, të punës së tyre dhe strategjisë profesionale, kanë qenë pengesat teknike dhe politike që të gjithë i dimë, që ndodhen në atë pjesë. Prandaj, sa i përket punës së tyre, ata mendoj se kanë qenë profesionalë, janë munduar të bëjnë një punë të drejtë edhe pse për arsyet që i përmenda kanë pasur vështirësi dhe pengesa. Kështu që, mendoj që ky raport duhet të votohet dhe të kalojë.

Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.

KRYESUESI: E ka fjalën Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Ne, në Komision të Legjislacionit, aty e kemi trajtuar raportin e kësaj agjencie dhe natyrisht, se ka qenë jashtëzakonisht i plotë me mjaft informata, por edhe në Komision e kam nënvizuar një fakt, i cili nuk më ka kënaqur dhe i cili nuk përputhej me të dhënat e mia, të cilat unë dëshiroja shumë t'i vërtetoja edhe përmes kësaj agjencie.

Kryesisht, kisha një vërejtje atje dhe tani po e apostrofoj edhe këtu, për pronat e shqiptarëve të larguar në ato pjesë të cilat sot nuk i kontrollojnë as shteti i Kosovës dhe shqiptarët janë të shpërngulur njëherë për njëherë. Unë për veten time, kam të dhëna prej 12 000 deri në 15 000 banorë, të cilët janë shpërngulur nga andej dhe që nuk korrespondojnë me të dhënat e sakta të Agjencisë përkatës dhe kisha një problem, të cilin unë doja ta vërtetoja meqenëse aty këtë kureshtje dhe këtë përpjekje nuk kisha mundësi ta realizoj përmes këtij vlerësimi, tash që i bëjmë këtij raporti, dua edhe njëherë ta ngre këtë shqetësim dhe inkurajoj Agjencinë Kosovare të Pronës që të mbledhë saktësisht pronat e shqiptarëve andej Urës së Ibrit, saktësisht banesat dhe patundshmëritë tjera, të saktësohen dhe të plotësohen me të dhënat, sepse ne në këtë raport nuk i kemi gjetur në tërësi.

Unë për veten time mendoj që së shpejti Agjencia Kosovare e Pronës do të dalë me të dhëna të sakta dhe ne do të shërbejemi pastaj në shembujt, në analizat edhe në debatet në trajtimin e këtij fenomeni, të jemi të saktë dhe të kemi edhe bazë faktike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Krasniqi! Nuk ka të tjerë që do të flasin për këtë raport.

Kolegë të nderuar,

Ne duhet të vazhdojmë të diskutojmë raporte të tjera, në ndërkohë besoj, që do të mbledhen deputetët, sepse kemi votime, kemi bile edhe votime të fshehta më vonë.

Kalojmë në pikën e 10-të të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka mbikëqyrur zbatimin e ligjit nr. 03/L-214 për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe Kuvendit i ka paraqitur raport me rekomandime.

Liburn Aliu është raportues i Komisionit Funkcional për arsyetimin e raportit me rekomandime. Deputeti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim hapësinor duke u bazuar në planin e punës dhe në bazë të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 3.10.2011 ka vendosur të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 03/L-214 për vlerësimin e ndikimit në mjedis si një ndër ligjet bazë në fushën e mjedisit e që rregullon çështjen e lejeve dhe pëlqimeve mjedisore, për veprimtarinë ekonomike në raport me nivelin e ndikimit të tyre në mjedis.

Me qëllim të realizimit të këtij vendimi Komisioni ka themeluar grupin punues prej 5 anëtarësh, i cili ka hartuar planin e veprimit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe ka realizuar një varg takimesh me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komisionin e Pavarur të Minierave dhe Mineraleve, Agjencisë së Pyjeve, ka vizituar po ashtu komunat dhe operatorë të shumtë.

Nga vizitat në terren i ka realizuar me qëllim të njoftimit të drejtpërdrejtë me nivelin e zbatimit të ligjit, si dhe ka organizuar disa tryeza publike. Pas shqyrtimit të analizës së tërë procesit dhe në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët relevantë, Komisioni përgatiti këtë raport me rekomandime, të cilin në mbledhjen e mbajtur më 22.4.2013 vendos t'ia paraqesë Kuvendit.

Një ndër arsytet e shtyrjes së afateve deri më tani, duhet ta cekim që kanë qenë vendimi i Ministrisë për ndalimin e eksploatimit të zhavorreve nëpër lumenj dhe pranë lumenjve, ka qenë një ndër arsytet që ka bërë që raportimi i hershëm i Komisionit do të ishte i

mangët, nëse nuk do të monitorohej pikërisht ky vendim, i cili lidhet drejtpërdrejtë me zbatimin e këtij ligji.

Do të doja të përmend se me qëllim të realizimit të këtij monitorimi Komisioni ka qenë tejet aktiv në vizita të shumta në terren, ka pasur po ashtu shumë raportime nga ana e ministrit, kanë qenë dy raportime nga ana e ministrit në Komision. Po ashtu, kanë qenë disa tryeza të organizuara, ajo në Prizren më 12.11.2011, tryeza në Drenas, ka qenë tryeza për Bjeshkët e Nemuna në Pejë dhe ka pas tryezë tjetër në Prishtinë, në dhjetor të vitit 2012.

Po ashtu, në komision kanë raportuar edhe kryetari i Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, zoti Ahmet Tmava, kemi pasur po ashtu së fundi edhe zonjën ministre Kusari-Lila, në lidhje me master-planin e Brezovicës.

Do të doja të theksoj, se pas këtij monitorimi njëri ndër sukseset e arritura është vetë krijimi i këtij ligji, pra miratimi i këtij ligji, i cili është ligj në harmoni të plotë me raportet e progresit dhe me ligjet e Komisionit Evropian dhe se edhe nga vetë Raporti i Progresit vlerësohet se është plotësisht në përputhje me standardet e BE-së.

Po ashtu, Ministria ka arritur t'i bëjë dhe t'i miratojë edhe udhëzuesit administrativ edhe pse ndoshta me vonesë. Pra, janë 4 udhëzues administrativ të miratuar deri më tani.

Për sa u përket problemeve të identifikuara në zbatimin e ligjit, pra kjo është pjesa kryesore e këtij raporti, pra, përderisa ligji në vetvete është ligj i mirë dhe nuk kemi ndonjë vërejtje konkrete për ligjin, problem përbën çështja e zbatimit të tij. Përderisa Ligji për vlerësim të ndikimit në mjedis e rregullon marrjen e masave në mbrojtje të mjedisit në fazën e projektimit e që përbën një akt dhe që përfundon me një pëlqim ministror, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e që e tëra mbulohet nga procedurat administrative, frytet e këtyre procedurave lidhen pastaj me fazat tjera të mëvonshme e që lidhen me Ligjin e mjedisit e të cilat përbëjnë një proces të tërë të punës në terren.

Edhe po të kufizoheshim vetëm në monitorim të këtij ligji, pra duke injoruar në njëfarë mënyre ligjet tjera, ne do të mund ta quanim të kryer monitorimin e këtij ligji, mirëpo duhet ta kemi të qartë lidhshmëria e këtij ligji me Ligjin e mjedisit e bën efektiv edhe vetë këtë ligj.

Duhet të mos harrojmë që në sistemin aktual, gjërat që kanë të bëjnë me aktin, respektivisht kur kemi të bëjmë me dhënien e një pëlqimi mjedisor, që është një akt të cilin e trajton Ministria, këtu kemi më shumë zbatueshmëri se sa kur kemi të bëjmë me procese, ku do të duhet të ketë monitorime të vazhdueshme dhe kjo pastaj lidhet edhe me kapacitetet e reduktuara të Ministrisë dhe buxhetin e ultë.

Ajo çka është më dekurajuese në lidhje me zbatimin e vlerësimit të ndikimit në mjedis është fakti që një ndër shkelësit më të mëdhenj në zbatimin e ligjit vijnë nga vetë ana e institucioneve. Pra, nëse do të mund të ishim kritikë kundrejt kapaciteteve të Ministrisë

për dhënien e lejeve, e cila edhe me ato kapacitete që bën përpiqet dhe arrin të bëjë relativisht mjaft vizita në terren përmes inspektoratit dhe po ashtu, t'i mbulojë edhe pse i ka kapacitetet mjaft të reduktuara, dhënien e pëlqimeve mjedisore, problemi është se është aplikimi tejet i vogël për leje mjedisore, për pëlqim mjedisor kundrejt projekteve të shumta, që realizohen apo që fillojnë të realizohen në Kosovë.

Dështimi i rezultateve konkrete në terren është dekurajues edhe për vetë sistemin. Kjo gjë ndikon në uljen e kriterëve edhe për dhënie të pëlqimeve, si pasojë e ndikimeve nga jashtë. Rrol negativ po ashtu, luan fakti që për pëlqim mjedisor kryesisht aplikojnë operatorët privatë, ndërsa autoritetet shtetërore, qendrore apo lokale në projektet e tyre injorojnë këtë procedurë.

Gatishmëria për lëshimin e pëlqimit mjedisor në shumë raste lejon që të mendohet, që kanë ekzistuar ndikime të tjera, kur është bërë lëshimi i pëlqimit mjedisor, sidomos këtu duhet të merret parasysh fakti që në shumë raste fillojnë punimet dhe pëlqimet mjedisore lëshohen tek pasi që të fillojnë ato. Ta zëmë, e kemi rastin në Lipjan te rezervuari i ujësjiellësit në fshatin Gadime, ku pëlqimi mjedisor është bërë pasi që pothuajse gati është realizuar puna. Ndërsa, në anën tjetër duhet ta kemi të qartë që ky ligj përcakton rregullat në fushën e projektit. Pra, është ligj tejet i rëndësishëm, pasi që do të mund t'i parandalonte veprimet negative, që në fazë të projektimit. E në shumë raste tek ne kemi të bëjmë me realizim dhe punë ndërsa, në ndërkohë që pëlqimet mjedisore ose nuk janë lëshuar ose tek atëherë aplikohet për këto pëlqime mjedisore.

Po ashtu, duhet ta përmend krijimin e grupit ndërministror për master-planin për Brezovicën, i cili grup ndërministror mund të themi që e ka injoruar plotësisht vlerësimin e ndikimit në mjedis, pasi që tanimë ka arritur në fazën e diskutimit me investitorë të ndryshëm për çështjen e këtij projekti dhe sidomos më skandaloze e bën fakti, që në kuadër të këtij projekti mendohet që të bëhen investime në zonën e Parkut Nacional, respektivisht në zonën e parë të tij, që është zonë strikte, ku me ligj ndalohen çfarëdo veprimesh, çfarëdo aktiviteteve në kuadër të këtyre zonave.

Po ashtu, problem që duhet përmendur është çështja e mungesës së profesionistëve të licencuar. Pra, në mungesë të profesionistëve të licencuar edhe raportet profesionale për VNM janë të mangëta. Natyrisht, është çështje e shumë... në mënyrë zinxhirore vijmë deri te këto probleme edhe nga fakti, që buxheti për Ministrinë e Mjedisit është tejet i limituar.

Është një raport tejet i gjatë, por unë po përpiqem ta kaloj sa më shpejt, që të mos ju marr kohën.

Duhet të përmend, që tek projektet, ta zëmë projektet nga komunat që kanë të bëjnë me infrastrukturën, qoftë nga komuna, qoftë nga Ministria, janë projekte të cilat tërësisht e kanë injoruar procedurën e vlerësimit të ndikimit në mjedis, përjashtim në këtë aspekt bëjnë vetëm akset rrugore Vërmicë-Merdar dhe Prishtinë-Shkup.

Ndërsa, projektet e zgjerimit të rrugëve të ndërmarra nga autoritetet komunale janë realizuar plotësisht pa asnjë pëlqim mjedisor. Këto projekte kanë rezultuar edhe me dëme në mjedisin përreth.

Një i ngjashëm, kemi të bëjmë pra edhe me projektet e ndërmarra nga ministritë tjera, për objektet ndërtimore, pra, çështja e pëlqimeve mjedisore injorohet plotësisht.

Veprimi i operatorëve ilegalë që eksploatojnë në mënyrë të paligjshme zhavorrin nëpër lumenj, nuk ka mundur të ndalet as pas vendimit të Ministrisë për çfarëdo veprimtarie minerare nëpër lumenj. Operatorë ilegal të cilët kanë vepruar edhe në periudhën kur ka pasur ndalesë edhe vetë Komisioni ka hasur drejtë në ta dhe në shumë raste edhe ka informuar edhe Ministrinë.

Fakti që operatorët ilegalë veprojnë...

(Ndërprerje nga regjia)

(Ndërhyrje nga salla)

KRYESUESI: Urdhëro! Menjëherë, tash ose e merr më vonë, si të duash ti. Vazhdo në emër të grupit. Urdhëro!

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Mungesa, pra pamundësia për t'i ndaluar operatorët ilegalë, në fakt është një dëm tejet i madh pasi që e inkurajon mos aplikimin për leje, meqenëse ka shumë operatorë legalë të cilët përballen me shumë procedura të cilat i respektojnë, ata tash në konkurrencë do të jenë përherë humbës kundrejt operatorëve ilegalë, të cilët edhe përkundër faktit që është zvogëluar numri i tyre, nuk ka arritur plotësisht të ndërpritet puna e tyre.

Problem tjetër është moskoordinimi i autoriteteve komunale me ato qendrore dhe mos koordinimi ta themi, me komisionet tjera, ku shpeshherë komuna lëshon leje pune, edhe pse bazohet duke u arsyetuar vetëm me një pëlqim mjedisor, që e lëshon Ministria. Në këto raste komunat do të duhej që t'i nënshtroheshin planeve të tyre zhvillimore, pavarësisht që Ministria mund të lëshojë pëlqim mjedisor për ndonjë projekt të caktuar.

Po ashtu, mungon edhe koordinimi në mes afateve për dhënien e lejeve të ndryshme, pra një autoritet jep afat, jep leje për periudha më të gjata, ndërsa një autoritet tjetër jep leje me periudha më të shkurta, kjo në fakt, e komplikon tejet shumë punën e operatorëve në terren, sidomos atyre operatorëve që përpiqen t'i respektojnë procedurat.

Mungesa e bashkëpunimit të institucioneve komunale dhe atyre qendrore me policinë dhe gjykatat kanë ndikuar në inkurajim të operatorëve ilegalë. Në shumë raste inspektorët janë kërcënuar drejtpërdrejtë nga operatorët ilegalë dhe kështu është penguar edhe zbatimi i detyrave të tyre.

Nga takimet dhe vizitat e zhvilluara haset një pajtim për gjendjen e rëndë në mjedis, si dhe për nevojat për ndryshim në politikat mjedisore. Këto ndryshime shihen si të domosdoshme dhe pritet të fillojnë gjatë këtij viti. Ndryshimet, në fakt nuk përbëjnë gjë tjetër, përpos zbatimit të ligjeve ekzistuese.

Fillimi i procesit të licencimit të ekspertëve të mjedisit, fillimi i lëshimit të lejeve mjedisore, po ashtu edhe lejeve mjedisore të integruara do të mund të shfaqin ca elemente pozitive edhe pse çdo gjë varet nga politikat e shtetit në raport me mjedisin.

Në bazë të këtij monitorimi të realizuar deri më tani ishin institucionet shtetërore të parat që injoruan procedurat e përcaktuara me ligj në fushën e mjedisit. Suksesi në zbatim të tij, varet pikërisht nga këto politika.

Pra, si konkluzion mund të konsiderojmë që ky ligj është ligj tejte i mirë dhe nuk ka nevojë të mendohet për ndonjë ndryshim të këtij ligji, sfida kryesore për këtë ligj mbetet zbatimi i tij në praktikë, gjë që tani për tani nuk realizohet në nivel të duhur.

Dhe, rekomandimet që i ka miratuar komisioni janë këto në vijim e që lidhen së pari me Qeverinë dhe komunat, pra, Qeveria dhe komuna të zbatojë legjislacionin në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis me gjithë mekanizmin përcjellës implementues, aktet nënligjore, në të gjitha projektet që kanë ndikim në mjedis.

Spektori i vlerësimit të ndikimit në mjedis pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të rritë kapacitetet e resurseve humane në aspektin kuantitativ dhe kualitativ. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor duhet të rrisë transparencën për procedurat e dhënies së pëlqimeve mjedisore dhe lejet që janë dhënë, të jenë në dispozicion të publikut.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të licencojë personat fizikë dhe juridikë, që hartojnë raportet e VNM-së dhe të njëjtët të bëhen publikë për operatorët ekonomikë.

Të shtohet bashkëpunimi, si në rrafshin horizontal në mes të dikastereve qeveritarë dhe agjencive ekzekutive të pavarura, ashtu edhe në rrafshin vertikal me komunat, në fushën e zbatimit të ligjit.

Të shtohet aktiviteti i Inspektoratit Mjedisor në mbikëqyrjen e implementimit të këtij ligji.

Komunat gjatë dhënies së lejeve ndërtimore dhe të punës, të respektojnë pëlqimet mjedisore dhe planet e saj zhvillimore dhe urbane.

Të zbatohen dispozitat ligjore për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje si dhe të organizohen fushata vetëdijesimi.

Të ndërpriten menjëherë të gjitha aktivitetet në zonat e mbrojtura, që nuk janë pajisur me pëlqim mjedisor dhe leje të tjera përcjellëse.

Për sa i përket fjalës sime në emër të grupit parlamentar, ne natyrisht se e mbështesim këtë raport. Vërejtja ime në emër të grupit, lidhet kryesisht me këto... me projektin e, po e theksoj më tepër, projektin e Brezovicës dhe së pari, vërejtja ime i adresohet Komisionit Evropian, i cili në fakt është hartuesi i parë i këtij projekti ideor e që si projekt ideor, që është paraparë të ndërtohet në Zonën e parë strikte të Parkut Nacional, bie në kundërshtim me vetë ligjet e Bashkimit Evropian. Prandaj, unë kërkoj së pari nga Komisioni Evropian, që të tërhiqet nga një projekt i tillë ideor e po ashtu, i bëj thirrje Ministrisë dhe autoriteteve tjera qeveritare e që në këtë rast është Komisioni Ndërministror, që pjesën e projektit master-planit për Brezovicën që përfshin Zonën e parë strikte, të mos realizojë veprimet, ndërsa të orientohet në pjesët tjera të projektit, që kanë të bëjnë me zonat tjera, ku edhe lejohet me ligj veprimi.

Natyrisht, turizmi dimëror edhe ai veror në këtë rast, është tejet në interes të Kosovës, por, kjo duhet të bëhet duke synuar gjithmonë zhvillimin e qëndrueshëm e në këtë rast duke u respektuar ligjet e që kjo do të nënkuptonte tërheqjen e çfarëdo projekti nga zonat strikte të Parkut Nacional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar përfaqësuesi i Qeverisë, ministri Gashi.

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Zoti Aliu,

Së pari t'ju falënderoj për një raport relativisht korrekt dhe të saktë dhe t'ju falënderoj edhe për rekomandimet, të cilat të gjitha qëndrojnë. Vetëm disa aspekte të raportit kisha dashur t'i cek, për shembull, numër një çështjen e Brezovicës që e përmendët disa herë, Ministria nuk ka dhënë asnjë pëlqim për zhvillimin e këtij projekti.

E kemi sqaruar edhe me Komisionin Evropian edhe me Komisionin Ndërministror, se Ministria është si të them, duke e toleruar në heshtje këtë aktivitet, derisa ta shohim se për çfarë projekti është fjala, se sa do të ketë ndikim në mjedis. Nëse ky projekt final, që i prezantohet Ministrisë, do të ketë ndikim të tillë në mjedis, që e pengon këtë zhvillim, ne në asnjë mënyrë nuk do të pajtohemi me këtë. Dhe, ky ka qenë një problem, që në vazhdimësi e kemi diskutuar edhe me Komisionin Evropian dhe me të interesuarit tjerë edhe me Komisionin Ndërministror.

Sa i përket Lipjanit, problemi ai që e cekët edhe ju, se disa komuna operojnë pa leje, ne kemi hasur në këtë projekt, që ka qenë pa leje, çfarëdo leje. Pas asaj kemi kërkuar që të sqarohet nga një komision tjetër, për shkak se ka qenë projekt me interes publik, pra punë çështje e ujësjellësit për 12 fshatra. Pasi është bërë ajo analizë, kemi lejuar që të vazhdojë, për shkak të interesit publik dhe të nevojës së fshatarëve për ujë, të vazhdojë pra realizimi i projektit.

Sa u përket lumenjve, ju e dini se vendimi ka ardhur si iniciativë e Ministrisë. Jemi në procedurë e sipër, në aksione e sipër, 19 raste kanë ndodhë konfiskime, 19 raste kanë ndodhur edhe arrestime. Do të thotë, numri i operatorëve ilegalë ka rënë dukshëm, mirëpo natyrisht se është e pamundur të kontrollohet secili qosh i Kosovës me këto mjete që i kemi.

Pra, ju falënderoj edhe një herë për raportin!

KRYESUESI: Zoti ministër, faleminderit! Për Grupin e PDK-së flet Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka mirëpritur këtë raport, sidomos monitorimin e zbatimit të këtij ligji, i cili ka shumë ndikim, ka shumë efekte mjedisore, për të cilat është folur shumë edhe në opinion edhe ndër ne.

Ky raport është një raport shumë përmbajtjesor, i cili ka përmbledhur një faktografi shumë të madhe, është bërë një punë shumë e mirë e Komisionit. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e vlerëson punën e këtij komisioni dhe ka konstatuar, se ky raport duhet të miratohet nga ne dhe ne në fakt do ta miratojmë këtë me të gjitha vërejtjet, që janë dhënë nga ky komision.

Dëshiroj të theksoj faktin se në vitin 2012 në raport me vitet tjera, ne kemi vërejtur një zbatim të mirë të këtij ligji, është rritur trajtimi i të gjitha lëndëve nga institucionet përgjegjëse, dhe si të thuash, edhe nga inspektorati edhe nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, po edhe nga Komisioni për Miniera dhe Minerale. Ka një progres të mirë, nuk ka pasur lëndë që kanë mbetur të pa trajtuara. Mendoj që nëse vazhdohet me këtë trend ne do të duhet ta përshëndesim punën, që e bëjnë të gjitha këto institucione. Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Deputeti Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së, ka shqyrtuar dhe analizuar këtë raport. Unë do të doja të ndalem në tri- katër komente, të cilat i tha edhe parafolësi më herët. Ka të bëjë me rekomandimin 3, ku Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kërkohet të rrisë transparencën për procedura të dhënies së pëlqimit mjedisor dhe lejet që janë dhënë, të jenë në dispozicion të publikut.

Pra, problem ndoshta numër një mbetet tek Ministria e Planifikimit, që ka të bëjë me disa operatorë, të cilët kërkojnë lejet mjedisore, mirëpo, operatorët që kërkojnë leje mjedisore nuk varen vetëm prej kësaj leje, sepse varen edhe prej disa lejeve dhe pëlqimeve tjera,

por nga Ministria e Planifikimit Hapësinor mendoj se duhet të jetë më transparente sa i përket pëlqimeve mjedisore, sepse kemi shumë operatorë në terren që nuk posedojnë pëlqime mjedisore, apo nuk posedojnë ndoshta edhe lejet tjera që kërkohen përmes këtij ligji.

Konsideroj se ligji si i tillë është jashtëzakonisht i mirë. Kjo është vlerësuar edhe nga anëtarë të komisionit, të cilët kanë marrë pjesë dhe kanë qenë prezentë edhe në shumë vizita, që janë realizuar sa i përket implementimit të këtij ligji, por mendoj që Ministria e Planifikimit Hapësinor, ne i kemi kërkuar edhe ministrit dhe kemi kërkuar po ashtu, edhe në hartimin e buxhetit ku është thënë se kjo ministri e ka një buxhet jo të mjaftueshëm dhe jo të kënaqshëm. Dhe, kjo i referohet edhe Raportit të Progresit, ku thotë që Ministria e Planifikimit Hapësinor posedon një buxhet jashtëzakonisht të vogël karshi kërkesave të shumta dhe karshi problemeve që posedon kjo ministri. Me një buxhet të tillë e ka të pamundur që t'i realizojë të gjitha kërkesat, që i drejtohen kësaj Ministrie.

Konsideroj që ndoshta edhe pika tjetër ka të bëjë me çështjen e komunave, ku thuhet se njëri prej rekomandimeve, komunat gjatë dhënies së lejeve ndërtimore dhe punës, të respektojnë pëlqimet mjedisore dhe planet e saja zhvillimore dhe urbane.

Pra, kemi raste kur Ministria e Planifikimit e jep pëlqimin, apo kur Ministria e Planifikimit nuk jep pëlqim ndërsa komunat japin leje mjedisore, që bie në kundërshtim me ligjin, i cili kërkon që të respektohet. Sepse, pa pëlqimin mjedisor lejet tjera ose organet tjera, që lëshojnë leje të punës, janë në kundërshtim dhe nuk përputhen me Ministrinë e Planifikimit Hapësinor.

Ndërsa, çështja tjetër ka të bëjë edhe të ndërpritet menjëherë të gjitha aktivitetet në zonat e mbrojtura, që nuk janë pajisur me pëlqime mjedisore dhe leje tjera përcjellëse, u tha edhe nga parafolësit tjerë.

Konsideroj që si raport është shumë korrekt dhe është shumë përmbajtësor. Atë e tha edhe vetë ministri dhe nga këto pikat kritike që janë paraqitur nga ky raport, unë konsideroj që Ministria, në këtë rast edhe vetë ministri është këtu prezent, obligohet që t'i përmbushë gradualisht, kohë pas kohe implementimin e këtij ligji, i cili është shumë i rëndësishëm për fushën e mjedisit në përgjithësi. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar raportin me rekomandime, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, vlerëson punën e Komisionit Parlamentar që e ka bërë në terren, po ashtu në takimet me grupet e interesit. Do ta përkrahim raportin, si dhe rekomandimet e dhëna nga komisioni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Gjatë monitorimit të zbatimit të Ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis grupi punues ka bërë shumë vizita, në mes tjerash dua të cekim me theks të veçantë, se më datën 27.4.2012 grupi punues ka realizuar vizitën në komunën e Gjakovës, me ç'rast është mbajtur takim me inspektoratin komunal për mjedis, si dhe drejtoreshën e urbanizmit atje.

Në takim kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga Inspektoratin qendror i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe të Ministrisë së Mjedisit. Është diskutuar puna dhe problemet e inspektoratit e që ndërlidhen me operatorët ilegalë, që veprojnë në terren. Është diskutuar për pamundësinë e inspektimit të këtyre veprimtarive, si pasojë e agresivitetit të këtyre operatorëve.

Grupi punues me këtë rast ka kërkuar të bëhet bashkërisht një vizitë te këta operatorë dhe me këtë rast është përzgjedhur Fabrika e Tullave e Niki-S në Gjakovë. Vizita në Fabrikën e Tullave Niki-S në Gjakovë përmban takimin me pronarin e fabrikës, diskutimin rreth posedimit të dokumenteve të kërkuara sipas ligjit, gjë që i lartcekuri nuk kishte dhe as që donte të dinte për to, si dhe vizitën e drejtpërdrejtë në vendin e shfrytëzimit të materialit bazë, dheut për prodhimin e tullave.

Të nderuar, atje po degradohet me të madhe mjedisi e sidomos, po shkatërrohet një pjesë e konsiderueshme e Kodrës së Çabratit dhe komuna as që po merret me këtë operator ilegal, me këtë rast dua t'ju kujtoj nenin 52 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Sido që të jetë, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re i përkrahë rekomandimet dhe kërkojmë zbatim të ligjit në tërë territorin e Kosovës. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYETARI: Nuk kemi më të lajmëruar për diskutim. Cila është prania? Kemi edhe dy pika të rendit të ditës, por me këtë mungesë të deputetëve, a jeni dakord ta vazhdojmë? Merruni vesh nga një të flisni në emër të grupeve parlamentare e jo kështu. Në emër të Vetëvendosjes, Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Propozoj që diskutimin për pikën 11 kishim mund ta përfundonim, e pastaj nëse s'ka deputetë për votë, atëherë ta shtyjmë votimin për një herë tjetër, po s'kemi nevojë për ta ndërprerë tash, meqenëse diskutimet mund t'i bëjmë edhe me këtë numër të deputetëve.

KRYETARI: Unë jam dakord, por po mungojnë deputetët.

(Ndërprerje e shkurtër - numërimi i deputetëve të pranishëm në sallë)

Votojmë për pikën e tetë:

8. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2012

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 64 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Raportin vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2012.

Tani e votojmë pikën e nëntë të rendit të ditës,

9. Shqyrtimi i raportit të punës të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2012

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 62 vota për, 7 kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Raportin e punës së Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2012.

Dhe, tash e votojmë pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 71 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi e miratoi Raportin me rekomandimet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Numër 03/L-214 për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Tani po vazhdojmë me pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për vlerësimin strategjik mjedisor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, e ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit numër 03/L-230 për vlerësimin strategjik mjedisor dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj deputetin Liburn Aliu, në emër të Komisionit, si raportues i Komisionit funksional, për arsyetimin e Raportit me rekomandime. Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit kryetar!

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Planifikim Hapësinor dhe Mjedis, bazuar në planin e punës dhe në bazë të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 3.10.2010 ka vendosur të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit 03/L-230 për

vlerësim strategjik mjedisor, si një ndër ligjet bazë për fushën e mjedisit e që rregullon çështjen e lejeve dhe pëlqimin mjedisor për veprimtaritë ekonomike në raport me nivelin e ndikimit të tyre në mjedis.

Me qëllim të realizimit të këtij vendimi, Komisioni themeloi grupin punues prej 5 anëtarësh, i cili ka hartuar planin e veprimit për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji të VSM-s dhe ka realizuar një varg takimesh në institucionet qendrore, në komuna dhe institucione tjera. Po ashtu ka realizuar edhe vizita të shumta, ka bërë në terren me qëllim të njoftimit të drejtpërdrejtë me nivelin e zbatimit të ligjit si dhe ka organizuar disa tryeza publike.

Pas shqyrtimit të analizës së tërë procesit dhe në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët relevantë, Komisioni e përgatiti këtë raport me rekomandime, të cilin në mbledhjen e mbajtur më 22 prill 2013, vendosi t'ia paraqet Kuvendit.

Për sa i përket çështjes së vizitave, do të doja t'i përmendi edhe një herë këto, që janë të ngjashme me këtë, se monitorimi është bërë paralelisht me monitorimin e Ligjit për vlerësim në ndikim në mjedis dhe po thuaj në të gjithë hapat kanë qenë paralel në të gjitha vizitat në Ministri janë parashtruar pra të dy palët pyetësor, po ashtu në të gjitha vizitat në terren ku ka pasur të bëjë edhe në komunat, janë shtruar çështjet, pra diskutimet e njëjta në lidhje me të dyja ligjet dhe pjesa hyrëse e këtij raporti është e njëjtë me atë të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Po ashtu, për këtë ligj konsiderojmë se si sukses i arritur është vetë miratimi i këtij ligji që ka ndodhur në vitin 2010 dhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian vlerësohet se është krejtësisht në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Me miratimin e këtij ligji është krijuar baza ligjore që me vlerësim strategjik mjedisor dhe planeve e programeve të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

Për sa i përket problemeve të identifikuara me zbatimin e këtij ligji, do të doja së pari të filloj me çështjen e planeve zhvillimore komunale ku në shumicën e rasteve planet e miratuara zhvillimore komunale nuk kanë aplikuar për pëlqim mjedisor në lidhje me vlerësimin strategjik mjedisor, përpos e kemi rastin e komunës së Junikut dhe komunës së Hanit të Elezit të cilët në draft-planet e tyre zhvillimore e kanë bërë edhe trajtimin e vlerësimit strategjik mjedisor.

Kemi edhe raste tjera që zona ekonomike dhe industriale në Kërqevë të komunës së Lipjanit, ndërtimi i planit në fshatin Lumbardhë të komunës së Vushtrisë, por në dyja raste këto nuk ka ndodhur ende pëlqimi mjedisor pasi që edhe nuk ka qenë i kompletuar tërësisht dokumentacioni.

Për sa i përket zbatimit të vlerësimit strategjik mjedisor është marrë për bazë autostrada Prishtinë - Merdar, pra vlerësimi strategjik i saj për autostradën Prishtinë - Merdar dhe po ashtu edhe për termocentralin “Kosova C”, apo termocentralin “Kosova e Re”. Sa u

përket të dyja këtyre rasteve, do të mund të themi që në këtë aspekt kemi një hap më tutje të themi në zbatim të këtij ligji me ç'rast kemi pasur vlerësim strategjik mjedisor, ka pasur edhe pjesëmarrje të publikut, por do të mund të konsiderojmë që pjesëmarrja e publikut në rastin e autostradës nuk ka qenë pjesëmarrje e mirëfilltë në vendimmarrje, e po ashtu vërejtje tjetër për sa i përket autostradës është që vlerësimi strategjik mjedisor i dhënë për projektin bazë të parë, duhet të trajtohet sërish dhe duhet të adaptohet me ndryshimet e mëvonshme që lidhen me ndryshimet në projekt.

Po ashtu situatë e ngjashme apo të themi është më e mirë situata te rasti i termocentralit “Kosova C”, me ç'rast komponenti i pjesëmarrjes së publikut në këtë proces është më e theksuar se në rastin e autostradës dhe edhe pse mund të themi që ky vlerësim strategjik në mjedis në këtë projekt ka ndodhur para se madje edhe të miratohet vetë Ligji i vlerësimit strategjik në mjedis dhe mund të themi që është një ndër hapat kryesorë dhe ndër hapat e parë të zbatimit të këtij ligji, edhe pse natyrisht ne nuk jemi ata që do të duhej ta vlerësonim tani profesionalizmin e atij vlerësimi strategjik mjedisor. Çka mbetet problematike te termocentrali “Kosova e Re” është që fati i vendimit të procesit të VSM edhe sot është i paqartë pasi projekti ka pësuar ndryshime prej kohës kur është realizuar plani i vlerësimi strategjik mjedisor në vitin 2008.

Si konkluzion do të mund të thoshim, sërish edhe tek rasti i njëjtë sikur tek vlerësimi i ndikimit në mjedis që për sa i përket ligjit ai i plotëson dhe paraqet bazë të mjaftueshme ligjore për përcaktimin e kushteve, mënyrën dhe procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara përmes integritetit të parimeve të mbrojtjes së mjedisit në procedurën e përgatitjes, miratimit dhe realizimit të planeve dhe programeve me synim të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm. Po ashtu sfida kryesore për këtë ligj mbetet zbatimi i tij në praktikë, gjë që nuk realizohet në nivel të duhur.

Dhe rekomandimet e dala nga puna e Komisionit janë që lidhen sërish edhe këtu me Qeverinë dhe komunat, e me këtë rast Qeveria dhe komunat do të duhej të zbatojnë legjislacionin në fuqi për lehtësimin strategjik mjedisor në të gjitha projektet që kanë ndikim në mjedis.

Komunat për planet zhvillimore të aplikojnë për pëlqim mjedisor sipas ligjit. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të rrisë transparencën për procedurat e dhënies së pëlqimeve mjedisore dhe lejet që janë dhënë të jenë në dispozicion të publikut. Të shtohet bashkëpunimi si në rrafshin horizontal në mes dikastereve qeveritare dhe agjencive të ekzekutiveve të pavarura e po ashtu edhe në rrafshin vertikal me komunat në fushën e zbatimit të këtij ligji.

Të zbatohen dispozitat ligjore për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje si dhe të organizohen fushata të vetëdijesimit.

Edhe në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Grupi Parlamentar pra do ta votojë këtë raport, pra edhe vërejtjet tona janë në përputhje me vërejtjet e këtij raporti.

KRYETARI: Vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike deputeti Nijazi Idrizi e ka fjalën.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit i nderuari kryetar!

I nderuari ministër,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë raport, i cili bashkë me raportin e më parëm e përbën të njëjtën lëndë. Grupi Parlamentar ka vendosur që ta mbështesë këtë raport bashkë me rekomandimet që u jepen institucioneve përgjegjëse, sidomos Qeverisë për zbatimin e këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri e ka fjalën.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Siç thekoi Liburni, Komisioni për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor i ka përgatitur dy raport lidhur me monitorimin e ligjeve për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe vlerësimin strategjik mjedisor.

Raporti për Ligin e vlerësimin strategjik mjedisor është përgatitur duke u bazuar në një varg takimesh në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komisionin e Pavarur për Minierat dhe Minerale, Agjencinë Kosovare të Privatizimit, komunat dhe institucionet tjera relevante. Janë organizuar disa vizita në terren me qëllim të informimit të drejtpërdrejt në nivelin zbatimit të ligjit si dhe janë organizuar disa tryeza publike.

Qëllimi i mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit të vlerësimin strategjik mjedisor është i rëndësishëm, sepse pasqyron nivelin e zbatimit të tij në praktikë nga ana e institucioneve qendrore siç është Ministria e Planifikimit Hapësinor si autoritet kompetent për zbatimin e tij, si dhe autoritetet lokale për mjedis që janë komunat.

Fusha e vlerësimin strategjik mjedisor rregullohet me Ligjin për vlerësimin strategjik mjedisor që ka për qëllim që në vlerësimin strategjik mjedisor të planeve dhe programeve të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit edhe shëndetit të njeriut, të rregullojë gjithashtu çështjet e lejeve dhe pëlqimeve mjedisore për veprimtaritë ekonomike në raport me nivelin e ndikimit të tyre në mjedis.

Ligji për vlerësimin strategjik mjedisor i miratuar në vitin 2010 në raportet e progresit të Komisionit Evropian, vlerësohet se është gjerësisht në përputhje me standardet e Bashkësisë Evropiane, me miratimin e tij është krijuar një bazë e mjaftueshme ligjore për vlerësim strategjik mjedisor të planeve dhe programeve që sigurojnë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

Andaj ne mendojmë që sfida kryesore për këtë ligj mbetet zbatimi i tij në praktikë, gjë që nuk realizohet në nivelin e duhur, prandaj Komisioni përmes këtij raporti i jep edhe disa

rekomandime për fuqizimin e implementimit të këtij ligji të cilat Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i përkrah dhe do t'i votojë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, deputetja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar këtë raport, e përkrah raportin dhe rekomandimet e dhëna nga Komisioni.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re, e përkrah raportin me rekomandime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ju njoftoj se prezenca elektronike është 89 deputetë. Votojmë për prezencë. Regjia, përgatitu! Votojmë tash!

70 deputetë është prania fizike. Ka kuorum për votim. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 69 vota për, 1 abstenim dhe asnjë kundër, Kuvendi e miratoi Raportin me rekomandime të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit numër 03/L-230 për vlerësimin strategjik mjedisor.

Vazhdojmë me pikën e dymbëdhjetë dhe të fundit të rendit të ditës:

12. Emërimi i dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur rekomandim për miratim.

Ftoj kryetaren e komisionit ad-hoc deputeten Xhevahire Izmaqu që para deputetëve të Kuvendit t'i arsyetojë rekomandimet.

XHEVAHIRE IZMAKU:

Rekomandim:

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të bëjë emërimin e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës me votim të fshehtë për një pozitë për anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, propozohen për votim 2 kandidatë si në vijim:

- Murat Musliu dhe

- Nysret Pllana.

Kuvendi bën përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga këta dy të propozuar.

Për një pozitë të anëtarit të Bordit nga radhët e komuniteteve tjera jo shumicë, propozohen për votim dy kandidatë, si në vijim:

- Elif Tokmak dhe
- Elmaz Karaxhi.

Kuvendi bën përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga dy këta të propozuar.

Anëtarët e Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, të emërohen me mandat trevjeçar. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Prej dy kandidatëve të përzgjedhur nga Komisioni ad-hoc nga radhët e komunitetit shqiptar, Kuvendi zgjedh një anëtar, nga dy kandidatë.

Për pozitën e anëtarit nga radhët e komuniteteve tjera jo shumicë, prej dy kandidatëve të përzgjedhur nga Komisioni ad-hoc Kuvendi, zgjedh një anëtar.

Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë, kërkohet krijimi i një Komisioni votues, me përbërje nga një deputet për secilin grup parlamentar, në mbështetje të zyrtarëve të administratës.

Nënkryetari Sabri Hamiti do t'i thotë dy-tri fjalë rreth kësaj çështjeje.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit,
Ku e keni shefin? S'ka as ministër hiç!
Kolegë të nderuar,
Sot kemi në rend dite edhe një herë zgjedhjen ose propozimin për zgjedhje të anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, që ka të bëjë me një anëtar shqiptar dhe me një anëtar të pakicave.

Më lejoni të them që s'kemi pasur shumë sukses në zgjedhjen e këtyre bordeve, po zgjat me muaj të tërë, por nuk mund të mos e shpreh mendimin tim, sepse jam njeri që i njoh lëmenjtë, s'kemi pasur sukses që t'i zgjedhim njerëzit më mirë, aq më keq, kemi pasur konkurrentë më të mirë e s'i kemi zgjedhur më të mirët.

Kjo ka ndodhur për shkak se në dy shkallët e propozimeve ka ndodhur ky, ta quaj një tip i seleksionimit, po e quaj unë negativ, edhe në nivel të Komisionit edhe në nivel të Kuvendit.

Në Kuvend vota është e fshehtë dhe këtu unë i çoj krahët, sepse vota është e fshehtë.

Ndërsa, sa i përket rekomandimit të Komisionit ad-hoc unë i kam dy fjalë. Të gjitha herat, edhe këtë herë, një Komision ad-hoc nëse i propozon Kuvendit që zgjedh anëtarë të bordit, që kanë funksione shumë përgjegjëse në një transmetues publik qysh është RTK-ja, duhet arsyetim plus. Ky është krejt formal, një arsyetim formal ku nuk ka kurrfarë arsyetimi pse këta dy një herë dhe këta dy një herë zgjidhen. Nuk ka. Pse janë më të mirët këta, duhet të bindet edhe opinioni edhe Kuvendi? A janë më të mirët prej konkurrentëve a s'janë, çka i dallon? Ia kemi borxh Kuvendit që voton dhe opinionit ku i dërgojmë t'iu themi: zotërinj deputetë dhe qytetarë të nderuar, ne ofrojmë këto dy alternativa dhe mendojmë se janë më të mirët për këtë, këtë e këtë. Kjo mungon.

Pra, kjo që e kemi përpara është një paraqitje skematike pa kurrfarë vlerësimi, pos propozimit.

Komisioni i cili është marrë me këtë, unë nuk e di krejt kush ka qenë, por s'është me rëndësi, sigurisht i kanë emrat dhe ai është Komision ad-hoc ku marrin pjesë të gjithë, sa e di unë, të gjitha grupet parlamentare, kështu që s'kam specifikum për dikë, por iu kisha thënë: ka qenë mirë t'i lexojnë këto biografi, qysh i kemi marrë ne, unë i kam lexuar dhe është shumë interesant që rekomandimet që vijnë për ta, kanë të bëjnë me rekomandime për krejt diçka tjetër. Për shembull rekomandimi bëhet për dikë që konkurron në një funksion, ju keni rekomandime që bëhet që ai jep mësim diku dhe është rekomandim, për shembull para dy-tri vjetësh, ose tjetri është rekomandim që ka të bëjë pak a shumë nga një person që dëshmon që e njeh, e ka koleg të hershëm, po ai thotë, për shef. Nuk thotë anëtar bordi, por thotë, e rekomandoj të jetë në krye të institucionit.

Kjo është e papërgjegjshme nga ana e Komisionit të mos thuhet, këtë që po e them unë.

Unë po e them për tu bërë më serioz, çka jemi duke bërë, të gjithë, se do të votojë gjithë Kuvendi. Nuk kam unë kurrfarë, do të thotë, raporti specifik, ama për asnjërin prej tyre, as ata që konkurrojnë në emër të shqiptarëve as të pakicave.

Për të shkuar edhe më tutje, atje zakonisht unë jam njeri që them harroni rekomandimet, mi jepni diplomat, sepse është bërë modë që të fshihen biografitë me disa trajnime që s'thonë gjë, ndërsa shkollë substanciale paraqesin pak. Por, në këtë rast kur i paraqesin janë të çuditshme, se tema çka thonë që kanë mbrojtur dhe diploma çfarë iu është dhënë, është një çudi, nuk kanë lidhje njëra me tjetrën.

Merrni lexoni, unë ju thërras t'i lexoni, unë nuk dua t'i deklamoj këtu se s'është çështje e imja, veç se ky Kuvend le të mendojë për këto probleme, është koha të mendojë se ka përgjegjësi. Faleminderit!

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem predsedniče!

Poštovani poslanici svih političkih partija i svih etničkih zajednica,

Molim vas da podržite kandidata ispred Bošnjačke zajednice za člana Borda direktora nacionalne televizije RTK iz razloga zato što je naša zajednica već 13 godina diskriminisana po tom pitanju i nema svog predstavnika i nije imala nijednog do sada, ali i zbog velike profesionalnosti kao jako iskusna osoba iz sfere ekonomije i menadžmenta, gospodin Elmaz Karadži postigao je ogromne rezultate u oblasti finansijske analize ali i velike uspehe u oblasti strategije, segmentacije tržišta u međunarodnom marketingu, upravljanju biznisom, statistikom, strateškom ispitivanju tržišta, što možete i sami videti u dostavljenom materijalu koga imate na stolu.

Izbor magistra ekonomije gospodina Elmaza Karadži je prioritetne važnosti za reforme koje se trebaju dogoditi na nacionalnoj televiziji RTK u programima na jezicima manjinskih zajednica daleko od političkog monopola i pristrasnosti pojedinaca. Zato je važno da kandidat koga danas izaberemo bude nepristrasan i objektivan, nestranačka ličnost, koja će raditi u interesu građana. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Deputeti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Faleminderit, kryetar!

Unë desha vetëm ta ngre këtë çështjen e këtyre dokumenteve që na vijnë, me ç'rast kandidatët nëpërmjet tyre synojnë që ta legjitimojnë vetveten si kandidatë të denjë për postet dhe pozitat të cilat i pretendojnë.

Këtu na ka ardhur njëri prej kandidatëve i cili do të zgjidhet prej komuniteteve jo shumicë, që po quhen me një diplomë e cila më ka bërë shumë përshtypje mua, e cila është një diplomë e strukturave paralele të cilat duhet të jenë të papranueshme për Republikën e Kosovës. Këtu kemi një diplomë të një kandidati e cila është e lëshuar prej Univeristetit të Prishtinës për Kosovën dhe Metohinë, mirëpo jo për para vitit 1999, por është dokument i lëshuar në vitin 2004, prej Universitetit paralel të Prishtinës, të cilin e kontrollon Beogradi.

Dhe aq më keq, është nënshkruar prej rektorit famëkeq të cilin e mbajmë ne në mend të gjithë, prej Radivoje Papoviqit, i cili, siç e dini, mezi i pat shpëtuar një atentatit prej Zahir Pajazitit.

Dhe dokumenti është i lëshuar për magjistraturë në vitin 2004. Nuk është para vitit 1999, është pas çlirimit të Kosovës, në vitin 2004, prej Universitetit paralel të Prishtinës, i cili aktualisht, dorën në zemër, nuk e di se në cilën skutë të Kosovës funksionon dhe i cili lëshon diploma, magjistratura, doktoratura me të cilat njerëzit marrin pozita në Republikën e Kosovës.

Tash unë mendoj që në Republikën e Kosovës nuk mund të shkojë edhe Papoviqi edhe Zahir Pajaziti, duhet të jetë njëri.

Për këtë arsye mendoj që seriozisht në Republikën e Kosovës nuk duhet të jenë të pranuar dokumente të tilla të cilat janë të nënshkruara prej Radivoje Papoviqit.

KRYETARI: Replikë, po më duket, Emilija Rexhepi!

EMILIJA REXHEPI: Zahvaljujem se predsedniče!

Diploma je validna. Profesor Elmaz Karađži je diplomirao 29.11.1994. godine i nema veze sa paralelnim institucijama. Zahvaljujem se.

KRYETARI: Realisht, kjo nuk do të duhej të ishte temë, është dashur Komisioni ta kryejë këtë punë. Glauk, e ke një minutë për kundër-replikë.

GLAUK KONJUFGA: Që po e prezantoj fotografinë e diplomës. Lart shkruan Republika e Serbisë, Universiteti i Prishtinës, viti i magjistraturës 2004, i nënshkruar në 2004 prej Radivoje Papoviqit.

Nëse pranohet njeri në këtë post nëpërmjet këtij dokumenti, kjo i vjen që Republika e Kosovës i pranon dokumentet e Universitetit paralel të Republikës së Kosovës, që funksionojnë në Republikën e Kosovës në mënyrë antikushtetuese.

KRYETARI: Jo e sekretarit, por është kjo punë e Komisionit. Mirë. Nuk ka më fjalë. Ai dokument është. Glauku po thotë diçka që është dhe është fakt.

(Ndërhyrje)

Ai po flet për dokumentin që është në material. Dhe, jo, ju lutem, s'kemi më, megjithatë ju dëgjuat dhe shkojmë në procedurën për formimin e Komisionit. Ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtar për komisionin votues.

Nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Zoti kryetar, unë propozoj zotin Halit Krasniqi për anëtar të Komisionit.

KRYETARI: Nga Vetëvendosja, Visar?

VISAR YMERI: Albana Gashi.

KRYETARI: Mirë, Nga AAK, Ardian?

ARDIAN GJINI: Teuta Haxhiu, zoti kryetar. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë. Nga Koalicioni për Kosovë të Re, kryetare?

MYZEJENE SELMANI: Sevdije Lama!

KRYETARI: Grupi i SLS, Sasha.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!
SLS predlaže Jasminu Živković.

KRYETARI: Mirë, po vazhdojmë. Kryetarja e Grupit 6+ Mufera Shinik?

MUFERA SHINIK: Fikrim Damka.

KRYETARI: Mirë, do të thotë, u formua Komisioni. Një votim formal për ta, na duhet.

Kush është për këta të propozuar? Faleminderit!

Kundër? Nuk ka, apo 2-3, nuk prish punë. Vazhdojmë.

Konstatohet se Kuvendi i miratoi anëtarët për Komisionin votues për zgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Lus komisionin të fillojë me procedimin e votimit, ndërsa deputetët do të ftohen të votojnë sipas listës.

(Ndërprerje e incizimit)

Adem Grabovci, Afërditë Berisha-Shaqiri, Afrim Hoti, Afrim Kasolli, Gëzim Kelmendi, Agim Kuleta, Ahmet Isufi, Albana Fetoshi, Albana Gashi, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Albert Kinolli, Alma Lama, Anton Çuni, Arben Gashi, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Aurora Bakalli, Azem Sylja, Bahri Thaçi, Arsim Bajrami, Bali Muharremaj, Berat Buzhala, Behar Selimi, Amir Ahmeti, Bekim Haxhiu, Biserka Kostiq, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Burim Ramadani, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enis Kervan, Nait Hasani, Eqrem Kryeziu, Etem Arifi, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Xhelili, Jeton Svirca, Flora Brovina, Florin Krasniqi, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Goran Marinkoviq, Nijazi Idrizi, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Hamza Balje, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Hashim Deshishku, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Emin Gërbeshi, Idriz Vehapi, Imri Ahmeti, Ismet Beqiri....

Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.

...Jakup Krasniqi, Jasmina Zhivkoviq, Jelena Bontiq, Justina Pula, Kymete Bajraktari, Latif Gashi, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Lumnije Morina, Lutfi Haziri....

(Ndërprerje e incizimit)

Lutfi Zharku, Fikrim Damka, Kurtan Kajtazi, Suzan Novobërdaliu, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Kurtan Kajtazi, Mursel Halili, Myzejene Selmani, Naser Osmani, Nazane Breca, Kimete Bytyqi, Sasha Milosavljeviq, Petar Miletqi, Rada Trajkoviq, Ramë Vataj, Ramiz Kelmendi, Ramiz Lladrovci, Rasim Demiri, Rexhep Selimi, Rita Hajzeraj-Beqaj, Sadri Ferati, Safete Hadergjona, Sala Berisha-Shala, Sali Asllanaj, Salih Morina, Salihe Mustafa, Sasha Gjokiq, Milivoje Stojanoviq, Sevdije Lama, Shaip Muja, Skënder Hyseni, Boban Todoroviq, Sreten Ivanoviq, Teuta Haxhiu, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Ukë Rugova, Vesimir Saviq, Vesna Mikiq, Visar Ymeri, Vjollca Krasniqi,

Vjosa Osmani, Valbona Dibra, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaku, Xhevdet Neziraj, Zenun Pajaziti.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Ftoj kryetarin e komisionit që ta paraqet rezultatin e votimit.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit kryetar!

Pas një pune që e bëri Komisioni, do ta konstatoj gjendjen, e cila nuk duket shumë për lëvdatë, po vazhdojmë.

Fletëvotimi i parë, që po e numërojmë, është:

Murat Musliu, Elif Tokmak

Kjo është e pavlefshme.

Nysret Plana dhe Elif Tokmak.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

Nysret Pllana, dhe nuk është nënvizuar, kjo është e prishur në të dyja, e pavlefshme.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

Është e pavlefshme.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

Nysret Pllana, Elmas Karaxhi,

E pavlefshme.

Murat Musliu, ndërsa tjetra është e pavlefshme.

Nysret Pllana, pjesa tjetër e pavlefshme.

E pavlefshme në të dyjat.

Nysret Pllana, Elif Tokmak.

(Ndërhyrje)

I numërojmë ato, po.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

(Ndërhyrje)

Dëgjo, janë të paqarta këtu, se mirë është. Për ata që është votuar, kur është votuar Murat Musliu dhe këto dy janë të pavlefshme, për këto janë dyjat të pavlefshme, jo votimi i pavlefshëm. Ku është votuar Nysret Pllana dhe këto dyja janë të pavlefshme, për këto dyja është e pavlefshme. Vazhdojmë më tutje dhe ne i shohim edhe një herë në Komision.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

KRYETARI: Shkojmë edhe një herë prej fillimit. Po, prej fillimit dhe fleta është e pavlefshme vetëm kur është e pavlefshme për dy kandidatët. Nuk është e pavlefshme nëse është për një kandidat po, për një jo. Mos i ngatërroni.

HALIT KRASNIQI: Ishte krejt e paqartë, por ishte e panevojshme edhe kjo ndërhyrje.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

Tani kjo është e pavlefshme se të katërtit janë bërë me shenja.

Tani është e pavlefshme, sepse ka vijë.

E pavlefshme.

E pavlefshme.

E kemi Nysret Pllana, Elif Tokmak.

Nysret Pllana, Elif Tokmak.

Nysret Pllana dhe këtu asnjëra.

Nysret Pllana, dhe këtu është prishur, në të dyja.

Nysret Pllana, Elif Tokmak.

Nysret Pllana, nuk është nënvizuar asnjëri.

Është e pavlefshme, në të dy pjesët.

E pavlefshme në të dy pjesët.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

E pavlefshme në të dy pjesët.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

E pavlefshme.

E pavlefshme.

Nysret Pllana, e pavlefshme, pjesa tjetër.

Nysret Pllana, Elif Tokmak.

E pavlefshme, në dy pjesët e pavlefshme.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

E pavlefshme.

Elif Tokmak, është e vlefshme këtu.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

E pavlefshme.

E pavlefshme.

E pavlefshme.

Murat Musliu, Elif Tokmak.

E pavlefshme.

Murat Musliu, Elmaz Karaxhi.
Elif Tokmak, ndërsa këtu është e pavlefshme.
Murat Musliu, vetëm Murati është nënvizuar.
E pavlefshme.
Murat Musliu, Elif Tokmak.
Murat Musliu, Elmaz Karaxhi.
Murat Musliu, Elif Tokmak.
Murat Musliu, Elif Tokmak.
Nysret Pllana, Elif Tokmak.
Murat Musliu, Elif Tokmak.
Nysret Pllana, Elmaz Karaxhi...

(Ndërhyrje)

Jo, jo nuk mund të quhet e pavlefshme sepse është një fletë dhe këtu e ka nënvizuar Elmaz Karaxhi.

ENIS KERVAN: Ngadalë, se këtu e ka shkruar Zahir Pajaziti, është e pavlefshme.

HALIT KRASNIQI: Po, mirë e pavlefshme, mirë e ke, e ka prishur ky. Mendova se është shkruar Zenun Pajaziti.

Murat Musliu, Elif Tokmak.
E pavlefshme.
Nysret Pllana, Elif Tokmak.
Nysret Pllana, Elif Tokmak.
Murat Musliu, Elif Tokmak.
Nysret Pllana dhe këto dyja janë të pavlefshme kjo pjesë.
Murat Musliu, Elif Tokmak.
Murat Musliu, Elif Tokmak.
Është e vlefshme vetëm për Elmaz Karaxhin.
Murat Musliu, Elif Tokmak.
Murat Musliu, Elif Tokmak.
Murat Musliu, Elif Tokmak.
E pavlefshme.
Nysret Pllana, pjesa tjetër nuk është, e pavlefshme në të dyjat.
E pavlefshme.
Vetëm Elif Tokmak është e vlefshme.
Murat Musliu, Elif Tokmak.
Murat Musliu, Elif Tokmak.
Murat Musliu, Elif Tokmak.
E pavlefshme.
Elif Tokmak, ndërsa pjesa tjetër e pavlefshme.
Kjo është e pavlefshme.
Murat Musliu, Elif Tokmak.
Edhe kjo e pavlefshme.

Tani tërhiqemi për të bërë raportin dhe do të verifikojmë edhe një herë gjithë këtë që e lexuam tani.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Kryetari i Komisionit votues e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Në bazë të numërimit të votave, që i bëri Komisioni, ka konstatuar një gjendje prej 77 deputetëve që kanë marrë pjesë, 25 fletëvotime të parregullta, për kanë votuar...

Për kandidatin e parë Murat Musliu kanë votuar 34 deputetë, ndërsa për Nysret Pllanën kanë votuar 13 deputetë.

Asnjëri prej këtyre nuk zgjidhet anëtar i Bordit.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar nga radhët e komuniteteve tjera joshumicë janë:

Elif Tokmak ka fituar 40 vota, kurse Elmaz Karaxhi ka fituar 5 vota.

Me këtë rast, ne mund të konstatojmë, në bazë të rezultatit të votimit, në pajtim me nenin kaq dhe Kushtetutën, e tjera, e tjera, asnjëri nuk zgjidhet anëtar i Bordit nga kandidatët shqiptarë, ndërsa Elif Tokmak nga radhët e komunitetit jo shumicë zgjidhet anëtare e Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës. Urime i qoftë kësaj dhe për hair! Faleminderit!

KRYETARI: Këtu e mbylлим seancën. Mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*